

TË DREJTAT E TË BURGOSURVE



TË DREJTAT E TË BURGOSURVE

Avokati i Popullit

Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

IOM nuk mban asnjë përgjegjësi për çfarëdoj përdorimi që mund t'i bëhet informacionit që përmban ky material.

IOM i përmbahet parimit se migracioni i organizuar dhe human i shërben migrantëve dhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, IOM bashkëpunon me partnerët në komunitetin ndërkombëtar për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve aktuale të migracionit; për të zhvilluar më tej kuptimin e çështjeve që lidhen me migracionin; për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social nëpërmjet migracionit; dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Botues: **Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)**

Rr. Brigada VIII, Vila Nr. 3 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42 257 836/7

Fax: +355 42 257 835

Email: iomtirana@iom.int

Internet: <http://www.albania.iom.int>

Mblodhi materialet e reja dhe përgatiti për ribotim: **Harallamb BANO, Zyra e Avokatit të Popullit**

© 2009 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, regjistrohët, kopjohet ose transmetohet në çfarëdoj forme apo me çfarëdoj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose të tjerë, pa marrë më parë miratimin me shkrim nga botuesi.

Parathënie

Avokati i Popullit është një institucion kombëtar i pavarur nga Qeveria dhe institucionet e tjera të shtetit shqiptar, i parashikuar në Kushtetutën shqiptare, që ka për detyrë të mbrojtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në rastet kur ato shkelen ose nuk respektohen nga administrata publike shqiptare. Avokati i Popullit vepron vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pra nuk ka të drejtë (kompetenca) të ndërhyjë direkt në administratat e shteteve të tjera për të mbrojtur shtetasit shqiptarë apo të huaj. Por në vizionin e Avokatit të Popullit, njeriu kudo qoftë, brenda apo jashtë vendit të tij, në gjendje të lirë, apo qoftë i burgosur, ka gjithë ato te drejta dhe liri themelore, zbatimi i te cilave duhet të garantojë trajtimin njerëzor të tij.

Avokati i Popullit pohon se ka shumë instrumente juridike (Konventa, protokolle, ligje) ndërkombëtare që mbrojnë dhe garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Por Avokati i Popullit, ndërkaq, është i njohur edhe me të vërtetën e madhe se, jo rrallë, për të mos thënë shpesh dhe në shumicën e vendeve, garancitë që japin ligjet ndërkombëtare, por edhe ato kombëtare, nuk zbatohen, sidomos për shtetasit e huaj që ndodhen në ato vende, me apo pa leje qëndrimi. Për shtetasit shqiptarë, kudo ku ata ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ky konstatim është një realitet i hidhur. Për këtë, Avokati i Popullit është bindur, si nga njohja e drejtpërdrejtë e situatës nga ankesat e kërkesat e shtetasve, nga mediat shqiptare apo të huaja, por edhe nga kontaktet dhe informacioni i shkëmbyer me homologët e tij jashtë vendit. Por shtypa “duhet bërë diçka për të ndihmuar shtetasit tanë” ka qenë e pranishme qysh në fillim të veprimtarisë së tij që dy vjet më parë, në vitin 2000. Prandaj vendosëm që në radhë të parë t’u vijmë në ndihmë atyre që kanë më tepër nevojë dhe që kanë gjënë më të shtrenjtë, lirinë, të kufizuar, pra të ndihmojmë shtetasit shqiptarë që ndodhen të burgosur jashtë Shqipërisë.

Ikushtëzuar nga juridiksioni që nuk i mundëson ndërhyrjen direkte pranë administratave të burgjeve të vendeve të tjera, ku eventualisht dhe realisht vuajnë dënimin jo pak bashkatdhetarë, Avokati i Popullit vendosi të bëjë për ta atë që e konsideron më minimalen: T’i njohë shqiptarët e burgosur jashtë vendit me të drejtat dhe rrugët e mbrojtjes apo rivendosjes së të drejtave të tyre. Prandaj ky Botim i njeh lexuesit me:

1. Rregullat Europiane të Burgut, të cilat janë miratuar nga Komiteti i Ministrave të Shteteve që janë anëtarë të Këshillit të Europës. Këto rregulla përfshijnë ato të cilat janë më minimale dhe duhet të zbatohen në çdo burg të çdo vendi që është anëtar i Këshillit të Europës.
2. Konventën Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për shkeljen e të cilave çdo individ që është shtetas i një shteti anëtar të Këshillit të Europës, mund të ankohet në Gjykatën Europiane të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me qendër në Strasburg të Francës.
3. Shënime shpjeguese të cilat janë çështjet që mund të trajtojnë Gjykata e Strasburgut, si mund të plotësohet një ankesë dhe si mund t’i drejtoheni asaj Gjykate.
4. Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”.
5. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë për:

- a. ekstradimin e shtetasve shqiptarë për jashtë shtetit;
 - b. ekstradimin nga jashtë shtetit ;
 - c. Ekzekutimin e vendimeve penale të dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë, por me banim në Shqipëri;
 - d. ekzekutimi jashtë shtetit i vendimeve penale të dhëna nga gjykatat shqiptare.
6. Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005.

Këto akte janë një minimum i domosdoshëm, por i mjaftueshëm, i instrumenteve juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve të burgosur.

Dëshirojmë që, njohja me to të shërbejë si bazë e mirë juridike për të bërë krahasimet e mundshme në procesin e zbatimit të rregullave, si nga ana e administratës së burgjeve, ashtu edhe nga ana e vuajtësve të dënimit. Avokati i Popullit mendon se në burgjet e çdo shteti ka biblioteka ku mund të gjenden jo vetëm ligjet ndërkombëtare, por edhe ligjet dhe Rregulloret e brendshme të burgjeve të tyre, të cilat mund të jenë në gjuhën e huaj përkatëse. Por shpeshherë të burgosurit shqiptarë nuk e dinë gjuhën e vendit, sidomos nuk dinë gjuhën e shkruar të vendit ku vuajnë burgimin. Kjo e ka bërë akoma më të nevojshëm botimin e këtyre akteve ndërkombëtare.

Ky botim u inicua nga Avokati i Popullit dhe u mundësua nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në kuadër të projektit „Mbështetje për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri“, financuar nga Komisionit European dhe bashkëfinancuar nga Qeveria Italiane. Avokati i Popullit bashkëpunoi edhe me Ministrat e Punëve të Jashtme dhe të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë. Angazhimi i tyre do të mundësojë shpërndarjen e këtij botimi në të gjitha ato shtete ku ka burgje, dhe ku rrethanat e kanë sjellë që vuajtësi të jetë shqipfolës. Pra botimi është i vlefshëm edhe për shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi etj.

Me këtë rast Avokati i Popullit ju bën të ditur se pothuajse në të gjitha Shtetet Europiane ka institucione që janë homologe të Avokatit të Popullit, por që zakonisht kanë emrin ndërkombëtar Ombudsman, ose Mediator, ose Ombudsperson, ose Komisioner për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut etj. Prandaj është e mundur që çdo shtetas shqiptar, qoftë edhe i burgosur, mund t'i drejtohet këtyre institucioneve kur konstaton se ju shkelen të drejtat e tyre nga administrata e burgut ku vuan dënimin. Por theksojmë se këtyre institucioneve mos ju drejtoni kur e konsideroni vendimin për dënimin tuaj të padrejtë, sepse për këtë çështje mund t'i drejtoheni vetëm Gjykatës së Strasburgut. Ombudsmanëve, Mediatorëve etj, mund t'i drejtoheni vetëm për shkelje të rregullave gjatë vuajtjes së dënimit.

Avokati i Popullit i Shqipërisë, me këtë rast, u jep mesazhin të gjithë bashkëkombasve të tij shqiptare: Njihini të drejtat Tuaja, që t'i mbronni më mirë ato! Gjithmonë, gjithkush ka një të ardhme, prandaj mos e humbisni shpresën.

AVOKATI I POPULLIT

PËRMBAJTJA E BOTIMIT

1. Parathënie
2. Përmbajtja e botimit
3. Rregullat Europiane të Burgut, të cilat janë miratuar nga Komiteti i Ministrave të Shteteve që janë anëtarë të Këshillit të Europës.
4. Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
5. Shënime shpjeguese të cilat janë çështjet që mund të trajtojë Gjykata e Strasburgut, si mund të plotësohet një ankesë dhe si mund t'i drejtoheni asaj Gjykate.
6. Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”.
7. Ligji Nr. 8499 dt. 10.06.1999 “Për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës për transferimin e personave të dënuar“
8. Konventa midis Republikës së Shqipërisë e Republikës së Greqisë për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësorë për çështjet penale.
9. Konventa midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për transferimin e të dënuarve të burgosur
10. Rekomandime për edukimin në burgje
11. Ligji nr. 8328 dt. 16.04.1998 i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve“
12. Mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Dy praktika të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
13. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë për:
 - a. ekstradimin e shtetasve shqiptarë për jashtë shtetit;
 - b. ekstradimin nga jashtë shtetit;
 - c. Ekzekutimin e vendimeve penale të dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë,
 - d. ekzekutimi jashtë shtetit i vendimeve penale të dhëna nga gjykatat shqiptare.
14. Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005.
15. Emrat dhe Adresat e Ombudsmanëve në Europë të cilëve mund t’ju ankoheni për shkelje gjatë kryerjes së dënimit në burgje, por jo për vendimet e Gjykatave.

Rekomandimi Nr. R (87) 3**IKOMITETIT TË MINISTRAVE PËRSHTETETANËTARE MBIRREGULLAT EVROPIANE TË BURGUT (1)**

Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Europës më 12 shkurt 1987 në mbledhjen e 404 të Zëvendësministrave

Komiteti i Ministrave, në përputhje me nenin 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës;

Duke pasur parasysh rëndësinë e vendosjes së parimeve të përbashkëta lidhur me politikën penale midis shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës;

Duke konstatuar se, me gjithë përparimin e konsiderueshëm që është bërë në zhvillimin e alternativave me karakter jo-shtrëngues në trajtimin e fajtorëve, heqja e lirisë mbetet një sanksion i nevojshëm në sistemet e së drejtës penale;

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të rregullave ndërkombëtarë në praktikën dhe filozofinë e regjimit dhe drejtimit të burgut;

Duke konstatuar, megjithatë, se tendencat dhe ndryshimet shoqërore të rëndësishme lidhur me regjimin dhe drejtimin e burgut kanë shtruar kërkesën për të riformuluar “Rregullat minimum standart për trajtimin e të burgosurve” të Këshillit të Evropës (Rezoluta (73)5) me qëllim që të përkrahen e inkurajohen zhvillimet më të mira dhe të ofrohet një kuadër për përparimin në të ardhmen,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare në legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme të udhëhiqen nga parimet e parashtruara në tekstin e Rregullave evropiane të burgut, bashkëngjitur këtij Rekomandimi, me qëllim që të zbatohen në mënyrë progresive, duke vënë theksin në mënyrë të veçantë në qëllimet e parashtruara në parathënie dhe rregullat e parimit themelor në Pjesën I, dhe për ta publikuar këtë tekst sa më shumë që të jetë e mundur.

Shtesa në Rekomandimi Nr. R (87) 3**RREGULLAT EVROPIANE TË BURGUT*****Versioni i rishikuar evropian i Rregullave minimum standart për trajtimin e të burgosurve***

Këto rregulla janë miratuar për të arritur këto qëllime:

a. të vendosin në tërësi të standarteve minimum për të gjitha ato aspekte të administrimit të burgut që janë të rëndësishme për kushtet njerëzore dhe trajtimin pozitiv në sistemet moderne dhe përparimtare;

b. të shërbejnë si një stimulues për administratat e burgut që të zhvillojnë politika dhe një stil e praktikë drejtimi të bazuar në parimet e mira bashkëkohore të qëllimit e barazisë;

c. të inkurajojnë tek personeli i burgut qëndrime profesionale që pasqyrojnë cilësi të rëndësishme shoqërore e morale të punës së tyre dhe të krijojnë kushte, në të cilat ata mund të kryejnë siç duhet detyrën e tyre në interes të shoqërisë në përgjithësi, të kujdesit për të burgosurit dhe kënaqësisë së tyre profesionale;

d. të sigurojnë kritere themelore realiste mbi bazën e të cilave administratat e burgut dhe organet kompetente për kontrollin e kushteve dhe drejtimit të burgjeve, mund të arrijnë në gjykime të vlefshme mbi realizimin dhe të vlerësojnë përparimin drejt standarteve më të larta.

Duhet theksuar se rregullat nuk përfaqësojnë një sistem model, dhe se, në praktikë, shumë shërbime evropiane të burgut ndjekin një mënyrë veprimi që qëndron më lart se shumë prej standarteve të parashtruara në rregullat dhe se të tjerë bëjnë përpjekje dhe do të vazhdojnë të përpiqen për të vepruar në këtë drejtim. Kurdoherë që paraqiten vështirësi ose probleme praktike që duhen kapërcyer në zbatimin e këtyre rregullave, Këshilli i Evropës ka mekanizmin dhe përvojën e gatshme për të ndihmuar me këshilla dhe rezultate nga eksperiencia e administratave të ndryshme të burgut brenda sferës së tij.

Në këto rregulla është vënë theksi në mënyrë të përsëritur mbi vlerat e dinjitetit njerëzor, angazhimin e administratave të burgut për një trajtim njerëzor e pozitiv, rëndësinë e rolit të personelit dhe mënyrave efektive moderne të administrimit. Këto janë parashtruar për të siguruar referencë, inkurajim dhe udhëzues të gatshëm për ata që punojnë në të gjitha nivelet e administrimit të burgut. Memorandumi shpjegues që shoqëron rregullat synon të sigurojë mirëkuptimin, pranimin dhe fleksibilitetin e nevojshëm për të arritur nivelin më të lartë realist të zbatimit tej standarteve bazë.

PJESA I

PARIMET THEMELORE

1. Dënimi i heqjes së lirisë do të kryhet në kushte materiale dhe morale që sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe janë në përputhje me këto rregulla.

2. Zbatimi i rregullave do të bëhet në mënyrë të paanshme. Nuk do të ketë diskriminim për arsye race, ngjyre, seks, gjuhë, feje, mendimi politik ose të tjera, origjinës kombëtare ose shoqërore, statusit të lindjes, atij ekonomik ose tjetër. Secilit të burgosur do t'i respektohen besimet fetare dhe vlerat morale të grupit të cilit ai i përket.

3. Trajtimi i personave nën mbikëqyrje do të ketë si qëllim ruajtjen e shëndetit dhe dinjitetit të tyre, dhe për aq sa e lejon kohëzgjatja e dënimit, zhvillimin e ndjenjës së tyre të përgjegjësisë dhe inkurajimin e qëndrimeve a aftësive që do t'i ndihmojnë ata të riintegrohen në shoqëri për të vepruar në përputhje me zbatimin e ligjit dhe të përballojnë vetë jetesën e tyre pas lirim.

4. Institucionet dhe shërbimet penale do të kontrollohen në mënyrë të rregullt nga inspektorë të kualifikuar dhe me eksperiencë, të emëruar nga një autoritet kompetent. Ata do të kenë për detyrë, në veçanti, të mbikëqyrin se në çfarë mënyre dhe mase administrohen këto institucione në përputhje me legjislationin në fuqi, objektivat e shërbimeve të burgut dhe kërkesat e këtyre rregullave.

- 5.** Mbrojtja e të drejtave individuale të të burgosurve, e në mënyrë të veçantë ligjshmëria e ekzekutimit të masave të ndalimit do të garantohet nëpërmjet ushtrimit të kontrollit në bazë të rregullave kombëtare nga një autoritet gjyqësor ose një organizëm tjetër i emëruar në mënyrën e duhur, i autorizuar për të vizituar të burgosurit, me kusht që të mos jetë pjesë e administratës së burgut.
- 6.** 1. Këto rregulla do të vihen në dispozicion të personelit në gjuhët kombëtare;
2. Ata do të vihen gjithashtu në dispozicion të të burgosurve në të njëjtat gjuhë dhe në gjuhë të tjera për aq sa është e arsyeshme dhe e mundshme praktikisht.

PJESA II

DREJTIMI I SISTEMEVE TË BURGUT

Pranimi dhe regjistrimi

- 7.** 1. Në institucion nuk do të pranohet asnjë person pa urdhrin e vlefshëm të burgimit.
2. Të dhënat më themelore të burgosjes dhe të pranimit do të shënohen menjëherë.
- 8.** Në çdo vend burgosje, për secilin person të pranuar të shënohet në mënyrë të plotë dhe të sigurtë informacioni i mëposhtëm:
- informacioni lidhur me identitetin e të burgosurit;
 - arsyet e burgosjes dhe autoriteti përkatës;
 - dita dhe ora e pranimit dhe lirim.
- 9.** Organizimi i pranimit duhet të jetë në përputhje me parimet themelore të rregullave dhe të ndihmojë të burgosurit për të zgjidhur problemet e tyre urgjente personale.
- 10.** 1. Menjëherë pas pranimit, për secilin të burgosur të dënuar për një periudhë të caktuar, do të hartohen dhe paraqiten tek drejtori për informim ose miratim raporte të plota dhe informacioni përkatës mbi gjendjen personale dhe programin e kualifikimit të tij për ta përgatitur për lirim.
2. Këto raporte do të përfshijnë gjithnjë raporte nga mjeku dhe personeli që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të burgosurin përkatës.
3. Raportet dhe informacioni lidhur me të burgosurit do të mbahet duke pasur parasysh karakterin konfidencial mbi bazë individuale, do të plotësohet rregullisht, në kohë dhe mund të shihet vetëm nga personat e autorizuar.

Shpërndarja dhe klasifikimi i të burgosurve

- 11.** 1. Në shpërndarjen e të burgosurve në institucione apo regjime të ndryshme do të merret parasysh siç duhet gjendja e tyre gjyqësore e juridike (të burgosur të pagjykuar ose të dënuar, fajtorë për herë të parë ose përsëritës, dënim i lehtë ose i rëndë), kërkesat e veçanta për trajtimin e tyre, nevojat e tyre mjekësore, seksi dhe moshë.

2. Në parim, meshkujt dhe femrat do të mbahen në mënyrë të veçantë, megjithëse ata mund të marrin pjesë bashkërisht në aktivitetet e organizuara si pjesë e programit të përcaktuar të trajtimit.
 3. Në parim, të burgosurit e pagjykuar do të mbahen veçmas nga ata të dënuar, përveç rastit kur ata pranojnë të qëndrojnë ose të marrin pjesë së bashku në aktivitetet e organizuara në interes të tyre.
 4. Të burgosurit në moshë të re do të mbahen në kushte që i mbrojnë ata sa është e mundur nga ndikimet e dëmshme dhe që marrin parasysh nevojat e posaçme të moshës së re.
- 12.** Klasifikimi ose riklasifikimi i të burgosurve do të ketë si qëllim:
- a. të ndajë veçmas nga të tjerët ata të burgosur, të cilët, për arsye të të dhënave të tyre kriminale ose personalitetit të tyre, mund të përfitojnë nga ajo, ose ata që mund të ushtrojnë një ndikim të keq; dhe
 - b. të ndihmojë në shpërndarjen e të burgosurve për të lehtësuar trajtimin dhe përshtatjen e tyre shoqërore, duke pasur parasysh kërkesat e drejtimit dhe të sigurisë.
- 13.** Institucionet e veçanta dhe seksionet e veçanta të një institucioni do të përdoren për aq sa është e mundur për të lehtësuar drejtimin e regjimeve të ndryshme të trajtimit ose shpërndarjen e kategorive të veçanta të të burgosurve.

Strehimi

- 14.** 1. Të burgosurit do të strehohen normalisht gjatë natës në qeli individuale, përveç rasteve kur shihet e nevojshme se strehimi i përbashkët me të burgosurit e tjerë ka avantazhe.
2. Në strehimin e përbashkët do të vendosen ata të burgosur që i përshtaten shoqërimin me njëri-tjetrin në këto kushte. Në përputhje me natyrën e institucionit, natën do të ketë mbikëqyrje.
- 15.** Strehimi që u sigurohet të burgosurve, dhe në veçanti kushtet e fjetjes, do të plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe të higjienës, duke i kushtuar kujdesin e duhur kushteve klimatike dhe veçanërisht kushteve të ajrimit, një hapësirë të arsyeshme, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.
- 16.** Në të gjitha vendet ku jetojnë e punojnë të burgosurit:
- a. dritaret do të jenë në madhësi të mjaftueshme për t'iu dhënë mundësi të burgosurve, ndër të tjera, për të lexuar ose punuar me dritë natyrale në kushte normale. Ato do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen e ajrit të freskët, përveç rastit kur ka një sistem të përshtatshëm të ajrimit të kondicionuar. Veç kësaj, duke pasur parasysh kërkesat e sigurisë, dritaret, për aq sa është e mundur, do të kenë një paraqitje normale për aq sa i përket përmasave, vendosjes dhe konstruksionit;
 - b. drita artificiale do të plotësojë standartet e njohura teknike.

17. Instalimet dhe kushtet sanitare për përdorim do të jenë të përshtatshme për t'i dhënë mundësi secilit të burgosur të përmbushë nevojat në çdo kohë dhe në kushte të pastra e të denja.

18. Secilit të burgosur do t'i sigurohen instalimet e përshtatshme për larje e dush, në mënyrë që t'i jepet mundësia për t'u larë ose për të bërë dush në një temperaturë të përshtatshme për klimën, sa here që është e nevojshme për higjienën e përgjithshme sipas stinës dhe rajonit gjeografik, por të paktën një herë në javë. Këto do të jenë të lira për përdorim në çdo kohë kur është e mundur.

19. Të gjitha pjesët e një institucioni do të mirëmbahen siç duhet dhe të pastra në çdo kohë.

Higjiena personale

20. Është kërkesë që të burgosurit të mbahen pastër dhe për këtë qëllim atyre do t'u sigurohet ujë dhe mjete tualeti që janë të nevojshme për shëndetin e pastërtinë.

21. Të burgosurve do t'u sigurohen lehtësi për kujdesin e duhur për flokët e mjekrën dhe burrave do t'u krijohen mundësi që të rruhen rregullisht, për arsye shëndetësore dhe në mënyrë që ata të kenë paraqitje të mire dhe të ruajnë dinjitetin.

Veshja dhe mbulesat

22. 1. Të burgosurve, që nuk u lejohet të mbajnë veshjen e tyre, do t'u sigurohen një pale rroba të përshtatshme për klimën dhe për t'i mbajtur mirë me shëndet. Kjo veshje nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë degraduese ose poshtëruese.

2. Të gjitha rrobat do të jenë të pastra dhe të mbahen siç duhet. Ndërresat do të ndërrohen dhe lahen aq shpesh sa është e nevojshme për ruajtjen e higjienës.

3. Kurdoherë që të burgosurit marrin leje për të dalë nga institucioni, ata do të lejohen të veshin rrobat e tyre ose rroba që nuk i bëjnë të dallueshëm.

23. Me pranimin e të burgosurve në një institucion, do të bëhen rregullimet e nevojshme për të siguruar që rrobat e tyre personale të mbahen në kushte të mira dhe të përshtatshme për përdorim.

24. Secilit të burgosur do t'i sigurohet një krevat i veçantë dhe mbulesa të veçanta e të përshtatshme, të cilat do të mbahen në gjendje të mirë dhe të ndërrohen aq shpesh sa është e nevojshme për të siguruar pastërtinë e tyre.

Ushqimi

25. 1. Administrata, në përputhje me standartet e parashtruara nga autoritetet shëndetësore, do t'u sigurojë të burgosurve në periudha normale ushqim të gatuar në mënyrë të përshtatshme, që plotëson standartet e cilësisë dhe sasisë për dietetikët dhe higjienën moderne dhe merr parasysh moshën e shëndetin e tyre, natyrën e punës së tyre, dhe për aq sa është e mundur, kërkesat fetare ose kulturore.

2. Secilit të burgosur do t'i sigurohet ujë i pijshëm

Shërbimet mjekësore

- 26.** 1. Në çdo institucion do të ketë në dispozicion shërbime të paktën të një mjeku me kualifikim të përgjithshëm. Shërbimet mjekësore duhet të organizohen në lidhje të ngushtë me administrimin e përgjithshëm shëndetësor të komunitetit ose të vendit. Ato do të përfshijnë një shërbim psikiatrik për diagnostifikim dhe, në raste të përshtatshme, trajtimin e gjendjeve mendore jonormale.
2. Të burgosurit e sëmurë që kërkojnë një trajtim të specialitetit do të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile. Kur lehtësitë spitalore janë siguruar në një institucion, mjetet e orënditë e tyre dhe pajisjet farmaceutike do të jenë të përshtatshme për kujdesin mjekësor dhe trajtimin e të burgosurve të sëmurë dhe do të ketë një personel prej specialistësh të kualifikuar siç duhet.
3. Secili i burgosur do të ketë në dispozicion shërbimet e specialistit të kualifikuar dentar.
- 27.** Të burgosurit nuk duhet t'i nënshtrohen ndonjë eksperimenti që mund të shkaktojë dëmtim fizik ose moral.
- 28.** 1. Kurdoherë që është e mundur praktikisht, duhen bërë rregullimet e duhura që fëmijët të lindin në një spital jashtë institucionit. Megjithatë, nëse nuk janë bërë rregullimet e veçanta, në institucionet penale do të ketë personel dhe kushte strehimi të nevojshme për lindjen dhe kujdesin pas lindjes të grave shtatzëna. Në qoftë se një fëmijë lind në burg, ky fakt nuk do të përmendet në çertifikatën e lindjes.
2. Kur lejohet që foshnjat të qëndrojnë në institucion me nënat e tyre, duhet siguruar në mënyrë të veçantë një çerdhe me personel të kualifikuar, ku do të vendosen foshnjat kur ata nuk janë në kujdesin e nënave të tyre.
- 29.** Mjeku do të vizitojë dhe ekzaminojë secilin të burgosur menjëherë pas pranimit dhe më vonë sa herë të jetë e nevojshme, në mënyrë të veçantë për të zbuluar sëmundje fizike ose mendore dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin mjekësor; veçimin e të burgosurve që dyshohen për kushte infektuese ose ngjitëse; konstatimin e të metave fizike ose mendore që mund të pengojnë riintegrimin e tyre pas lirimit; dhe përcaktimin e gjendjes shëndetësore për punë të çdo të burgosuri.
- 30.** 1. Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të të burgosurve dhe, në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje ose dëmtim dhe çdo të burgosur, të cilit i kushtohet një vëmendje e veçantë.
2. Mjeku do t'i raportojë drejtorit kurdoherë që mendon se gjendja fizike e mendore e një të burgosuri është keqësuar ose do të keqësohet nga vazhdimi i burgosjes ose nga ndonjë kusht i saj.
- 31.** 1. Mjeku ose një autoritet kompetent do të kontrollojë dhe këshillojë rregullisht drejtorin për:
- a. sasinë, cilësinë, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit dhe ujit;
 - b. higjienën dhe pastërtinë e institucionit dhe burgjeve;

- c. kushtet sanitare, ngrohjen, ndriçimin dhe ajrimin e institucionit;
- d. gjendjen dhe pastërtinë e veshjes dhe mbulesave të të burgosurve.

2. Drejtori do të shqyrtojë raportet dhe këshillat që i paraqet mjeku sipas Rregullave 30, paragrafi 2 dhe 31, paragrafi 1, dhe kur është në përputhje me rekomandimet e bëra, do të marrë masa të menjëhershme për të zbatuar këto rekomandime; në qoftë se ato nuk janë në kompetencë të drejtorit ose në qoftë se drejtori nuk është i një mendimi me to, ai do t'i paraqes menjëherë një raport personal dhe këshillat e mjekut një autoriteti më të lartë.

32. Shërbimet mjekësore të institucionit do të kërkojnë që të diagnostikojnë e kurojnë çdo sëmundje ose të metë fizike e mendore që mund të pengojë riintegrimin e një të burgosuri pas lirit. Për këtë qëllim, të burgosurit do t'i sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psikiatrike, përfshirë ato që janë në dispozicion të komunitetit.

Disiplina dhe ndëshkimi

33. Disiplina dhe rregulli do të mbahen në interes të mbikëqyrjes së sigurtë, jetës së disiplinuar të komunitetit dhe objektivave të trajtimit në institucion.

- 34.** 1. Asnjë i burgosur nuk do të vihet të punojë në shërbim të institucionit për arsye disiplinore.
2. Megjithatë, ky rregull nuk do të pengojë zbatimin në mënyrën e duhur të marrëveshjeve, sipas të cilave të burgosurit të organizuar në grupe, kanë marrë përsipër organizimin e aktiviteteve ose angazhimeve të përcaktuara shoqërore, edukative ose sportive që i shërbejnë qëllimeve të pjesëmarrjes së tyre në programet e regjimit.

35. Legjislacioni ose rregullat e autoriteteve kompetente do të parashikojnë dhe përcaktojnë sa më poshtë:

- a. sjelljen që përbën një shkelje disiplinore;
- b. llojet dhe kohëzgjatjen e dënimit që mund të jepet;
- c. autoritetin kompetent që jep këto dënime;
- d. mundësinë dhe autoritetin për t'iu drejtuar procedurës së ankimit.

- 36.** 1. Asnjë i burgosur nuk do të dënohet përveçse në përputhje me kushtet e këtyre ligjeve ose rregullave, dhe kurrë dy herë për të njëjtin veprim.
2. Raportet mbi shkeljet do t'i paraqiten menjëherë autoritetit kompetent, i cili do të vendosë për to pa vonesë.
3. Asnjë i burgosur nuk do të dënohet pa u informuar për shkeljen që akuzohet dhe pa iu dhënë një mundësi e përshtatshme për të paraqitur mbrojtjen.
4. Kur është e nevojshme dhe e mundshme praktikisht, të burgosurit do t'i lejohet mbrojtja me ndihmën e një përkthyesi.

37. Do të ndalohen plotësisht si dënime për shkelje disiplinore dënimet kolektive, trupore, vendosja në qeli të errëta dhe të gjithë dënimet mizore, çnjerëzore ose degraduese.

- 38.** 1. Dënimi me izolim disiplinor dhe çdo dënim tjetër që mund të dëmtojë gjendjen fizike dhe psikike të të burgosurit do të jepen vetëm në qoftë se mjeku vërteton me shkrim, pas ekzaminimit, se i burgosuri është në gjendje ta përballojë atë.
2. Këto dënime nuk duhet të jenë në asnjë rast në kundërshtim ose në shkelje të parimeve të parashikuara në Rregullin 37.
3. Mjeku do të vizitojë përditë të burgosurit që vuajnë këto dënime dhe do të këshillojë drejtorin për ndërprerjen ose ndryshimin e dënimit nëse kjo shihet e nevojshme në bazë të gjendjes fizike ose mendore.

Instrumentet e shtrëngimit

39. Përdorimi i zinxhirëve dhe hekurave do të ndalohet. Nuk do të zbatohen kurrë si dënime prangat, xhaketat kufizuese dhe kufizime të tjera trupore. Ato mund të përdoren vetëm në rrethanat e mëposhtme:

- a. nëse shihet e nevojshme si një masë paraprake për të mos lejuar largimin gjatë një transferimi, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri paraqitet para një autoriteti gjyqësor ose administrative, përveçse kur ky autoritet vendos ndryshe;
- b. për arsye mjekësore, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e mjekut;
- c. me urdhër të drejtorit, në qoftë se metodat e tjera të kontrollit nuk japin rezultat, me qëllim që ta mbrojnë një të burgosur nga vetëdënimi, dëmtimi nga të tjerët ose për të ndaluar dëmtimin e rëndë të pasurisë; në këto raste drejtori do të konsultohet menjëherë me mjekun dhe do t'i raportojë autoritetit më të lartë administrativ.

40. Modelet dhe mënyra e përdorimit të instrumenteve të shtrëngimit, të autorizuara në paragrafin e mësipërm do të caktohet me ligj dhe rregullore. Këto instrumente nuk duhet të zbatohen për një periudhë më të gjatë se sa është e nevojshme.

Informimi dhe ankesat e të burgosurve

- 41.** 1. Secilit të burgosur, pasi të pranohet do t'i sigurohet një informacion me shkrim mbi rregullat e trajtimit të të burgosurve të kategorisë përkatëse, kërkesat disiplinore të institucionit, metodat për kërkimin e informacionit dhe paraqitjen e ankesave, dhe të gjithë ato çështje që janë të nevojshme për të kuptuar të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve dhe për t'iu përshtatur jetës së institucionit.
2. Në qoftë se një i burgosur nuk mund të kuptojë informacionin me shkrim që i është siguruar, ky informacion do t'i shpjegohet gojarisht.
- 42.** 1. Secili i burgosur do të ketë çdo ditë mundësinë për t'i paraqitur kërkesa ose ankesa drejtorit të institucionit ose zyrtarit të autorizuar për të vepruar me këtë cilësi.
2. I burgosuri do të ketë mundësinë për të biseduar, për t'i paraqitur kërkesa ose ankesa inspektorit të burgjeve ose një personi tjetër të autorizuar për të vizituar burgun, pa u shoqëruar nga drejtori ose anëtarë të tjerë të personelit. Megjithatë, ankesat kundër vendimeve zyrtare duhet të paraqiten nëpërmjet procedurave të autorizuara.

3. Secilit të burgosur do t'i lejohet që të paraqesë në mënyrë konfidenciale kërkesa ose ankesa në administratën qendrore të burgut, autoritetet gjyqësore ose autoritete të tjera përkatëse.
4. Autoriteti i burgut do të shqyrtojë menjëherë çdo kërkesë apo ankese që i drejtohet ose referohet dhe do t'u përgjigjet pa vonesë.

Kontakti me botën e jashtme

43. 1. Të burgosurve do t'u lejohet komunikimi me familjet e tyre, dhe në varësi të nevojave të trajtimit, sigurisë dhe rendit, me persona ose përfaqësues të organizatave të ndryshme dhe të presin vizita nga këta persona aq shpesh sa është e mundur.
2. Për inkurajimin e kontaktit me botën e jashtme do të ketë një sistem leje burgu në përputhje me objektivat e trajtimit në pjesën IV të këtyre rregullave.
44. 1. Të burgosurit që janë shtetas të huaj të informohen pa vonesë për të drejtën e tyre për të kërkuar kontakt dhe për t'u dhënë lehtësitë e arsyeshme për komunikim me përfaqësuesin diplomatik ose konsullor të shtetit, të cilit ai i përket. Administrata e burgut duhet të bashkëpunojë plotësisht me këta përfaqësues në interes të shtetasve të huaj në burg, që mund të kenë nevoja të veçanta.
2. Të burgosurve që janë shtetas të shteteve që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në atë vend dhe refugjatë ose persona pa shtetësi, do t'iu jepen të njëjtat lehtësi për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatik të shtetit që merr përsipër interesat e tyre, autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar që ka për detyrë t'iu shërbejë interesave të këtyre personave.
45. Të burgosurve do t'iu lejohet mundësia për t'u informuar rregullisht për lajmet, nëpërmjet leximit të gazetave, periodikëve dhe botimeve të tjera, transmetimeve të radios ose televizionit, leksioneve ose nëpërmjet mënyrave të njëjta të autorizuar ose kontrolluara nga administrata. Për të plotësuar nevojat e shtetasve të huaj që kanë vështirësi me gjuhën duhet të bëhen rregullime të veçanta.

Ndihma fetare e morale

46. Secilit të burgosur do t'i lejohet, për aq sa është e mundur praktikisht, që të plotësojë nevojat e jetës së tij fetare, shpirtërore dhe morale, duke ndjekur shërbimet ose takimet që organizohen në institucion dhe duke mbajtur libra ose literaturën e nevojshme.
47. 1. Në qoftë se në një institucion gjendet një numër i mjaftueshëm i të burgosurve të të njëjtit besim, do të caktohet dhe miratohet një përfaqësues i kualifikuar i këtij besimi. Ky rregullim duhet të bëhet mbi një bazë të përherëshme në qoftë se justifikohet nga numri i të burgosurve dhe nëse lejohet nga kushtet konkrete.
2. Përfaqësuesit të kualifikuar, që është caktuar apo miratuar sipas paragrafit 1, do t'i lejohet që të organizojë shërbime dhe aktivitete të rregullta dhe t'u bëjë vizita pastorale private të burgosurve të besimit të tij në kohë të përshtatshme.
3. Përfaqësuesit të kualifikuar të çdo besimi nuk do t'i refuzohet kontakti me asnjë të burgosur. Në qoftë se ndonjë i burgosur do të kundërshtojë një vizitë nga përfaqësuesi fetar, këtij të burgosuri do t'i lejohet që t'a refuzojë atë.

Ruajtja e pasurisë së të burgosurve

48. 1. Të gjitha kartëmonedhat, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera që u përkasin të burgosurve, të cilat sipas rregullave të institucionit nuk lejohen të mbahen, pas pranimit në institucion do të vendosen në ruajtje të sigurtë. Inventari do të nënshkruhet nga i burgosuri. Për mbajtjen e tyre në kushte të mira do të merren masat përkatëse. Nëse konsiderohet e nevojshme për të asgjësuar ndonjë send, kjo do të mbahet shënim dhe të informohet i burgosuri.
2. Pas liritimit, të burgosurit do t'i kthehen të gjitha këto sende dhe kartëmonedha, me përjashtim të kartëmonedhave që janë tërhequr me autorizim, ose të asaj pasurie që është nxjerrë jashtë institucionit me autorizim, ose të ndonjë sendi që është konstatuar e nevojshme për t'u shkatërruar për arsye higjienike. I burgosuri do të nënshkruajë një dokument për marrjen e sendeve dhe kartëmonedhave të kthyera.
3. Çdo kartëmonedhë ose pasuri që i vjen një të burgosuri nga jashtë do të trajtohet për aq sa është e mundur në të njëjtën mënyrë, në qoftë se nuk ka për qëllim ose lejohet të përdoret gjatë burgosjes.
4. Në qoftë se një i burgosur sjell ilaçe, mjeku do të vendosë mbi përdorimin e tyre.

Njoftimi për vdekje, sëmundje, transferim, etj.

49. 1. Në rast vdekje, sëmundje të rëndë ose dëmtimi serioz të një të burgosuri ose dërgimit të tij në një institucion për t'u kuruar për sëmundje mendore, drejtori do të informojë menjëherë bashkëshorten, në qoftë se i burgosuri është i martuar, ose kushëririn e tij më të afërt dhe do të informojë për çdo ngjarje çdo person tjetër të caktuar më pare nga i burgosuri.
2. I burgosuri do të informohet menjëherë për vdekjen ose sëmundjen e rëndë të të afërmeve të tij. Në këto raste dhe kurdoherë, që e lejojnë rrethanat, i burgosuri do të autorizohet, që ose i shoqëruar ose i vetëm, të vizitojë të afërmin e sëmurë ose të shikojë të vdekurin.
3. Të gjithë të burgosurit do të kenë të drejtë të informojnë menjëherë familjet e tyre për burgosjen ose transferimin në një institucion tjetër.

Zhvendosja e të burgosurve

50. 1. Zhvendosja e të burgosurve nga institucioni do të bëhet në një mënyrë që të jetë sa më pak e njohur nga publiku, dhe do të sigurohen garancitë e duhura për t'i mbrojtur ata nga çdo formë fyerje, kurioziteti ose publikimi.
2. Do të ndalohet transportimi i të burgosurve me mjete transporti që nuk kanë ndriçim dhe ventilim të përshtatshëm, ose që në ndonjë mënyrë mund t'i verë ata para vuajtjeve fizike dhe poshtërimit të panevojshëm.
3. Transportimi i të burgosurve do të kryhet me shpenzimet e administratës dhe në përputhje me rregullat përkatëse të autorizuar.

PJESA III

PERSONELI

51. Duke pasur parasysh rëndësinë themelore që ka personeli i burgut për administrimin siç duhet të institucioneve dhe arritjen e objektivave të tyre lidhur me organizimin dhe trajtimin, administratave të burgut do t'iu jepet prioritet i madh për plotësimin e rregullave mbi personelin.

52. Personeli i burgut do të nxitet vazhdimisht nëpërmjet kualifikimit, procedurave të konsultimit dhe një stili pozitiv administrimi që të aspirojë për standarte humane, efikasitet më të lartë dhe qëndrim me përgjegjësi ndaj detyrave të tyre.

53. Administrata e burgut do të konsiderojë si një detyrë të rëndësishme të saj që të informojë vazhdimisht opinionin publik për rolin e sistemit të burgut dhe punën e personelit, me qëllim që të nxisë një mirëkuptim publik për rëndësinë e kontributit të tyre në shoqëri.

54. 1. Administrata e burgut do të marrë masa për një përzgjedhje të kujdesshme gjatë rekrutimit ose emërimeve të mëvonshme të të gjithë personelit. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet ndershmërisë, humanizmit, aftësisë profesionale dhe cilësive të tyre personale për punë.

2. Normalisht, personeli do të caktohet mbi një bazë të përhershme si personel profesional burgu dhe do të ketë një status shërbimi civil me afat shërbimi të sigurtë, që kushtëzohet vetëm nga sjellja e mirë, efikasiteti, gjendja e mirë fizike e mendore dhe një nivel i përshtatshëm arsimimi. Pagat do të jenë të mjaftueshme për të nxitur interesin e burrave dhe grave me cilësitë e duhura për t'u angazhuar me këtë punë; përfitimet e punësimit dhe kushtet e shërbimit do të jenë të favorshme për sa i përket natyrës ekzakte të punës.

3. Kurdoherë që është e nevojshme për të punësuar personel të përkohshëm, ndaj tyre do të zbatohen po këto kritere për aq sa është e përshtatshme.

55. 1. Pas rekrutimit ose një periudhe të përshtatshme të eksperiencës praktike, personeli do të ndjekë një kurs kualifikimi mbi detyrat e tyre të përgjithshme me të veçanta dhe do të kalojë teste teorike dhe praktike, me përjashtim të rastit kur cilësitë e tyre profesionale e bëjnë këtë të panevojshme.

2. I gjithë personeli, gjatë gjithë karrierës, do të ruajë dhe përmirësojë njohuritë e tyre dhe aftësitë profesionale nëpërmjet pjesëmarrjes në kurse kualifikimi mbi shërbimin, që do të organizohen nga administrata në intervale të përshtatshme.

3. Për atë pjesë të personelit, cilësitë profesionale të të cilit duhen përmirësuar akoma më tej, do të merren masa për të organizuar një eksperiencë dhe kualifikim më të gjerë.

4. Kualifikimi i të gjithë personelit duhet të përfshijë udhëzimin mbi kërkesat dhe zbatimin e Rregullave Evropiane të Burgut dhe Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut.

56. Të gjithë anëtarët e personelit duhet që në çdo kohë të sillen dhe të përmbushin detyrat e tyre në atë mënyrë që të ndikojnë pozitivisht mbi të burgosurit me shembullin e tyre dhe t'iu imponojnë respektin e tyre.

- 57.** 1. Personeli do të përbëhet për aq sa është e mundur nga një numër i mjaftueshëm specialistësh, të tillë si psikiatër, psikologë, punonjës shoqërorë, mësues, instruktorë, profesionistë edukimi fizik e sportive.
2. Këta dhe personeli tjetër specialistë do të punësohen normalisht mbi një bazë të përhershme. Kjo nuk do të pengojë punëtorët e përkohshëm ose vullnetarë, kur kjo shihet e nevojshme dhe me interes për mbështetjen dhe kualifikimin që ata mund të sigurojnë.
- 58.** 1. Administrata e burgut do të sigurojë që çdo institucion të jetë në çdo kohë nën drejtimin e drejtorit, nëndrejtorit ose zyrtarit tjetër të autorizuar.
2. Drejtori i një institucioni duhet të ketë cilësitë e përshtatshme për atë post për nga karakteri, aftësia administrative, kualifikimi dhe eksperiencia e duhur profesionale.
3. Drejtori do të caktohet për një mandat të plotë dhe do të jetë në dispozicion siç kërkohet nga administrata e burgut në udhëzimet e saj të drejtimit.
4. Kur dy ose më shumë institucione janë nën varësinë e një drejtori, secili prej tyre do të vizitohet në intervale të shpeshta. Secili prej këtyre institucioneve do të jetë nën drejtimin e një zyrtari përgjegjës.
- 59.** Administrata do të paraqesë forma organizimi dhe sisteme drejtimi për të lehtësuar komunikimin ndërmjet kategorive të ndryshme të personelit në një institucion, me qëllim që të sigurojë bashkëpunim midis shërbimeve të ndryshme, në veçanti lidhur me trajtimin dhe riintegrimin e të burgosurve.
- 60.** 1. Drejtori, nëndrejtori dhe shumica e personelit tjetër të institucionit do të jenë të aftë të flasin gjuhën e numrit më të madh të të burgosurve, ose një gjuhë që kuptohet nga numri më i madh i tyre.
2. Kurdoherë që është e nevojshme dhe praktike do të përdoret shërbimi i përkthyesit.
- 61.** 1. Do të merren masat për të siguruar që gjithmonë në rastet e urgjencës të jetë i pranishëm një mjek i kualifikuar.
2. Në institucionet që nuk kanë një ose më shumë mjekë të përhershëm, do të bëhen rregullisht vizita nga mjekë të përhershëm ose personel i autorizuar nga shërbimi shëndetësor.
- 62.** Do të inkurajohet caktimi i personelit në institucione ose pjesë të institucioneve që strehojnë të burgosur të një seksi tjetër.
- 63.** 1. Personeli i institucioneve nuk do të përdorë forcën kundër të burgosurve, përveçse në vetëmbrojtje dhe në rastet e përpjekjeve për t'u larguar, ose rezistencës fizike aktive ose pasive kundër një urdhri të bazuar në ligj ose rregullore. Personeli që imponon forcën nuk duhet ta përdorë atë më shumë se ç'është domosdoshmërisht e nevojshme dhe duhet të raportojë menjëherë mbi incidentin tek drejtori i institucionit.
2. Personeli do të kualifikohet teknikisht në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të jetë në gjendje të mbajë nën kontroll të burgosurit agresivë.
3. Me përjashtim të rrethanave të veçanta, personeli që kryen detyrat duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit nuk duhet të jetë i armatosur. Për më tepër, personeli nuk duhet të pajiset në asnjë rrethanë me armë, përveç atyre që janë plotësisht të kualifikuar për përdorimin e tyre.

PJESA IV**OBJEKTIVAT DHE REGJIMI I TRAJTIMIT**

64. Burgosja, duke hequr lirinë, përbën një dënim në vetvete. Prandaj me përjashtime të vogla që justifikojnë veçimin ose ruajtjen e disiplinës, kushtet e burgosjes dhe regjimi i burgut nuk do të keqësojnë vuajtjet që ai përmban në vetvete.

65. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që regjimet e institucioneve synojnë dhe kanë rezultat që:

- a. të garantojnë që kushtet e jetës janë në përputhje me dinjitetin njerëzor dhe standartet e pranueshme në komunitet;
- b. të minimizojnë efektet e dëmshme të burgosjes dhe ndryshimet midis jetës së burgut dhe jetës në liri, të cilat priren të ulin dinjitetin apo sensin e përgjegjësisë personale të të burgosurve;
- c. të mbajnë dhe fuqizojnë ato lidhje me të afërmit dhe komunitetin e jashtëm që do të nxisin interesat më të mira të të burgosurve dhe familjeve të tyre;
- d. t'u sigurojnë të burgosurve mundësitë për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet që do të përmirësojnë perspektivat e tyre për një integrim të suksesshëm pas lirim.

66. Për këtë qëllim do të vihen në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme riedukuese arsimore, morale, shpirtërore e të tjera, të cilat do të përdoren në përputhje me nevojat e trajtimit individual të të burgosurve. Regjimet do të përfshijnë:

- a. përkrahjen morale, udhëzimin dhe mundësitë për punën përkatëse, udhëzimin dhe kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, aktivitetet e përbashkëta dhe argëtuese;
- b. masat për të siguruar që këto aktivitete janë organizuar, për aq sa është e mundur, për të shtuar kontaktet me komunitetin e jashtëm dhe mundësitë brenda tij, në mënyrë që të zgjerojnë perspektivat për riintegrimin shoqëror pas lirim;
- c. procedurat për vendosjen dhe shqyrtimin e programeve të trajtimit dhe kualifikimit individual për të burgosurit, pas konsultimeve midis personelit përkatës dhe të burgosurit individual, të cilat do të përfshihen në to, për aq sa është e mundur;
- d. sistemet e komunikimit dhe një stil drejtimi që do të inkurajojë marrëdhënie të përshtatshme dhe pozitive midis personelit dhe të burgosurve, që do të përmirësojnë perspektivat për programet efektive dhe përkrahëse të regjimeve dhe trajtimit.

67. 1. Duke qenë se plotësimi i këtyre objektivave kërkon individualizimin e trajtimit, dhe për këtë qëllim, një sistem fleksibël të shpërndarjes, të burgosurit duhet të vendosen në institucione ose njësi të veçanta, ku secili prej tyre mund të ketë trajtimin dhe kualifikimin e përshtatshëm.

2. Lloji, masa, organizimi dhe aftësia e këtyre institucioneve ose njërive duhet të përcaktohet në radhë të parë nga natyra e trajtimit që do të sigurohet.
3. Është e nevojshme që të sigurohet se të burgosurit janë vendosur duke pasur siç duhet parasysh sigurinë dhe kontrollin, por këto masa duhet të jenë minimumi i përputhjes me sigurinë dhe të përfshijnë nevojat e veçanta të të burgosurit. Duhet

bërë çdo përpjekje për t'i vendosur të burgosurit në institucione që kanë karakter të hapur ose krijojnë mundësi të gjera për kontakte me komunitetin jashtë. Në rastin e shtetasve të huaj, do t'u kushtohet një rëndësi e veçantë lidhjeve me njerëzit e shtetësive të tyre në komunitetin e jashtëm.

68. Për secilin të burgosur që ka një dënim për një periudhë të përshtatshme, menjëherë pas pranimit dhe pasi të studiohet personaliteti i tij, do të përgatitet një program trajtimi në një institucion të përshtatshëm, në dritën e njohurive të fituara për nevojat, aftësitë e prirjet individuale, veçanërisht afërsisë me të afërmit.

69. 1. Të burgosurve do t'u jepet mundësi, brenda regjimit, të marrin pjesë në aktivitetet e institucionit që i ndihmojnë ata të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit dhe të nxisin interesin në trajtimin e tyre.

2. Duhet bërë përpjekje për të zhvilluar metodat e bashkëpunimit inkurajues dhe pjesëmarrjes së të burgosurve në regjimin e tyre. Për këtë qëllim, të burgosurit do të inkurajohen që të marrin përsipër, brenda kufijve të përcaktuar në Rregullin 34, përgjegjësi në një sërë sektorësh të aktivitetit të institucionit.

70. 1. Përgatitja e të burgosurve për lirim duhet të fillojë menjëherë pas pranimit në një institucion penal. Në këtë mënyrë, trajtimi i të burgosurve duhet të verë theksin jo në përjashtimin e tyre nga komuniteti, por pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme në të. Për këtë qëllim, kurdoherë që është e mundshme duhen angazhuar agjencitë e komunitetit dhe punonjësit shoqërorë për të ndihmuar personelin e institucionit në detyrën e rehabilitimit shoqëror të të burgosurve, veçanërisht duke ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet me familjet e tyre, me personat e tjerë dhe me agjencitë shoqërore. Duhet ndërmarrë hapa për të mbrojtur, në masën më të madhe të mundshme në përputhje me legjislacionin dhe dënimin, të drejtat e interesat e tyre civile, të drejtat e sigurimit shoqëror dhe përfitimet e tjera shoqërore të të burgosurve.

2. Programet e trajtimit duhet të përfshijnë dispozita mbi leje burgu, e cila duhet të jepet sa më shumë që të jetë e mundur për arsye mjekësore, edukative, profesionale, familjare dhe arsye të tjera shoqërore.

3. Shtetasit e huaj nuk duhet të përjashtohen nga rregullat për leje burgu vetëm për shkak të shtetësisë së tyre. Veç kësaj, duhet bërë çdo përpjekje për t'iu dhënë atyre mundësi për të marrë pjesë në aktivitetet e regjimit në mënyrë të përbashkët, me qëllim që të lehtësojnë ndjenjat e tyre të izolimit.

Puna

71. 1. Puna në burg duhet parë si një element pozitiv në trajtimin, kualifikimin dhe drejtimin institucional.

2. Të burgosurve të dënuar mund t'u kërkohet që të punojnë, në varësi të aftësive të tyre fizike e mendore, e përcaktuar nga mjeku.

3. Angazhimi normal në një punë të dobishme, ose nëse është e përshtatshme, aktivitetet e tjera të përcaktuara, do të jenë të tilla që t'i mbajnë të burgosurit të punësuar aktivisht për një ditë pune normale.

4. Angazhimi në punë duhet të jetë i tillë që të ruajë ose të rrisë sa më shumë që të jetë e mundur aftësinë e të burgosurit për të bërë një jetesë normale pas lirimit.
 5. Për të burgosurit që janë të aftë të përfitojnë dhe veçanërisht për të burgosurit e rinj do të sigurohet kualifikimi profesional në profesione të dobishme.
 6. Të burgosurit do të jenë në gjendje të zgjedhin llojin e punësimit në të cilin ata dëshirojnë të marrin pjesë brenda kufijve përkatës të përzgjedhjes profesionale të përshtatshme dhe kërkesave të administrimit dhe disiplinës së institucionit.
- 72.**
1. Organizimi dhe metodat e punës në institucione do të jenë sa më shumë që të jetë e mundur të përafërta me ato të punës përkatëse në komunitet, në mënyrë që t'i përgatisin të burgosurit për kushtet e jetës profesionale normale. Në këtë mënyrë, ato duhet të jenë në përputhje me standartet dhe teknikat bashkëkohore të punës dhe të organizuara për të funksionuar në sistemet moderne të administrimit dhe proceset e prodhimit.
 2. Interesat e të burgosurve dhe të trajtimit të tyre nuk duhet t'i nënshtrohen qëllimit të arritjes së përfitimit financiar, megjithëse ndjekja e këtij qëllimi në industrinë e institucioneve mund të jetë e vlefshme për rritjen e standarteve dhe përmirësimin e cilësisë dhe përkatësisë së kualifikimit.
- 73.**
1. Administrata e burgut do t'iu sigurojë të burgosurve punë:
 - a. ose në lokalet, punishtet dhe fermat e saj, ose:
 - b. në bashkëpunim me kontraktuesit private brenda apo jashtë institucionit, dhe në këto raste pagat e plota normale do të paguhen nga personat për të cilët është punuar, duke marrë parasysh prodhimin e të burgosurve.
- 74.**
1. Masat paraprake për sigurinë dhe shëndetin e të burgosurve do të jenë të njëjta me ato që zbatohen për punëtorët jashtë.
 2. Duhet parashikuar masa për dëmshpërblimin e të burgosurve kundër dëmtimit industrial, përfshirë sëmudjet profesionale, në kushte jo më pak të favorshme se sa ato që ligji u siguron punëtorëve jashtë.
- 75.**
1. Koha maksimale e punës ditore e javore e të burgosurve do të fiksohet në përputhje me rregullat ose zakonet lokale lidhur me punësimin e punëtorëve të lirë.
 2. Të burgosurit duhet të kenë të paktën një ditë pushim në javë dhe kohë të mjaftueshme për edukim dhe aktivitete të tjera që kërkohen si pjesë e trajtimit e kualifikimit të tyre për integrimin shoqëror.
- 76.**
1. Puna e të burgosurve do të shpërblehet mbi bazën e një sistemi të drejtë.
 2. Të burgosurve do t'u lejohet, sipas sistemit, që të shpenzojnë të paktën një pjesë të fitimeve të tyre për artikuj që lejohen për t'u përdorur dhe për t'iu dhënë një pjesë të fitimeve të tyre familjeve të tyre apo për qëllime të tjera të miratuara.
 3. Sistemi mund të lejojë gjithashtu që një pjesë e fitimeve të mbahet mënjane nga administrata, në mënyrë që të përbëjë një fond kursimi që t'i dorëzohet të burgosurit pas lirimit.

Edukimi

77. Në çdo institucion do të organizohet një program tërësor edukimi për të siguruar mundësi që të gjithë të burgosurit të plotësojnë të paktën disa prej nevojave dhe aspiratave të tyre individuale. Këto programe duhet të kenë si objektiva të tyre përmirësimin e perspektivave për riintegrimin e suksesshëm shoqëror, moral dhe qëndrimit të të burgosurve dhe respektimit të dinjitetit të tyre.

78. Edukimi duhet konsideruar si një aktivitet i regjimit që gëzon status të njëjtë dhe shpërblim bazë brenda regjimit njëlloj si puna, me kusht që ai të zhvillohet në kohën normale të punës dhe është pjesë e një programi të autorizuar për trajtimin individual.

79. Administrata e burgut duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë edukimit të të burgosurve të rinj, atyre me origjinë të huaj apo me nevoja të veçanta kulturore apo etnike.

80. Për të burgosurit me probleme të veçanta, si ata që nuk dinë të shkruajnë e llogarisin, duhet të organizohen programe të veçanta për edukim shtesë.

81. Edukimi i të burgosurve, për aq sa është e mundur praktikisht, do të:

- a. integrohet me sistemin arsimor të vendit, me qëllim që pas lirimit të tyre ata të mund të vazhdojnë pa vështirësi edukimin e tyre;
- b. zhvillohet në institucionet arsimore që ndodhen jashtë.

82. Çdo institucion do të ketë një bibliotekë për përdorim nga të gjithë kategoritë e të burgosurve, të pajisur në mënyrë të përshtatshme me një shumëllojshmëri të madhe të librave argëtues dhe udhëzues, dhe të burgosurit do të inkurajohen për t'i përdorur ata në mënyrë të plotë. Kurdoherë që është e mundur, bibliotekat e burgut duhet të organizohen në bashkëpunim me shërbimet e bibliotekave të komunitetit.

Edukimi fizik, ushtrimi, sporti dhe argëtimi

83. Regjimet e burgut do të njohin rëndësinë që kanë për shëndetin fizik dhe mendor aktivitetet e organizuara në mënyrën e duhur për të siguruar aftësi fizike, ushtrim të përshtatshëm dhe mundësi argëtuese.

84. Për këtë qëllim, brenda kuadrit dhe objektivave të regjimit të trajtimit dhe kualifikimit, duhet të organizohet një program i përshtatshëm i aktivitetit të edukimit fizik, sportit dhe argëtimeve të tjera. Për realizimin e tij duhen siguruar hapësira, instalimet dhe pajisjet.

85. Administratat e burgut duhet të sigurojnë që të burgosurit që marrin pjesë në këto programe të jenë të aftë fizikisht për një gjë të tillë. Sipas udhëzimeve të mjekut, duhen bërë organizime të veçanta për edukimin fizik dhe terapinë kuruese për ata të burgosur që kanë nevojë për to.

86. Secili i burgosur, që nuk është angazhuar në punën në natyrë, ose vendosur në një institucion të hapur, do të lejohet, nëse koha jep mundësi, të ketë të paktën një orë në ditë shëtitje ose ushtrim i përshtatshëm në natyrë, dhe për aq sa është e mundur në vende të mbrojtura nga moti i ashpër.

Përgatitja para lirim

87. Të gjithë të burgosurit duhet të përfitojnë nga rregullat që synojnë t'i ndihmojnë ata për t'u rikthyer në shoqëri, familje, jetë dhe punë pas lirim. Për këtë qëllim do të parashikohen procedura dhe kushte të veçanta.

88. Në rastin e atyre të burgosurve me dënime më të gjata, do të merren masa për të siguruar një kthim gradual në jetën e shoqërisë. Në veçanti, ky qëllim mund të arrihet nga një regjim para-lirimi i organizuar në të njëjtin institucion ose në një institucion tjetër të përshtatshëm, apo nga lirimi i kushtëzuar nën një lloj mbikëqyrje të kombinuar me përkrahje efikase shoqërore.

- 89.** 1. Administratat e burgut duhet të punojnë të lidhura ngushtë me shërbimet e agjencitë shoqërore që ndihmojnë të burgosurit e liruar për t'u riintegruar në shoqëri, në veçanti për sa i përket jetës familjare e punësimit.
2. Duhet marrë masa për të siguruar që pas lirim të burgosurit të pajisen, siç është e nevojshme, me dokumentet dhe kartat e identitetit të përshtatshme, dhe të ndihmohen për të gjetur shtëpi dhe punë të përshtatshme. Ata duhet të pajisen gjithashtu me mjete të domosdoshme jetese, me veshmbathje të duhura e të përshtatshme për të arritur në destinacionin e tyre.
3. Përfaqësuesve të miratuar të agjencive dhe shërbimeve shoqërore duhet t'u lejohet hyrja e nevojshme në institucione dhe kontakti me të burgosurit, me qëllim që të japin kontributin e tyre të plotë për përgatitjen e programeve të lirim dhe të kujdesit të mëvonshëm për të burgosurit.

PJESA V

RREGULLA SHITESË PËR KATEGORI TË VEÇANTA

90. Administratat e burgut duhet të udhëhiqen nga dispozitat e rregullave si një të tërë me qëllim që ata të mund të zbatohen siç duhet në praktikë në interes të atyre kategorive të veçanta të të burgosurve, për të cilët janë parashikuar rregullat shitesë të mëposhtme.

Të burgosurit e pagjykuar

91. Pa paragjykuar rregullat ligjore për mbrojtjen e lirisë individuale ose përshkruar procedurën që duhet zbatuar lidhur me të burgosurit e pagjykuar, këta të burgosur, që prezumohen si të pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia, do t'u sigurohen përfitimet që rrjedhin nga Rregulli 90 dhe të trajtohen pa kufizime, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për procedurën penale dhe sigurinë e institucionit.

- 92.** 1. Të burgosurit e pagjykuar do të lejohen të informojnë menjëherë familjet e tyre për ndalimin dhe do t'u jepen të gjitha lehtësitë e arsyeshme për të komunikuar me familjet, të afërmit dhe personat, të cilët kanë një interes të ligjshëm për të hyrë në kontakt.
2. Atyre do t'u lejohet gjithashtu të presin vizita prej tyre sipas kushteve humane që iu nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve dhe mbikëqyrjes, që janë të nevojshme për interesat e administrimit të drejtësisë, të sigurisë dhe ruajtjes së rendit në institucion.
3. Në qoftë se një person i pagjykuar nuk dëshiron të informojë ndonjë prej këtyre personave, administrata e burgut nuk duhet ta bëjë këtë gjë me iniciativën e saj, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta pozitive, si për shembull, moshën, gjendjen mendore ose ndonjë paaftësi tjetër e të burgosurit.
- 93.** Të burgosurit e pagjykuar do të kenë të drejtë, menjëherë pas burgosjes, që të zgjedhin një përfaqësues ligjor, ose do të lejohen të kërkojnë ndihmë ligjore të lirë kur u ofrohet kjo ndihmë dhe për të pritur vizita nga këshilltarë ligjorë për mbrojtjen e tyre, për të përgatitur dhe dorëzuar këshilltarit ligjor dhe për të marrë udhëzime konfidenciale. Atyre do t'u jepen të gjitha lehtësitë e nevojshme për këtë qëllim, nëse e kërkojnë. Në veçanti, atyre do t'u jepet ndihma e lire e një përkthyesi për të gjitha kontaktet e rëndësishme me administratën dhe për mbrojtjen e tyre. Bisedat ndërmjet të burgosurve dhe këshilltarëve të tyre ligjorë mund të vëzhgohen, por jo të përgjohen, si drejtpërdrejt ashtu edhe jo drejtpërdrejt, nga policia dhe personeli i institucionit. Të burgosurit e pagjykuar do të shpërndahen në përputhje me dispozitat e Rregullit 11, paragrafi 3.
- 94.** Të burgosurve të pagjykuar do t'u jepet mundësia të kenë dhoma të veçanta, me përjashtim të rasteve kur ka rrethana që e bëjnë një gjë të tillë të padëshirueshme.
- 95.** 1. Të burgosurve të pagjykuar do t'u jepet mundësia që të veshin rrobat e tyre, në qoftë se ato janë të pastra e të përshtatshme.
2. Të burgosurit që nuk mund të përfitojnë nga kjo mundësi do të pajisen me veshje të përshtatshme.
3. Në qoftë se nuk kanë veshje të tyre të përshtatshme, të burgosurit e pagjykuar do të pajisen me veshje civile që të jenë në gjendje të mire, për t'u paraqitur para gjykatës ose një organi të autorizuar.
- 96.** Të burgosurve të pagjykuar do t'u ofrohet, kurdoherë që është e mundur, mundësia për të punuar, por nuk do t'u kërkohet të punojnë. Ata që vendosin të punojnë do të paguhën si të burgosurit e tjerë. Në qoftë se është siguruar kualifikimi arsimor ose profesional, të burgosurit e pagjykuar do të inkurajohen që të përfitojnë nga këto mundësi.
- 97.** Të burgosurit e pagjykuar do të lejohen që të sigurojnë, me shpenzimet e tyre ose me shpenzimet e një pale të tretë, libra, gazeta, materiale me shkrim dhe literature për studim që është në përputhje me interesat e administrimit të drejtësisë, sigurisë dhe ruajtjes së rendit në institucion.

98. Të burgosurve të pagjykuar do t'u jepet mundësia të vizitohen dhe ekzaminohen nga mjeku ose dentisti i tyre, në qoftë se ka arsye të shëndosha për një kërkesë të tillë. Në rast se kërkesa refuzohet duhet të tregohen arsyet. Këto shpenzime, në rast se kryhen, nuk do të jenë në ngarkim të administratës së burgut.

Të burgosurit civilë

99. Në vendet ku legjislacioni lejon burgimin me vendim të gjykatës, sipas një procesi jopenal, personat që burgosen në këtë mënyrë nuk do t'i nënshtrohen kufizimit ose ashpërsisë më të madhe se sa është e nevojshme për të siguruar mbajtjen e sigurtë në arrest dhe ruajtjen e rendit. Trajtimi i tyre do të jetë i njëjtë me atë të burgosurve të pagjykuar, me rezervën se atyre mund t'u kërkohet të punojnë.

Të burgosurit e çmendur dhe me të meta mendore

- 100.**
1. Personat që konstatohen se janë të çmendur nuk do të mbahen në burg dhe do të bëhen rregullime të veçanta për t'i zhvendosur ata sa më shpejt që të jetë e mundur në vende të përshtatshme për sëmundje mendore.
 2. Për mbikëqyrjen e trajtimit të të burgosurve që vuajnë nga sëmundje ose të meta të rënda mendore, do të vihen në dispozicion institucione ose seksione të specializuara nën drejtimin mjekësor.
 3. Shërbimi mjekësor e psikiatrik i institucioneve penale do të sigurojë trajtimin psikik të të gjithë të burgosurve që kanë nevojë për një gjë të tillë.
 4. Në marrëveshje me agjencitë përkatëse të komunitetit, duhet të merren veprime për të siguruar, kur është e nevojshme, vazhdimin e trajtimit psikiatrik pas lirimit dhe kujdesit shoqëror psikiatrik.
-

KONVENTA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

Teksti i Konventës është amenduar në përputhje me dispozitat e protokollit n°3 (STE n°45), hyrë në fuqi më 21 shtator 1970, të protokollit n°5 (STE n°55), hyrë në fuqi më 20 dhjetor 1971 dhe të protokollit n°8 (STE n°118) hyrë në fuqi më 1 janar 1990, dhe përfshinte nga ana tjetër tekstin e Protokollit n°2 (STE n°44), që sipas nenit 5, paragrafi 3 bënte pjesë në Konventë që kur kishte hyri në fuqi, më 21 shtator 1970. Të gjitha dispozitat e amenduara apo të shtuara nga këto protokolle u zëvendësuan nga protokollit n°11 (STE n°155), që nga data e hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998. Duke filluar nga kjo datë, Protokollit n° 9 (STE n°140), hyrë në fuqi më 1 tetor 1994, është shfuqizuar.

Teksti i Konventës Nënshkruar në Romë me 4 nëntor 1950

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Europës;

Duke pasur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948;

Duke pasur parasysh se kjo Deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të;

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore;

Duke ripohuar përkushtimin e tyre të thellë ndaj këtyre lirive themelore që përbëjnë vetë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë dhe ruajtja e të cilave mbështetet kryesisht në një regjim politik me të vërtetë demokratik, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, në një koncept dhe një respekt të përbashkët për të drejtat e njeriut që ata kanë marrë përsipër të mbrojnë;

Duke qenë të vendosura, si qeveri të Shteteve evropiane që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një pasuri të përbashkët idealesh dhe traditash politike, të respektimit të lirisë dhe të epërsisë të së drejtës, për të marrë masat e para të përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale;

Janë marrë vesh sa vijon:

Neni 1 - Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Palët e Larta Kontraktuese i njohin çdo njeriu që përfshihet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin I të kësaj Konvente.

TITULLI I**TË DREJTAT DHE LIRITË****Neni 2 - E drejta për jetën**

E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Vdekja nuk mund t'i shkaktohet me qëllim kujtdoqoftë, me përjashtim të rastit të zbatimit të një vendimi kapital të dhënë nga një gjykatë, në rastin kur krimi ndëshkohet nga ligji me këtë dënim.

Vdekja nuk quhet e shaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo është pasojë e përdorimit të forcës i bërë absolutisht i domosdoshëm;

- a. për të siguruar mbrojtjen e çdo personi kundër dhunës së paligjshme;
- b. për të kryer një arrestim të rregullt ose për të penguar arratisjen e një personi ligjërisht të burgosur;
- c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një rebelim ose një kryengritje.

Neni 3 - Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri as në robëri.
2. Askush nuk mund të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.
3. Nuk quhet si “punë e imponuar me dhunë ose e detyruar”, në kuptimin e këtij neni:
 - a. çdo punë që i kërkohet normalisht një personi, të cilit i është hequr liria në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente, ose gjatë vënies së tij në liri me kusht;
 - b. çdo shërbim me karakter ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, një shërbim tjetër në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
 - c. çdo shërbim që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;
 - d. çdo punë ose shërbim që bën pjesë në detyrimet qytetare normale.

Neni 5 - E drejta për liri dhe siguri

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën ligjore:

- a. kur burgoset rregullisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
- b. kur arrestohet ose burgoset në mënyrë të rregullt për moszbatim të një urdhri të dhënë në përputhje me ligjin, nga një gjykatë, ose për të garantuar ekzekutimin e një detyrimi të parashkruar nga ligji;
- c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar që ai ka kryer një vepër

- penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të menduar për domosdoshmërinë për ta penguar që të kryejë një vepër penale ose për t'u larguar pas kryerjes së saj;
- d. kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një të mituri, të vendosur për edukimin e tij të mbikëqyrrur, ose për heqjen e rregullt të lirisë së tij me qëllim për ta çuar përpara autoritetit kompetent;
 - e. kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një personi të dyshuar se mund të përhapë një sëmundje ngjitëse, të një të çmenduri, të një alkooliku, të një toksikomani ose të një vagabondi;
 - f. kur është fjala për arrestimin ose burgimin e rregullt të një personi për të ndaluar hyrjen e tij të paligjshme në territor, ose kundër të cilit është në vijim një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë të drejtuar kundër tij.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur, në kushtet e parashikuara në paragrafin 1.c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një magjistrati tjetër të autorizuar me ligj që të ushtrojë funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit të interesuar përpara gjyqit.

4. Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim ka të drejtë të paraqesë një ankim përpara një gjykate me qëllim që kjo e 4 fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, viktimë e një arrestimi ose e një burgimi në kushte të kundërta me dispozitat e këtij neni, ka të drejtë për dëmshpërblim

Neni 6 - E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë të gjithë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralitetit, të rendit publik ose të sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkon këtë, ose në masën e gjykuar krejtësisht të domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të ishte i një natyre që do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar ka të drejtë pikërisht që:

- a) të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që bëhet kundër tij;

- b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c) të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d) të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të fitojë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve që e shfajësojnë, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 7 - Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që në çastin kur është kryer nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në çastin kur vepra ka qenë kryer.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi fajtor për një veprim ose një mosveprim, i cili në çastin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara.

Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.

2. Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si edhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose e bindjeve të tij nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 10 - Liria e shprehjes

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e

autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 11 - Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit, me të tjerë, të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj përbëjnë në një shoqëri demokratike, masat e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjestarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Neni 12 - E drejta për martesë

Që nga mosha e martesës, burri dhe gruaja kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Neni 13 - E drejta për ankim efektiv

Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qënë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

Neni 15 - Shmangiet në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

1. Në rast lufte, ose në rast të një rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që nuk u përmbahen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, vetëm për sa e kërkon situata dhe me kusht që këto masa të mos jenë në kundërshtim me detyrimet e tjera që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare.

2. Dispozita e mësipërme nuk autorizon asnjë shmangie nga neni 2, me përjashtim të rastit të vdekjes që rrjedh nga akte të lejueshme të luftës dhe nga nenet 3,4 (paragrafi 1) dhe 7.

3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ushtron këtë të drejtë shmangieje mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të gjitha masat e marra dhe arsyet që i kanë shkaktuar ato. Gjithashtu, ajo duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për datën në të cilën këto masa pushojnë së qeni në fuqi dhe dispozitat e Konventës vihen rishtazi plotësisht në zbatim.

Neni 16 - Kufizime të veprimtarisë politike të të huajve

Asnjë nga dispozitat e neneve 10, 11 dhe 14 nuk mund të konsiderohet sikur u ndalon Palëve të Larta Kontraktuese që t'i vënë kufizime veprimtarisë politike të të huajve.

Neni 17 - Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet sikur i jep një Shteti, një grupimi ose një individ, çfarëdo të drejte që të ndërmarrë një veprimtari ose të kryejë një akt që ka për qëllim zhdukjen e të drejtave ose të lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave se ato të parashikuara në Konventën në fjalë.

Neni 18 - Caku i kufizimeve të të drejtave

Kufizimet që, në bazë të kësaj Konvente, u bëhen të drejtave dhe lirive të lartpërmendura mund të zbatohen vetëm për qëllimin për të cilin janë parashikuar.

TITULLI II

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 19 - Krijimi i Gjykatës

Për të siguruar respektimin e zotimeve që rrjedhin për Palët e Larta Kontraktuese nga kjo Konventë dhe protokollet e saj, krijohet Gjykata evropiane e të Drejtave të Njeriut, tani e tutje e quajtur “Gjykata“. Ajo funksionon në mënyrë të përhershme.

Neni 20 - Numri i gjyqtarëve

Gjykata përbëhet nga një numër gjyqtarësh i barabartë me numrin e Palëve të Larta kontraktuese.

Neni 21 - Kushtet e ushtrimit të funksioneve

1. Gjyqtarët duhet të kenë karakter të lartë moral dhe të plotësojnë kushtet e kërkuara për ushtrimin e funksioneve më të larta gjyqësore ose të jenë juristë me kompetencë të shquar.

2. Gjyqtarët kanë vendin e vet në Gjykatë si individë.

3. Gjatë mandatit të tyre, gjyqtarët nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari që nuk pajtohet me kërkesat e pavarësisë, paanësisë ose të disponibilitetit për një veprimtari me kohë të plotë; çdo çështje që lidhet me zbatimin e këtij paragrafi zgjidhet nga Gjykata.

Neni 22 - Zgjedhja e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja parlamentare për çdo Palë të Lartë kontraktuese, me shumicën e votave të shprehura, mbi bazën e një liste prej tre kandidatësh të paraqitur nga Pala e Lartë kontraktuese.

2. E njëjta procedurë ndiqet për plotësimin e Gjykatës në rast aderimi të Palëve të Larta kontraktuese të reja dhe për plotësimin e vendeve të mbetura vakante.

Neni 23 - Kohëzgjatja e mandatit

1. Gjyqtarët zgjidhen për një kohë prej gjashtë vjetësh. Ata mund të rizgjidhen. Por, mandatet e gjysmës së gjyqtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbarojnë në fund të tre vjetëve.

2. Gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në fund të periudhës fillestare prej tre vjetësh caktohen me short nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, menjëherë pas zgjedhjes së tyre.

3. Për të siguruar, sa të jetë e mundur, përtëritjen e mandateve të gjysmës së gjyqtarëve çdo tre vjet, Asambleja parlamentare, para se të procedojë në çdo zgjedhje të mëpasme, mund të vendosë që një ose më shumë mandate të gjyqtarëve që do të zgjidhen, të ketë një kohëzgjatje të ndryshme nga ajo e gjashtë vjetëve, por jo më shumë se nëntë vjet dhe jo më pak se tre vjet.

4. Në rastet kur ka më shumë se një mandat dhe kur Asambleja parlamentare zbaton paragrafin e mësipërm, ndarja e mandateve bëhet me short nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës menjëherë pas zgjedhjes.

5. Gjyqtari i zgjedhur që zëvendëson gjyqtarin , të cilit nuk i ka mbaruar mandati merr mandatin e paraardhësit.

6. Mandati i gjyqtarëve mbaron kur ata mbushin moshën 70 vjeç.

7. Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë deri sa zëvendësohen. Ata vazhdojnë të merren me çështjet që u janë caktuar.

Neni 24 - Revokimi

Gjyqtari mund të largohet nga detyra vetëm kur gjyqtarët e tjerë vendosin me një shumicë dy të tretash, se ai nuk u përgjigjet më kushteve të kërkuara.

Neni 25 - Sekretaria dhe referentët

Gjykata ka një sekretari, detyrat dhe organizimi i së cilës caktohet me rregulloren e Gjykatës. Ajo ndihmohet nga referentët ligjorë.

Neni 26 - Mbledhja plenare e Gjykatës

Gjykata në mbledhje plenare:

- a) zgjedh, për një kohë prej tre vjetësh, kryetarin dhe një ose dy zëvendëskryetarë; ata mund të rizgjidhen;
- b) krijon Dhomat për një kohë të caktuar;
- c) zgjedh kryetarët e Dhomave të Gjykatës, të cilët mund të rizgjidhen;
- d) miraton rregulloren e Gjykatës dhe
- e) zgjedh sekretarin dhe një ose më shumë zëvendëssekretarë.

Neni 27 - Komitetet, Dhomat dhe Dhoma e Madhe

1. Për shqyrtimin e çështjeve që i paraqiten, Gjykata vepron me komitete prej tre gjyqtarësh, me dhoma prej gjashtë gjyqtarësh dhe me një Dhomë të Madhe prej gjashtëmbëdhjetë gjyqtarësh. Dhomat e Gjykatës krijojnë komitete për një periudhë të caktuar.

2. Gjyqtari i zgjedhur në emër të një Shteti Palë në gjykim është anëtar me të drejtë i Dhomës dhe i Dhomës së Madhe; në rast se ky gjyqtar mungon ose kur ai nuk mund të gjykojë, Shteti Palë cakton një person që merr pjesë si gjyqtar.

3. Bëjnë pjesë në Dhomën e Madhe edhe, Kryetari i Gjykatës, zëvendëskryetarët, kryetarët e Dhomave dhe gjyqtarë të tjerë të caktuar sipas rregullores së Gjykatës. Kur çështja i është shtruar Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43, asnjë gjyqtarë i Dhomës që ka dhënë vendimin nuk mund të marrë pjesë në të, me përjashtim të kryetarit të Dhomës dhe gjyqtarit që ka marrë pjesë në emër të Shtetit palë e interesuar.

Neni 28 - Deklarimi i papranueshmërisë nga komitetet

Një Komitet, me votë unanime, mund ta deklarojë të papranueshme ose ta çregjistrojë një kërkesë individuale të paraqitur në bazë të nenit 34, kur një vendim i tillë mund të merret pa ndonjë shqyrtim të mëtejshëm. Vendimi është përfundimtar.

Neni 29 - Vendimet e Dhomave për papranueshmërinë dhe themeltësinë

1. Në qoftë se asnjë vendim nuk mund të merret sipas nenit 28, një Dhomë shprehet për pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave individuale të paraqitura në bazë të nenit 34.

2. Një Dhomë shprehet për pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave të shteteve të paraqitura në bazë të nenit 33.

3. Përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe në raste përjashtimore, për pranueshmërinë merret vendim i veçantë.

Neni 30 - Dorëheqja nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe

Në qoftë se një çështje në gjykim para një Dhome paraqet një problem të rëndësishëm për interpretimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose kur zgjidhja e një çështjeje mund të çojë në një kundërshtim me një vendim të dhënë më parë nga Gjykata, Dhoma, derisa nuk e ka dhënë vendimin, mund të heqë dorë nga juridiksioni i saj në favor të Dhomës së Madhe, me kusht që njëra nga palët të mos ketë kundërshtim.

Neni 31 - Kompetencat e Dhomës së Madhe

Dhoma e Madhe:

- a) shprehet për kërkesat e paraqitura sipas nenit 33 ose nenit 34 kur çështja që i është kaluar nga Dhoma sipas nenit 30 ose kur çështja i është kaluar sipas nenit 43; dhe
- b) shqyrton kërkesat për këshillime të paraqitura në bazë të nenit 47.

Neni 32 – Kompetenca e Gjykatës

1. Kompetenca e Gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve të saj që i janë shtruar në kushtet e parashikuara në nenet 33, 34 dhe 47.

2. Në rast mosmarrëveshjes lidhur me kompetencën vendos Gjykata.

Neni 33 - Çështjet ndërshtetërore

Çdo Palë e Lartë kontraktuese mund t'i drejtohet Gjykatës për çdo shkelje të dispozitave të Konventës e të protokolleve të saj, për të cilat mendon se ka faj një Palë e Lartë kontraktuese tjetër.

Neni 34 - Kërkesat individuale

Gjykata mund të pranojë kërkesa nga çdo person fizik, çdo organizatë joqeveritare ose nga çdo grup individësh që pretendon se është viktimë e një shkeljeje nga një Palë e Lartë kontraktuese e të drejtave të njohura nga Konventa ose protokollet e saj. Palët e Larta kontraktuese zotohen të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

Neni 35 - Kushtet e pranueshmërisë

1. Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje përveçse kur janë shterur mjetet e brendshme juridike, ashtu siç kuptohen sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar, dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm.

2. Gjykata nuk pranon një kërkesë individuale të paraqitur sipas nenit 34 kur

- a) ajo është anonime; ose
- b) ajo është në thelb e njëjtë me një kërkesë të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është shtruar për zgjidhje një instance tjetër ndërkombëtare hetimore ose vendimore, dhe kur ajo nuk përmban fakte të reja.

3. Gjykata deklaron të papranueshme çdo kërkesë individuale të paraqitur në zbatim të nenit 34, kur çmon se kërkesa nuk pajtohet me dispozitat e Konventës ose të protokolleve të saj, është haptazi e pabazuar ose abuzive.

4. Gjykata rrëzon çdo kërkesë që e çmon si të papranueshme në zbatim të këtij neni. Ajo mund të vendosë në këtë mënyrë në çdo fazë të procedimit.

Neni 36 - Ndërhyrja e të tretit

1. Në çdo çështje para një Dhome ose Dhomës së Madhe, një Palë e Lartë kontraktuese, shtetasi i së cilës është kërkues, ka të drejtë të paraqesë vërejtje me shkrim dhe të marrë pjesë në seancat.

2. Në interes të mirëadministrimit të drejtësisë, kryetari i Gjykatës mund të ftojë çdo Palë të Lartë kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose çdo person të interesuar të ndryshëm nga kërkuesi, të paraqesë vërejtje me shkrim ose të marrë pjesë në seancat.

Neni 37 - Çregjistrimi

1. Në çdo moment të procedurës, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë kur rrethanat lejojnë të arrihet në përfundimin se:

a) kërkuesi nuk ka ndërmend ta ndjekë më çështjen; ose

b) mosmarrëveshja është zgjidhur; ose

c) për çdo arsye tjetër, ekzistencën e së cilës e konstaton Gjykata, nuk përlijet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës.

Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe Protokollet e saj.

2. Gjykata mund të vendosë reregjistrimin e një kërkesë kur çmon se e përlijin rrethanat.

Neni 38 - Shqyrtimi kontradiktor i çështjes dhe procedura e pajtimit

1. Kur Gjykata deklaron të pranueshme një kërkesë, ajo

a) vazhdon shqyrtimin kontradiktor të çështjes me përfaqësuesit e palëve dhe, kur është rasti, procedon nëpërmjet hetimit për zhvillimin efektiv të të cilit Shtetet e interesuara duhet të krijojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme;

b) vihet në dispozicion të të interesuarve për të arritur në një zgjidhje me pajtim të çështjes, duke u nisur nga respektimi i të drejtave të njeriut ashtu siç i njeh Konventa dhe protokollet e saj.

2. Procedura e përshkruar në paragrafin 1.b është konfidenciale.

Neni 39 - Përfundimi i zgjidhjes me pajtim

Në rast zgjidhjeje me pajtim, Gjykata e çregjistron çështjen me një vendim i cili kufizohet me një paraqitje të shkurtër të fakteve dhe me zgjidhjen e dhënë.

Neni 40 - Dëgjimi publik dhe e drejta për t'u njohur me dokumentet

1. Dëgjimi është publik përveçse kur Gjykata vendos ndryshe për shkak të rrethanave përjashtimore.
2. Dokumentet e depozituara në sekretari janë të hapura për publikun përveçse kur kryetari i Gjykatës vendos ndryshe.

Neni 41 - Shpërblimi i drejtë

Kur Gjykata deklaron shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe në qoftë se e drejta e brendshme e Palës së Lartë kontraktuese mundëson vetëm një mënjanim të pjesshëm të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, kur ka vend, i cakton palës së dëmtuar, një shpërblim të drejtë.

Neni 42 - Vendimet e Dhomave

Vendimet e Dhomave bëhen përfundimtare sipas dispozitave të nenit 44, paragrafi 2.

Neni 43 - Dërgimi në Dhomën e Madhe

1. Brenda një afati prej tre muajsh nga data e vendimit të themelit të një Dhome, çdo palë në çështje mund, në raste të veçanta, të kërkojë dërgimin e çështjes para Dhomës së Madhe.
2. Një koleg prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe e pranon kërkesën në qoftë se çështja ngre një problem të rëndësishëm për interpretimin ose zbatimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose një problem të rëndësishëm me karakter të përgjithshëm.
3. Kur kolegjii e pranon kërkesën, Dhoma e Madhe shprehet për çështjen me vendim.

Neni 44 - Vendimet përfundimtare

1. Vendimi i Dhomës së Madhe është përfundimtar;
2. Vendimi i një Dhome bëhet përfundimtar
 - a) kur palët deklarojnë se nuk do të kërkojnë dërgimin e çështjes para Dhomës së Madhe; ose
 - b) kur tre muaj pas datës së vendimit, dërgimi i çështjes para Dhomës së Madhe nuk është kërkuar; ose
 - c) kur kolegjii i Dhomës së Madhe e ka rrëzuar kërkesën për dërgim të formuluar në zbatim të nenit 43.
3. Vendimi përfundimtar shpallet publikisht.

Neni 45 - Arsyetimi i vendimeve

1. Vendimet, edhe ato që deklarojnë pranueshmërinë ose papranueshmërinë e kërkesave, arsyetohen.
2. Në qoftë se vendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht opinionin e njëzëshëm të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të bashkëngjisë parashtrësën e opinionit të tij të veçantë.

Neni 46 - Fuqia detyruese dhe zbatimi i vendimeve

1. Palët e Larta kontraktuese zotohen t'iu binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ata janë palë.
2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave i cili mbikëqyr zbatimin e tij.

Neni 47 – Mendime Konsultative

1. Gjykata, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, mund të hapë mendime konsultative për çështje juridike që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj.
2. Këto mendime nuk mund të jepen për çështje që kanë të bëjnë me përmbajtjen ose masën e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në titullin I të Konventës dhe në protokollin dhe as për çështje të tjera që Gjykata ose Komiteti i Ministrave mund të shqyrtojnë për shkak të paraqitjes së një rekursi të parashikuar nga Konventa.
3. Vendimi i Komitetit të Ministrave për t'iu kërkuar këshillë Gjykatës merret me votën e shumicës së përfaqësuesve që kanë të drejtë vendi në Komitet.

Neni 48 - Kompetenca konsultative e Gjykatës

Gjykata vendos nëse kërkesa për mendim konsultativ e paraqitur nga Komiteti i Ministrave hyn në kompetencën e saj siç është përcaktuar në nenin 47.

Neni 49 - Arsyetimi i mendimeve konsultative

1. Mendimi konsultativ i Gjykatës arsyetohet.
2. Në qoftë se mendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht opinionin e njëzëshëm të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të bashkëngjisë parashtrësën e opinionit të tij të veçantë.
3. Mendimi konsultativ i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave.

Neni 50 - Shpenzimet e funksionimit të Gjykatës

Shpenzimet e funksionimit të Gjykatës përballohen nga Këshilli i Evropës.

Neni 51 - Privilegjet dhe imunitetet e gjyqtarëve

Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në nenin 40 të statutit të Këshillit të Evropës dhe në marrëveshjet e lidhura në zbatim të këtij neni.

TITULLI III

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 52 - Hetimet e Sekretarit të Përgjithshëm

Çdo Palë e Lartë kontraktuese do të japë, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, shpjegimet e kërkuara mbi mënyrën në të cilën e drejta e saj e brendshme siguron zbatimin efektiv të të gjitha dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 53 - Mbrojtja e të drejtave të njohura të njeriut kur ato njihen

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk do të interpretohet si kufizuese ose cënuese e të drejtave të njeriut dhe e lirive themelore që do të mund të njihen në përputhje me ligjet e çdo Pale kontraktuese ose me çdo Konventë tjetër në të cilën kjo Palë kontraktuese është palë.

Neni 54 - Kompetencat e Komitetit të Ministrave

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk cënon kompetencat që i janë njohur Komitetit të Ministrave nga Statuti i Këshillit të Evropës.

Neni 55 - Dorëheqja dhe mënyra të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Palët e Larta kontraktuese heqin dorë reciprokisht, me përjashtim të rastit të një kompromisi të posaçëm, nga përfitimi prej traktateve, konventave ose deklaratave që ekzistojnë midis tyre, për të zgjidhur me anë të një ankimi, një mosmarrëveshje të lindur nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Konvente, në mënyrë të ndryshme nga ajo e parashikuar nga Konventa në fjalë.

Neni 56 - Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet mund, në çastin e ratifikimit ose në çdo çast tjetër të mëvonshëm, të deklarojë me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se kjo Konventë do të zbatohet me rezervën e paragrafit 4 të këtij neni, për të gjithë territoret ose për njërin çfarëdo nga territoret, marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ai i siguron.

2. Konventa do të zbatohet për territorin ose territoret e caktuara në njoftim tridhjetë ditë pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të ketë marrë këtë njoftim.

3. Në territoret e lartpërmendur dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen duke marrë parasysh nevojat lokale.

4. Çdo Shtet i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, mund, në çdo çast të mëvonshëm, të deklarojë përsa u përket një ose disa territoreve të përmendur në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve të personave fizikë, të organizatave jo qeveritare ose të grupeve të individëve në përputhje me nenin 34 të kësaj Konvente.

Neni 57 - Rezervat

1. Çdo shtet mund, në çastin e nënshkrimit të Kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të formulojë ndonjë rezervë në lidhje me një dispozitë të veçantë të Konventës, përderisa një ligj në fuqi në atë kohë në territorin e tij nuk është në përputhje me këtë dispozitë. Rezervat me karakter të përgjithshëm nuk janë të autorizuara sipas këtij neni.

2. Çdo rezervë e bërë në përputhje me këtë nen duhet të përmbajë një paraqitje të shkurtër të ligjit në fjalë.

Neni 58 – Denoncimi

1. Një Palë e Lartë kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë vetëm pas kalimit të pesë vjetëve nga data e hyrjes së Konventës në fuqi për këtë palë dhe me një paralajmërim prej gjashtë muaj, të bërë me një njoftim të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili informon Palët e tjera kontraktuese.

2. Ky denoncim nuk mund të ketë për efekt të lirojë Palën e Lartë Kontraktuese në fjalë nga detyrimet e përmbajtura në këtë Konventë lidhur me çdo fakt që, po të përbëjë shkelje të këtyre detyrimeve, që mund të jetë kryer nga ajo përpara datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm.

3. Me të njëjtën rezervë, çdo Palë kontraktuese që do të pushojë së qeni anëtare e Këshillit të Evropës, do të pushojë së qeni Palë në këtë Konventë.

4. Konventa mund të denoncohet në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mëparshëm përsa i përket çdo territori për të cilin ajo ka qenë deklaruar e zbatueshme në bazë të nenit 56.

Neni 59 - Nënshkrimi dhe ratifikimi

1. Kjo Konventë u paraqitet për nënshkrim Anëtarëve të Këshillit të Evropës. Ajo duhet të ratifikohet. Ratifikimet dorëzohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Kjo Konventë hyn në fuqi pas dorëzimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit.

3. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Konventa do të hyjë në fuqi që me dorëzimin e instrumentit të ratifikimit.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Anëtarët e Këshillit të Evropës për hyrjen në fuqi të Konventës, për emrat e Palëve të Larta kontraktuese që do ta ratifikojnë, si edhe për dorëzimin e mëvonshëm të çdo instrumenti të ratifikimit.

Bërë në Romë, më 4 nëntor 1950, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë të barazvlerëshme, në një ekzemplar të vetëm, i cili depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i komunikon një kopje të vërtetuar konform të gjithë nënshkruesve.

PROTOKOLLE TË KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE

PROTOKOLLI NR. 1

Paris, 20 mars 1952

Hyrja në fuqi, më 18 maj 1954

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të të drejtave dhe të lirive të tjera nga ato që figurojnë tashmë në Titullin I të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (e quajtur më poshtë “Konventa”),

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1 - Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose moral ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuar nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mësipërme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve që të vënë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.

Neni 2 - E drejta për arsim

Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Neni 3 - E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta kontraktuese angazhohen që të organizojnë, në intervale kohe të arsyeshme, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e trupit ligjvënës.

PROTOKOLLI NR. 4

Strasburg, 16 shtator 1963

Hyrja në fuqi, më 2 maj 1968

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të të drejtave dhe të lirive të tjera nga ato që figurojnë tashmë në Titullin I të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë,

më 4 nëntor 1950 (e quajtur më poshtë “Konventa”) dhe në nenet 1 deri 3 të Protokollit të parë shtojcë e Konventës, të nënshkruar në Paris më 20 mars 1952,

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1 - Ndalimi i burgimit për borxhe

Askujt nuk mund t’i hiqet liria për të vetmen arsye se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Neni 2 - Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të rregullt në territorin e një Shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.

3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të cilat, të parashikuar nga ligji, përbëjnë masa të domosdoshme, në një shoqëri demokratike, për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 3 - Ndalimi i dëbimit të shtetasve

1. Askush nuk mund të dëbohet, me anë të një mase individuale ose kolektive, nga territori i Shtetit, shtetas i të cilit ai është.

2. Askujt nuk mund t’i hiqet e drejta për të hyrë në territorin e Shtetit, shtetas i të cilit ai është.

Neni 4 - Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

Dëbimet kolektive të të huajve janë të ndaluara.

PROTOKOLLI NR. 6

Strasburg, 28 prill 1983

Hyrja në fuqi, më 1 mars 1985

Shtetet, Anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokollit të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (më poshtë e quajtur “Konventa”),

Duke marrë parasysh se zhvillimet e ndodhura në shumë shtete, anëtare të Këshillit të Evropës tregojnë një prirje të përgjithshme në favor të heqjes së dënimit me vdekje,

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1 - Heqja e dënimit me vdekje

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të ndëshkohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet.

Neni 2 - Dënimi me vdekje në kohë lufte

Një Shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për veprime të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky legjislacion dhe në përputhje me dispozitat që përfshin legjislacioni në fjalë.

Neni 3 - Ndalimi i çdo shmangieje

Asnjë shmangie nuk lejohet nga dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 57 të Konventës.

Neni 4 - Ndalimi i rezervave

Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 57 të Konventës.

PROTOKOLLI NR. 7

Strasburg, 22 nëntor 1984

Hyrja në fuqi, më 1 nëntor 1988

Shtetet, anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokolli, Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa të drejtave dhe lirive nga Konventa e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (e quajtur më poshtë “Konventa”),

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1 - Garancitë procedurale në rast dëbimi të të huajve

1. Një i huaj që ka rezidencë të rregullt në territorin e një Shteti nuk mund të dëbohet veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet t’i jepet mundësia:

- a) të vërë në dukje arsyet e vlefshme kundër dëbimit të tij,
- b) të kërkojë shqyrtimin e çështjes të tij, dhe
- c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa personave të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të radhitura në paragrafin 1, a, b dhe c të këtij neni kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose është bazuar mbi arsye të sigurimit kombëtar.

Neni 2 - E drejta e apelit në çështjet penale

1. Çdo person i deklaruar fajtor për një veprë penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj.

2. Kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta siç janë përcaktuar nga ligji, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose deklaruar fajtor dhe dënuar në vijim të një kundërshtimi kundër pafajësisë së tij.

Neni 3 - E drejta për zhdëmtim në rast gabimi gjyqësor

Kur një dënim penal përfundimtar është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon kryerjen e një gabimi gjyqësor, personi që ka pësuar dënimin për arsye të këtij dënimi zhdëmtohet, sipas ligjit ose zakonisht në fuqi në Shtetin në fjalë, me përjashtim të rastit kur është provuar se moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

Neni 4 - E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit Shtet për një veprë për të cilën ai është deklaruar më parë i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë, në rast se fakte të reja ose të zbuluar rishtazi, ose një ves themelor në procedurën e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të çënojnë vendimin e dhënë.

3. Asnjë shmangie nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.

Neni 5 - Barazia midis bashkëshortëve

Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisive me karakter civil midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe me zgjidhjen e saj. Ky nen nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.

Shënime shpjeguese për personat që dëshirojnë t'i drejtohen

GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT ME QENDËR NË STRASBURG - FRANCË

IV. CILAT JANË ÇËSHTJET QË MUND TË TRAJTOJË GJYKATA?

1. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një institucion ndërkombëtar që, sipas disa kushteve, mund të pranojë kërkesat e personave, të cilët ankohen për shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo Konventë është një marrëveshje nëpërmjet të cilit shumë shtete të Evropës janë angazhuar të respektojnë disa të drejta themelore të individëve. Këto të drejta janë formuluar në vetë Konventën, si edhe në disa Protokolle, të cilat një pjesë e shteteve i kanë nënshkruar. Ju rekomandohet të njiheni me këto tekste dhe me rezervat që shtetet kanë për nene të veçanta, të cilat janë pasqyruar në tabelat përkatëse në fund të këtij botimi.

2. Nëse ju vlerësoni që një prej Shteteve, lista e të cilëve është në fund të botimit, ka shkelur në dëmin tuaj një nga këto të drejta themelore, ju mund të ankoheni për shkeljen në Gjykatë. Kjo Gjykatë mund të trajtojë vetëm ankesat në lidhje me shkeljen e të drejtave të formuluar në Konventë dhe në Protokollin, duke përfshirë të gjitha shkeljet e tjera.

3. Gjykata e Strasburgut mund të pranojë kërkesa vetëm nëse ato drejtohen kundër njërit prej Shteteve, lista e të cilëve është më poshtë, dhe nëse ato kanë të bëjnë me ngjarje më të vona se data kur shteti ka ratifikuar (pranuar Konventën). Kjo datë ndryshon sipas Shtetit të paditur dhe sipas faktit nëse kërkesa përputhet me një të drejtë të formuluar në vetë Konventën, apo në një nga Protokollin. P.sh. ankesa ndaj Republikës së Shqipërisë mund të bëhen vetëm kur shkeljet e Konventës janë bërë pas datës 02.10.1996, kur Konventa është ratifikuar nga Kuvendi (Parlamenti) i Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi pas kësaj date.

4. Ju mund të ankoheni në Gjykatë vetëm për aktet e një autoriteti publik (Parlament, administratë, gjykata etj.) të njërit prej Shteteve të listës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk mund të merret me ankesat e drejtuar kundër personave të veçantë, ose institucioneve private.

5. Përpara se t'i drejtoheni Gjykatës së Strasburgut, ju duhet të keni bërë, në shtetin ku jeni dënuar, të gjitha (ankesat) rekursat që do të kishin mundur të sillnin zgjidhjen e çështjes në favorin tuaj ose ndreqjen e situatës për të cilën ju ankoheni. Ju duhet, për shembull, t'i jeni drejtuar organit më të lartë kompetent p.sh. në qoftë se ankoheni se jeni dënuar padrejtësisht nga gjykata e shkallës së parë p.sh. në Itali ose Greqi, ose Francë, duhet të keni bërë ankesë brenda afateve në gjykatat e Apelit dhe në qoftë se lejohet edhe në Gjykatën e Lartë (apo të Kasacionit) të vendit ku jeni dënuar. Gjatë ndjekjes së tyre ankimeve (rekurseve), ju duhet të keni respektuar rregullat e procedurës, sidomos

afatet që ato parashikojnë. Nëse, për shembull, rekursi juaj është hedhur poshtë si i bërë me vonesë, apo për mosrespektim të një rregulli të kompetencës ose të procedurës, ka mundësi që Gjykata e Strasburgut të mos e shqyrtojë çështjen tuaj. Pra duhet bërë kujdes sepse kalimi i afatit 6 mujor, pas datës së vendimit të fundit të dhënë për çështjen tuaj bën që ankesa juaj të mos merret në shqyrtim.

6. Pasi organi më i lartë kombëtar kompetent p.sh. Gjykata e Apelit greke, italiane etj. ka dhënë vendimin e saj, ju keni një afat maksimal prej gjashtë muajsh për t'ju drejtuar Gjykatës së Strasburgut. Nëse ankimi juaj ka të bëjë me një dënim, afati fillon duke u nisur nga data e vendimit përfundimtar të formës së prerë dhe jo duke u nisur nga refuzimi i ndonjë kërkesë të bërë për rishikim jashtë afateve të rregullta të ankimit. Gjykata nuk do ta shqyrtojë ankesën tuaj nëse, përpara skadimit të afatit prej gjashtë muajsh, ju nuk i keni paraqitur asaj qartë arsyet e ankimit tuaj, qoftë edhe në një formë të shkurtuar.

II. SI DUHET T'I DREJTOHENI GJYKATËS SË STRASBURGUT?

7. Nëse mendoni që arsyet e ankimit tuaj kanë të bëjnë me shkeljen e një nga të drejtave të garantuara nga Konventa, ose nga njëri prej Protokolleve dhe se kushtet e përshkruara më sipër plotësohen, (afati 6 mujor etj), dërgoni më parë tek Sekretari i Gjykatës së Strasburgut një letër që përmban të dhënat e radhitura më poshtë. Kjo letër duhet t'i adresohet:

**Le Greffier de la
Cour Européenne des Droits de l'Homme
Conseil de l'Europe
F-67075 STRASBOURG CEDEX
FRANCË**

8. Letra juaj mund të shkruhet në gjuhën shqipe ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj dhe duhet të përmbajë:

- a) një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të ankimit tuaj;
- b) citimin e së drejtës ose të të drejtave të garantuara nga Konventa dhe që i vlerësoni se janë shkelur. Këtë do ta bëni pasi të keni lexuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të gjeni nenin përkatës p.sh. ndalimi i torturës (neni 3), e drejta për një proces të rregullt (neni 6), ndalimi i diskriminimit për shkak të origjinës kombëtare, fesë etj (neni 14) etj.
- c) Ankesat (rekurset) që keni bërë p.sh. në Gjykatën e Apelit apo Gjykatën e Lartë.
- d) Listën e vendimeve të dhëna për çështjen tuaj nga një autoritet publik, duke saktësuar për çdo vendim: datën, përmbajtjen e tij të përmbledhur dhe organin që e ka dhënë. Bashkëngjitni letrës tuaj një kopje të këtyre vendimeve. (Këto dokumenta nuk do t'ju kthehen. Si rrjedhim, është në interesin tuaj të dërgoni vetëm kopje dhe jo origjinale)
- e) Ankesa mund të bëhet nga ju personalisht ose avokati i autorizuar prej jush ose çdo person tjetër i autorizuar me shkrim nga ju.

9. Sekretari i Gjykatës do t`ju përgjigjet. Do t`ju kërkohen ndoshta dokumente, të dhëna ose shpjegime plotësuese lidhur me ankimin tuaj. Mund t`ju informojmë mbi mënyrën se si është interpretuar Konventa në raste të ngjashme. Në rastin kur pranimi i ankesave tuaja ka ndonjë pengesë evidente, do t`ju bëhet e njohur.

10. Nëse nga korrespondenca juaj me Sekretarin del që ankesa juaj mund të regjistrohet si një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut dhe nëse ju dëshironi që ajo të jetë e tillë, Sekretari do t`ju dërgojë formularët që përdoren për të paraqitur formalisht kërkesën tuaj. Pasi t`i keni plotësuar dhe drejtuar ato Sekretarit, kërkesa juaj do t`i paraqitet Gjykatës.

11. Ju do të viheni në dijeni të ecurisë së Procedurës nga Sekretari. Kjo procedurë të paktën në fillim, zhvillohet me shkrim. Kështu që, ju apo personi i autorizuar nga ju, nuk ka pse të paraqitet në selinë e Gjykatës.

12. Nëse është e mundur, është më mirë që të ngarkoni një avokat të paraqesë kërkesën tuaj. Më vonë, gjatë procedurës, nëse duhet, ju mund të merrni ndihmë gjyqësore, në qoftë se nuk dispononi mjetet për të shpërblyer një avokat. Por, kjo ndihmë nuk mund të jepet që në momentin e paraqitjes së kërkesës, por pasi ankesa të jetë pranuar për shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut.

NOTË SHPJEGUESE

Se si duhet të plotësohet një formular ankese për Gjykatën e Strasburgut në zbatim të nenit 34 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

H Y R J E

Shpjegimet që vijojnë kanë për qëllim t`ju ndihmojnë të plotësoni ankimin tuaj drejtuar Gjykatës së Strasburgut.

Duhet t`i lexoni këto shpjegime me vëmendje para se të plotësoni ankimin dhe më pas, referoju atyre kur të plotësoni secilën prej rubrikave të formularit të ankesës.

Pasi plotësohet, ky formular do të përbëjë kërkesën tuaj në Gjykatë, në bazë të nenit 34 të Konventës dhe do të shërbejë për shqyrtimin e rastit tuaj nga Gjykata. Pra, ka shumë rëndësi që formulari të plotësohet në mënyrë të plotë e të saktë, edhe pse mund t`ju kërkohet të përsërisni të dhëna që figurojnë në korrespondencën tuaj të mëparshme me Sekretariat.

Siç do ta shihni, ky formular përmban tetë rubrika. Të gjitha këto duhet të plotësohen, në mënyrë që ankesa juaj të përmbajë të gjitha të dhënat që kërkohen nga Rregullorja e Brendshme e Gjykatës. Ju do të gjeni më poshtë shpjegime të hollësishme që kanë të bëjnë me secilën nga rubrikat. Do të gjeni në fund të kësaj note, edhe tekstin e neneve 45 dhe 47 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës.

SI DUHET TË PLOTËSOHET FORMULARI I ANKIMIT

I. PALËT

Neni 47 § (a), (b) dhe (c)
(1-13)

Çdo ankues do të shënojë të dhënat e tij.

Nëse ka më shumë se një ankues, jepni të dhënat e kërkuara (emri, mbiemri, atësia, mosha, adresa e saktë etj) për secilin prej tyre. Nëse është e nevojshme, përdorni një fletë më vete për secilin.

Çdo ankues mund të caktojë dikë për ta përfaqësuar. Ky përfaqësues duhet të jetë një avokat i njohur ligjërisht të ushtrisë profesionin e tij në cilëndo prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe të jetë banues në territorin e njërit prej tyre. Kur ankuesi është i përfaqësuar, të gjitha të dhënat e nevojshme për përfaqësuesin duhet të jepen në këtë rubrikë; Sekretariati i Gjykatës së Strasburgut do mbajë kështu korrespondencë vetëm me përfaqësuesin tuaj (avokatin).

II. PARAQITJA E FAKTEVE

Neni 47 § (d)
(14)

Paraqitni në mënyrë të qartë dhe të hollësishme, por megjithatë koncize, faktet për të cilat ju ankoheni. Përpiquni të përshkruani ngjarjet sipas radhës që kanë ndodhur, duke dhënë datën e tyre të saktë. Nëse ankimet tuaja kanë të bëjnë me disa çështje të ndryshme (p.sh. disa procedura gjyqësore), trajtoni çdonjërin prej tyre më vete.

III. PARAQITJE E SHKELJES OSE E SHKELJEVE TË KONVENTËS DHE/ OSE E PROTOKOLLEVE, SI DHE ARGUMENTET MBËSHTETËSE

Neni 47 § 1 (e)
(15)

Shpjegoni në këtë rubrikë, sa më saktë që të jetë e mundur, cilat janë ankimet tuaja **përsa i përket shkeljes së Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut**. Tregoni mbi cilën dispozitë ose dispozita të Konventës mbështeteni dhe shpjegoni përse i vlerësoni faktet e përshkruara në rubrikën II si shkelje të këtyre dispozitave.

Siç duhet t'ju ketë rënë në sy, disa nene të Konventës autorizojnë, brenda disa kushteve, kufizime në ushtrimin e të drejtave që ato garantojnë (shih, për shembull, pikat (a) deri (f) të nenit 5 1, si dhe paragrafin e dytë të neneve 8deri 11). Nëse ju i referoheni njërit prej këtyre neneve, shpjegoni përse mendoni që kufizimi për të cilin ankoheni nuk ishte i autorizuar.

IV. PARAQITJE LIDHUR ME NENIN 35 § 1 TË KONVENTËS

Neni 47 § (a)
(16-18)

Në këtë rubrikë, përshkruani në mënyrë të plotë ankimet (rekurset) që ju keni ushtruar përpara autoriteteve kombëtare të shtetit që ju ka dënuar.

Plotësoni secilën prej tre pjesëve të kësaj rubrike, duke ndarë përgjigjet tuaja për secilin ankim që ju paraqitni përpara Gjykatës. Në pikën 18, përmendni të gjitha rekurset që mund të kishin sjellë ndreqje të ankimeve tuaja, por që ju nuk i keni bërë. Nëse një rekurs i tillë ekzistonte, specifikojeni atë (për shembull, duke shënuar emrin e autoritetit – gjyqësor ose tjetër – të cilit mund t'i drejtoheshit) dhe shpjegoni përse nuk e keni përdorur atë, pra pse nuk jeni ankuar, p.sh. se nuk ju kanë lejuar autoritetet e burgut, të policisë etj.

V. PARAQITJE E OBJEKTIT TË KËRKESËS

Neni 47 § 1 (g)
(19)

Tregoni në këtë rubrikë se çfarë prisni nga procedura që ju kërkon të hapni në Gjykatë. Duhet gjithashtu të saktësoni në vija të përgjithshme pretendimet tuaja për të kërkuar zhdëmtimin e drejtë që ju kërkon të fitoni, duke u mbështetur në nenin 41 të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut.

VI. INSTANCA TË TJERA NDËRKOMBËTARE QË TRAJTOJNË OSE KANË TRAJTUAR ÇËSHTJEN

Neni 47 § 2 (b)
(20)

Në këtë rubrikë ju do të tregoni nëse i keni paraqitur ankimet e përfshira në ankesën drejtuar Gjykatës së Strasburgut, në një instancë tjetër ndërkombëtare hetimore ose vendimore. Nëse po, lutemi jepni për atë instancë të dhëna të plota, konkretisht emrin e organit ndërkombëtar të cilit i jeni drejtuar, të gjitha hollësitë mbi procedurat e ndjekura, vendimet e dhëna prej tyre, me datën e tyre. Bashkëngjitni një kopje të vendimeve të dhëna dhe të çdo dokumenti tjetër përkatës.

VII. LISTA E DOKUMENTEVE

Neni 47 § 1 (h)

Mbani parasysh që të dërgoni jo origjinale, por vetëm kopje të dokumenteve
(21)

Mos harroni të shtoni në ankesën tuaj dhe të përmendni në këtë listë të gjitha gjykimet

si dhe vendime të tjera që ju keni, si edhe çdo dokument tjetër që ju dëshironi të paraqisni në Gjykatën e Strasburgut si mjet prove si raporte mjekoligjore, deklaratatë të dëshmitarëve etj. Megjithatë, kufizohuni të dërgoni vetëm dokumentet që kanë rëndësi për shqyrtimin e ankimeve që përmban ankesa juaj.

VIII. DEKLARATA DHE NËNSHKRIMI

Neni 45 § 3

(22)

Nëse formulari i ankimit do të nënshkruhet jo nga vetë ankuesi, por nga përfaqësuesi i tij, ajo duhet të shoqërohet me një prokurë në favor të këtij të fundit, të nënshkruar nga vetë ankuesi, (me përjashtim të rastit kur një prokurë e tillë është dorëzuar më parë në Sekretariat).

Nenet 45 dhe 47 të Rregullores së Gjykatës së Strasburgut

(Përkthim i Sekretariatit)

Neni 45

(Nënshkrimet)

1. Çdo ankesë e formuluar sipas nenit 33 ose 34 të Konventës duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga ankuesi ose nga personi që e përfaqëson.

2. Kur ankesa është paraqitur nga një organizatë jo qeveritare ose nga një grup individësh, ajo nënshkruhet nga persona të njohur ligjërisht për të përfaqësuar organizatën ose grupin. Dhoma ose komiteti përkatës vendosin të verifikojnë nëse personat që kanë nënshkruar një ankesë kanë pasur kompetencë.

3. Kur ankuesi është i përfaqësuar, në përputhje me nenin 36 të kësaj Rregulloreje, përfaqësuesi ose përfaqësuesit e tij duhet të paraqesin një prokurë ose një mandat me shkrim.

Neni 47

(Përmbajtja e një ankese individuale)

1. Çdo ankesë e depozituar sipas nenit 34 të Konventës, pasqyrohet në formularin e dhënë nga sekretariati me përjashtim të rasteve kur Kryetari i seksionit përkatës vendos ndryshe. Formulari duhet të ketë:

- a) emrin, datën e lindjes, kombësinë, seksin, profesionin dhe adresën e ankuesit
- b) nëse duhet, emrin, profesionin dhe adresën e përfaqësuesit të tij;
- c) palën (shtetin) ose Palët kontraktuese, (shtetet) kundër të cilave është drejtuar ankesa;
- d) paraqitje të shkurtër të fakteve;
- e) paraqitje të shkurtër të shkeljes ose shkeljeve të Konventës dhe të argumenteve përkatës
- f) paraqitje të shkurtër të rrugës procedurale të ndjekur nga ankuesi në bazë të nenit 35 për pranueshmërinë e kërkesës (ndjekja e të gjitha rekurseve të brendshme dhe respektimi i afatit prej gjashtë muajsh)
- g) objektin e ankësës si dhe në vija të përgjithshme kërkesën për zhdëmtim të drejtë

që ankuesi mund të formulojë sipas nenit 41 të Konventës;

Formulari duhet të shoqërohet me:

h) me kopje të gjitha dokumentave përkatës dhe në veçanti me vendimet gjyqësore ose të tjera, që kanë të bëjnë me objektin e ankesës.

2. Përveç këtij formulari, çdo ankues duhet:

a. Të paraqesë të gjithë elementët, konkretisht dokumentet dhe vendimet e përmendura ne paragrafin 1.h të këtij neni që lejojnë të provohet se janë të gjitha kushtet për pranueshmërinë e ankimit cituar në nenin 35 1 të Konventës;

b. Të bëjë të ditur nëse ka paraqitur ankesat e tij në ndonjë instancë tjetër ndërkombëtare hetimore ose vendimore.

3. Ankuesi që nuk dëshiron të bëjë të njohur publikisht identitetin e tij duhet të saktësojë një gjë të tillë dhe të japë një përmbledhje të shkaqeve që justifikojnë përjashtimin nga rregulli normal i bërjes publike të procedurës përpara Gjykatës. Kryetari i dhomës mund të autorizojë anonimatit në raste të veçanta dhe mëse të përligjura.

4. Në rast mosrespektimi të detyrimeve të paraqitura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, ankesa mund të mos regjistrohet dhe të mos shqyrtohet nga Gjykata

5. Si rregull i përgjithshëm, ankesa quhet e hapur që nga data kur ankuesi ka bërë komunikimin e parë të objektit të kërkesës së tij, qoftë dhe shkurtimisht. Megjithatë gjykata, nëse e gjen me vend, mund të vendosë të mbajë një datë tjetër.

6. Ankuesi duhet të njoftojë Gjykatën e Strasburgut për çdo ndryshim të adresës së tij dhe të cdo fakti të rëndësishëm në shqyrtimin e ankesës së tij.

Këshilloheni të mos mërziteni sepse zakonisht çështjet në Gjykatën e Strasburgut zgjaten me muaj e me vite. E rëndësishme do të jetë për ju në qoftë se ju njoftojnë se kërkesa juaj është pranuar për shqyrtim.

Voir Note explicative - See Explanatory Note - Të shihet Nota shpjeguese (albanais)

**COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME
EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

CONSEIL DE L'EUROPE
COUNCIL OF EUROPE
Strasbourg, France

KËSHILLI I EVROPËS
Strasbourg, Francë

REQUÊTE

APPLICATION

KËRKESË

présentée en application de l'article 34 de la Convention européenne des Droits de l'Homme. ainsi que des articles 45 et 47 du Règlement de la Cour

under Article 34 of the European Convention on Human Rights and Rules 45 and 47 of the Rules of Court

e paraqitur në bazë të nenit 34 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe neneve 45 e 47 të Rregullores së Gjykatës

IMPORTANT:

La présente requête est un document juridique et peut affecter vos droits et obligations.

This application is a formal legal document and may affect your rights and obligations.

E RËNDËSISHME:

Kjo kërkesë është një dokument juridik dhe mund të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet tuaja

I -LES PARTIES

THE PARTIES

PALËT

A. LE REQUÉRANT / LA REQUÉRANTE

THE APPLICANT

KËRKUESI / KËRKUESJA

(Renseignements à fournir concernant le/la requérant (e) et son/sa représentant(e) éventuel(le))

(Fill in the following details of the applicant and the representative, if any)

(Të dhënat që jepen për kërkuesin/kërkuesen dhe përfaqësuesin eventual të tij/të saj)

1. Nom de famille

Surname – Mbiemri

2. Prénom (s)

First name (s) – Emri

Sexe: masculin / féminin

Sex: male / female

Seksi: mashkull / femër

3. Nationalité.....

Nationality – Kombësia

4. Profession

Occupation – Profesion

5. Date et lieu de naissance

Date and place of birth – Data dhe vendi i lindjes

- 6. Domicile**
Permanent address – Vendbanimi
- 7. Tel.N0**.....
- 8. Adresse actuelle (si différente de 6.)**.....
Present address (if different from 6.) – Adresa aktuale (nëse është e ndryshme nga 6.)
- 9. Nom et prénom du/de la représentant (e)***
Name of representative* Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit*
- 10. Profession du/de la représentant(e)**.....
Occupation of representative – Profesioni i përfaqësuesit
- 11. Adresse du/de la représentant(e)**.....
Address of representative – Adresa e përfaqësuesit
- 12. Tel.N0** **Fax N0**.....

B. LA HAUTE PARTIE CONTRACTANTE
THE HIGH CONTRACTING PARTY
PALA E LARTË KONTRAKTUESE

(Indiquer ci-après le nom de l'Etat / des Etats contre le(s)quel(s) la requête est dirigée)

(Fill in the name of the State(s) against which the application is directed)

(Shënoni emrin e Shtetit ose Shteteve kundër të cilit/të cilëve drejtohet kërkesa)

- 13.**
.....
.....
.....

** Si le/la requérant(e) est représenté(e), joindre une procuration signée par le/la requérant (e) en faveur du/de la représentant(e).*

** A form of authority signed by the applicant should be submitted if a representative is appointed.*

** Nëse kërkuesi/kërkuesja është i përfaqësuar, bashkëngjitini një prokurë të firmosur nga kërkuesi/kërkuesja në favor të përfaqësuesit.*

II. EXPOSÉ DES FAITS**STATEMENT OF THE FACTS****PARAQITJA E FAKTEVE**

(Voir chapitre II de la note explicative)(See Part II of the Explanatory Note)

(Të shihet kapitulli II i notës shpjeguese)

14.

** Si nécessaire, continuer sur une feuille séparée*

** Continue on a separate sheet if necessary*

** Nëse është e nevojshme, vazhdoni në një fletë tjetër*

III. EXPOSÉ DE LA OU DES VIOLATION(S) DE LA CONVENTION ET/OU DES PROTOCOLES ALLÉGUÉE(S), AINSI QUE DES ARGUMENTS À L'APPUI**STATEMENT OF ALLEGED VIOLATION(S) OF THE CONVENTION AND/OR PROTOCOLS AND OF RELEVANT ARGUMENTS****PARAQITJE E SHKELJES OSE SHKELJEVE TË KONVENTËS OSE TË PROTOKOLLEVE SI DHE ARGUMENTET PËRKATËSE**

** Voir chapitre III de la note explicative*

** See Part III of the Explanatory Note*

** Të shihet kapitulli III i notës shpjeguese*

15.

IV. EXPOSÉ RELATIF AUX PRESCRIPTIONS DE L'ARTICLE 35 § 1 DE LA CONVENTION**STATEMENT RELATIVE TO ARTICLE 35 § 1 OF THE CONVENTION****PARAQITJE LIDHUR ME PARASHKRIMET E NENIT 35 § 1 TË KONVENTËS**

(Voir chapitre IV de la note explicative. Donner pour chaque grief, et au besoin sur une feuille séparée, les renseignements demandés sous les points 16 à 18 ci-après)

(See Part IV of the Explanatory Note. If necessary, give the details mentioned below under points 16 to 18 on a separate sheet for each separate complaint)

(Të shihet kapitulli IV i notës shpjeguese. Të dhënat e kërkuara në pikën 16 deri 18 të jepen për çdo ankim, nëse është e nevojshme të përdoret një fletë më vete).

16. Décision interne définitive (date et nature de la décision, organe – judiciaire ou autre – l’ayant rendue)

Final decision (date, court or authority and nature of decision)

Vendimi përfundimtar (data dhe lloji i vendimit, organi gjyqësor apo tjetër – që e ka dhënë)

17. Autres décisions (énumérées dans l’ordre chronologique en indiquant, pour chaque décision, sa date, sa nature et l’organe – judiciaire ou autre – l’ayant rendue)

Other decisions (list in chronological order, giving date, court or authority and nature of decision for each of them)

Vendime të tjera (radhitini sipas rendit kronologjik duke dhënë, për çdo vendim, datën, llojin dhe organin gjyqësor apo tjetër – që e ka dhënë)

18. Dispos(i)ez-vous d’un recours que vous n’avez pas exercé? Si oui, lequel et pour quel motif n’a-t-il pas été exercé?

Is there or there any other appeal or other remedy available to you which you have not used? If so, explain why you have not used it.

Dispononi ndonjë rekurs që nuk e keni ushtruar? Nëse po, cilin dhe për çfarë arsye.

* *Si nécessaire, continuer sur une feuille séparée*

* *Continue on a separate sheet if necessary*

* *Nëse është e nevojshme, vazhdoni në një fletë tjetër*

V. EXPOSÉ DEL’OBJET DE LA REQUÊTE ET PRÉTENTIONS PROVISOIRES POUR UNE SATISFACTION EQUITABLE

STATEMENT OF THE OBJECT OF THE APPLICATION AND PROVISIONAL CLAIMS FOR JUST SATISFACTION

PARAQITJA E OBJEKTIT TË KËRKESËS DHE PRETENDIMEVE PROVIZORE PËR NJË ZHDËMTIM TË DREJTË

(Voir chapitre V de la note explicative)

(See Part V of the Explanatory Note)

(Të shihet kapitulli V i notës shpjeguese)

19.

VI. AUTRES INSTANCES INTERNATIONALES TRAITANT OU AYANT TRAITÉ L'AFFAIRE

STATEMENT CONCERNING OTHER INTERNATIONAL PROCEEDINGS

INSTANCA TË TJERA NDËRKOMBËTARE QË TRAJTOJNË OSE QË KANË TRAJTUAR ÇËSHTJEN

(Voir chapitre VI de la note explicative)

(See Part VI of the Explanatory Note)

(Të shihet kapitulli VI i notës shpjeguese)

20. Avez-vous soumis à une autre instance internationale d'enquête ou de règlement les griefs énoncés dans la présente requête? Si oui, fournir des indications détaillées à ce sujet.

Have you submitted the above complaints to any other procedure of international investigation or settlement? If so, give full details.

Keni paraqitur në ndonjë instancë tjetër ndërkombëtare hetimore apo vendimore ankesat tuaja të përmendura në këtë kërkesë? Nëse po, jepni për këtë të dhëna të detajuara.

VII – PIÈCES ANNEXÉES

(PAS D'ORIGINAUX, UNIQUEMENT DES COPIES)

LIST OF DOCUMENTS

(NO ORIGINAL DOCUMENTS, ONLY PHOTOCOPIES)

LISTA E DOKUMENTEVE

(JO ORIGJINALE, VETËM FOTOKOPJE)

(Voir chapitre VII de la note explicative. Joindre copie de toutes les décisions mentionnées sous ch. IV et VI ci-dessus. Se procurer, au besoin, les copies nécessaires, et, en cas d'impossibilité, expliquer pourquoi celles-ci ne peuvent pas être obtenues. Ces documents ne vous seront pas retournés).

(See Part VII of the Explanatory Note. Include copies of all decisions referred to in Parts IV and VI above. If you do not have copies, you should obtain them. If you cannot obtain them, explain why not. No documents will be returned to you).

(Të shihet kapitulli VII i notes shpjeguese. Bashkëngjitni kopje të të gjitha vendimeve të përmendura në kapitullin IV dhe VI në rastet kur është e pamundur të jepet kopja, shpjegoni arsyet. Këto dokumente nuk do t'ju kthehen).

- 21.** a)
- b)
- c).....

VIII. DÉCLARATION ET SIGNATURE**DECLARATION AND SIGNATURE****DEKLARATA DHE NËNSHKRIMI**

(Voir chapitre VIII de la notre explicative)

(See Part VIII of the Explanatory Note)

(Të shihet kapitulli VIII i notës shpjeguese)

22. Je déclare en toute conscience et loyauté que les renseignements qui figurent sur la présente formule de requête sont exacts.

I hereby declare that, to the best of my knowledge and belief, the information. I have given in the present application form is correct.

Deklaroj me ndërgjegje dhe përgjegjësi të plotë se të dhënat që figurojnë në këtë formulë ankese janë të sakta.

Lieu / Place / Vendi:

Date / Date / Data

* (Signature du/de la requérant(e) ou du/de la représentant(e))

* (Signature of the applicant or of the representative)

* (Nënshkrimi i kërkesit/kërkueses ose i përfaqësuesit)

**Lista e shteteve që kanë firmosur
Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollet shtesë**

**Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
dhe Liritë Themelore ETS n° : 005**

Traktat i hapur për firmë nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës

Status 09/09/02

E hapur për firmë:

Vendi : Rome

Data : 04/11/50

Hyn në fuqi:

Kushtet : 10 Ratifikime

Data : 03/09/53

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës:

Shtetet	Data e firmosjes	Data e ratifikimit	Data e hyrjes në fuqi	Shënime	R.	D.	A.	T.	K.	V.
Shqipëria	13/07/95	02/10/96	02/10/96							
Andorra	10/11/94	22/01/96	22/01/96		X	X				
Armenia	25/01/01	26/04/02	26/04/02		X					
Austria	13/12/57	03/09/58	03/09/58		X					
Azerbajxhani	25/01/01	15/04/02	15/04/02		X	X				
Belgjika	04/11/50	14/06/55	14/06/55							
Bosnje-Hercegovina	24/04/02	12/07/02	12/07/02							
Bullgaria	07/05/92	07/09/92	07/09/92							
Kroacia	06/11/96	05/11/07	05/11/07		X					
Qipro	16/12/61	06/10/62	06/10/62							
Republika Çeke	21/02/91	18/03/92	01/01/92	17	X					
Danimarka	04/11/50	13/04/53	03/09/53							
Estonia	14/05/93	16/04/96	16/04/96		X					
Finlanda	05/05/89	10/05/90	10/05/90		X					
Franca	04/11/50	03/05/74	03/05/74		X	X		X		
Gjeorgjia	27/04/99	20/05/99	20/05/99							
Gjermania	04/11/50	05/12/52	03/09/53	30	X			X		
Greqia	28/11/50	28/11/74	28/11/74	29						
Hungaria	06/11/90	05/11/92	05/11/92							
Islanda	04/11/50	29/06/53	03/09/53							
Irlanda	04/11/50	25/02/53	03/09/53		X					
Italia	04/11/50	26/10/55	26/10/55							
Letonia	10/02/95	27/06/97	27/06/97							
Lihtenshtein	23/11/78	08/09/82	08/09/92		X					
Lituania	14/05/93	20/06/95	20/06/95		X					
Luksemburgu	04/11/50	03/09/53	03/09/53							
Malta	12/12/66	23/01/67	23/01/67		X	X				
Moldavia	13/07/95	12/09/97	12/09/97		X	X				
Holanda	04/11/50	31/08/54	31/08/54					X		
Norvegjia	04/11/50	15/01/52	03/09/53		X					
Polonia	26/11/91	19/01/93	19/01/93							
Portugalia	22/09/76	09/11/78	09/11/78		X					
Rumania	07/10/93	20/06/94	20/06/94		X					

Rusia	28/02/96	05/05/98	05/05/98		X					
San Marino	16/11/88	22/03/89	22/03/89		X	X				
Sllovakia	21/02/91	18/03/92	01/01/93	17	X					
Sllovenia	14/05/93	28/06/94	28/06/94							
Spanja	24/11/77	04/10/79	04/10/79		X	X				
Suedia	28/11/50	04/02/52	03/09/53							
Zvicra	21/12/72	28/11/74	28/11/74							
IRJ e Maqedonisë	09/11/95	10/04/97	10/04/97							
Turqia	04/11/50	18/05/54	18/05/54						X	
Ukraina	09/11/95	11/09/97	11/09/97		X					
Mbretëria e Bashkuar	04/11/50	08/03/51	03/09/53					X	X	

Numri total i firmave jo të ndjekura nga ratifikimet	0
Numri total i ratifikimeve/Hyrjeve	44

Shënime:

(17) Data e firmosjes dhe ratifikimit nga ish Republika Çekosllovaqe.

(29) Ratifikimi 28/03/1953 – Denoncim më 13/06/1970

(30) Ratifikimi nga Saarland 14/01/1953 - Saarland u bë pjesë integruese e Gjermanisë më 01/01/1957.

h: Hyrje - f: Firmosje pa rezervë ndaj ratifikimit - v: Vijim - r: “firmosje me referendum”.
R.: Rezervim - D.: Deklarata - A.: Autoritetet - T.: Zbatim territorial - K.: Komunikim
- V.: Vërejtje.

**Protokolli i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive
Themelore ETS n° : 009**

Traktat i hapur për firmë nga shtetet anëtare nënshkruese të Traktatit ETS 5

Status 09/09/02

I hapur për firmë:

Vendi : Paris

Data : 20/03/52

Hyn në fuqi:

Kushtet : 10 Ratifikime

Data : 18/05/54

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës:

Shtetet	Data e firmosjes	Data e ratifikimit	Data e hyrjes në fuqi	Shënime	R.	D.	A.	T.	K.	V.
Shqipëria	02/10/96	02/10/96	02/10/96		X					
Andorra										
Armenia	25/01/01	26/04/02	26/04/02							
Austria	13/12/57	03/09/58	03/09/58		X					
Azerbajxhani	25/01/01	15/04/02	15/04/02			X				
Belgjika	20/03/52	14/06/55	14/06/55							

Bosnje-Hercegovina	24/04/02	12/07/02	12/07/02							
Bullgaria	07/05/92	07/09/92	07/09/92		X					
Kroacia	06/11/96	05/11/07	05/11/07							
Qipro	16/12/61	06/10/62	06/10/62							
Republika Çeke	21/02/91	18/03/92	01/01/93	17						
Danimarka	20/03/52	13/04/53	18/05/54							
Estonia	14/05/93	16/04/96	16/04/96		X	X				
Finlanda	05/05/89	10/05/90	10/05/90							
Franca	20/03/52	03/05/74	03/05/74					X		
Gjeorgjia	17/06/99	07/06/02	07/06/02		X	X				
Gjermania	20/03/52	13/02/57	13/02/57			X		X		
Greqia	20/03/52	28/11/74	28/11/74		X					
Hungaria	06/11/90	05/11/92	05/11/92							
Islanda	20/03/52	29/06/53	18/05/54							
Irlanda	20/03/52	25/02/53	18/05/54			X				
Italia	20/03/52	26/10/55	26/10/55							
Letonia	21/03/97	27/06/97	27/06/97		X					
Lihtenshtein	07/05/87	14/11/95	14/11/95							
Lituania	14/05/93	24/05/96	24/05/96							
Luksemburgu	20/03/52	03/09/53	18/05/54		X					
Malta	12/12/66	23/01/67	23/01/67			X				
Moldavia	02/05/96	12/09/97	12/09/97			X				
Holanda	20/03/52	31/08/54	31/08/54			X		X		
Norvegjia	20/03/52	18/12/52	18/05/54							
Polonia	14/09/92	10/10/94	10/10/94							
Portugalia	22/09/76	09/11/78	09/11/78		X					
Rumania	04/11/93	20/06/94	20/06/94			X				
Rusia	28/02/96	05/05/98	05/05/98							
San Marino	01/03/89	22/03/89	22/03/89		X					
Sllovakia	21/02/91	18/03/92	01/01/93	17						
Sllovenia	14/05/93	28/06/94	28/06/94							
Spanja	23/02/78	27/11/90	27/11/90		X					
Suedia	20/03/52	22/06/53	18/05/54		X					
Zvicra	19/05/76									
IRJ e Maqedonisë	14/06/96	10/04/97	10/04/97		X					
Turqia	20/03/52	18/05/54	18/05/54		X				X	
Ukraina	19/12/96	11/09/97	11/09/97							
Mbretëria e Bashkuar	20/03/52	03/11/52	18/05/54		X		X			

Numri total i firmave jo të ndjekura nga ratifikimet	0
Numri total i ratifikimeve/Hyrjeve	42

Shënime:

(17) Data e firmosjes dhe ratifikimit nga ish Republika Çekosllovaqe.

h: Hyrje - f: Firmosje pa rezervë ndaj ratifikimit - v: Vijim - r: “firmosje me referendum”.
 R.: Rezervim - D.: Deklarata - A.: Autoritetet - T.: Zbatim territorial - K.: Komunikim
 - V.: Vërejtje.

Finlanda	03/05/02													
Franca	03/05/02													
Gjeorgjia	03/05/02	15/06/01					X							
Gjermania	03/05/02													
Greqia	03/05/02													
Hungaria	03/05/02													
Islanda	03/05/02													
Irlanda	03/05/02	03/05/02												
Italia	03/05/02													
Letonia	03/05/02													
Lihtenshtein	03/05/02													
Lituania	03/05/02													
Luksemburgu	03/05/02													
Malta	03/05/02	03/05/02												
Moldavia	03/05/02													
Holanda	03/05/02													
Norvegjia	03/05/02													
Polonia	03/05/02													
Portugalia	03/05/02													
Rumania	03/05/02													
Rusia														
San Marino	03/05/02													
Slovakia	24/07/02													
Slovenia	03/05/02													
Spanja	03/05/02r													
Suedia	03/05/02													
Zvicra	03/05/02	03/05/02												
IRJ e Maqedonisë														
Turqia														
Ukraina	03/05/02													
Mbretëria e Bashkuar	03/05/02													

Numri total i firmave jo të ndjekura nga ratifikimet	35
Numri total i ratifikimeve/Hyrjeve	3

Shënime:

h: Hyrje - f: Firmosje pa rezervë ndaj ratifikimit - v: Vijim - r: “firmosje me referendum”.
 R.: Rezervim - D.: Deklarata - A.: Autoritetet - T.: Zbatim territorial - K.: Komunikim
 - V.: Vërejtje.

Suedia	22/11/84	08/11/85	01/11/88							
Zvicra	28/02/86	24/02/88	01/11/88		X					
IRJ e Maqedonisë	14/06/96	10/04/97	01/07/97							
Turqia	14/03/85									
Ukraina	19/12/96	11/09/97	01/12/97							
Mbretëria e Bashkuar										

Numri total i firmave jo të ndjekura nga ratifikimet	6
Numri total i ratifikimeve/Hyrjeve	33

Shënime:

(17) Data e firmosjes dhe ratifikimit nga ish Republika Çekosllovaqe.

h: Hyrje - f: Firmosje pa rezervë ndaj ratifikimit - v: Vijim - r: "firmosje me referendum".

R.: Rezervim - D.: Deklarata - A.: Autoritetet - T.: Zbatim territorial - K.: Komunikim

- V.: Vërejtje.

**Protokolli Nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore
lidhur me heqjen e dënimit me vdekje ETS n° : 114**

Traktati i hapur për firmë nga shtetet anëtare nënshkruese të Traktatit ETS 5

Status 09/09/02

I hapur për firmë:

Vendi : Strasburg

Data : 28/04/83

Hyn në fuqi:

Kushtet : 5 Ratifikime

Data : 01/03/85

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës:

Shtetet	Data e firmosjes	Data e ratifikimit	Data e hyrjes në fuqi	Shënime	R.	D.	A.	T.	K.	V.
Shqipëria	04/04/00	21/09/00	01/10/00							
Andorra	22/01/96	22/01/96	01/02/96							
Armenia	25/01/01									
Austria	28/04/83	05/01/84	01/03/85							
Azerbajxhani	25/01/01	15/04/02	01/05/02			X				
Belgjika	28/04/83	10/12/98	01/01/99							
Bosnje-Hercegovina	24/04/02	12/07/02	01/10/99							
Bullgaria	06/11/96	05/11/97	01/12/97							
Kroacia	09/11/06	05/11/07	01/12/97							
Qipro	07/05/99	19/01/00	01/02/00						X	
Republika Çeke	21/02/91	18/03/92	01/01/93	17						
Danimarka	28/04/83	01/12/83	01/03/85							

Estonia	14/05/93	17/04/98	01/05/98							
Finlanda	05/05/89	10/05/90	01/06/90							
Franca	28/04/83	17/02/86	01/03/86							
Gjeorgjia	17/06/99	13/04/00	01/05/00							
Gjermania	28/04/83	05/07/89	01/08/89			X		X		
Greçia	02/05/83	08/09/98	01/10/98							
Hungaria	06/11/90	05/11/92	01/12/92							
Islanda	24/04/85	22.05.87	01/06/87							
Irlanda	24/06/94	24/06/94	01/07/94							
Italia	21/10/83	29/12/88	01/10/89							
Letonia	26/06/98	07/05/99	01/06/99							
Lihtenshtein	05/11/90	05/11/90	01/12/90							
Lituanua	18/01/99	08/07/99	01/08/99							
Luksemburgu	28/04/83	19/02/85	01/03/85							
Malta	26/03/91	26/03/91	01/04/91							
Moldavia	02/05/96	12/09/97	01/10/97							
Holanda	28/04/83	25/04/86	01/05/86			X		X		
Norvegjia	28/04/83	25/10/88	01/11/88							
Polonia	18/11/99	30/10/00	01/11/00							
Portugalia	28/04/83	02/10/86	01/11/86							
Rumania	15/12/93	20/06/94	01/07/94							
Rusia	16/04/97									
San Marino	01/03/89	22/03/89	01/04/89							
Slovakia	21/02/91	18/03/92	01/01/93	17						
Slovenia	14/05/93	28/06/94	01/07/94							
Spanja	28/04/83	14/01/85	01/03/85							
Suedia	28/04/83	09/02/84	01/03/85							
Zvicra	28/04/83	09/02/84	01/03/85			X				
IRJ e Maqedonisë	14/06/96	10/04/97	01/05/97							
Turqia										
Ukraina	05/05/97	04/04/00	01/05/00						X	
Mbretëria e Bashkuar	27/01/99	20/05/99	01/06/99					X		

Numri total i firmave jo të ndjekura nga ratifikimet	2
Numri total i ratifikimeve/Hyrjeve	41

Shënime:

(17) Data e firmosjes dhe ratifikimit nga ish Republika Çekosllovaqe.

h: Hyrje - f: Firmosje pa rezervë ndaj ratifikimit - v: Vijim - r: “firmosje me referendum”.

R.: Rezervim - D.: Deklarata - A.: Autoritetet - T.: Zbatim territorial - K.: Komunikim - V.: Vërejtje.

KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR”

e datës 21.03.1983

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e nënshkruese;

Duke parë se qëllimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij; Duke dashur të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;

Duke parë se një bashkëpunim i tillë duhet t’i çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar;

Duke parë se këto objektiva kërkojnë që të huajve, të cilëve u është hequr liria si rezultat e kryerjes prej tyre të një vepre penale, duhet t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre; dhe

Duke parë se ky qëllim mund të arrihet më mirë duke i transferuar ata në vendet e tyre,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj konvente:

- a). “dënim” do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të përcaktuar si rezultat i një vepre penale;
- b). “vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që vendos një dënim;
- c). “shteti dënues” është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund ose është transferuar;
- d). “shteti zbatues” – është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Palët angazhohen t’i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Një person i dënuar në territorin e një pale mund të transferohet në territorin e një pale tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për të vuajtur dënimin që i është dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e vet tek shteti dënues ose tek shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Konventë.

3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3**Kushte për transferim**

1. Në përputhje me këtë Konventë një person i dënuar mund të transferohet vetëm në kushtet e mëposhtme:

- a) Nëse ai person është shtetas i shtetit zbatues;
- b) Nëse vendimi është i formës së prerë;
- c) Nëse në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i papërcaktuar;
- d) Nëse për transferimin është dhënë pëlqimi nga personi i dënuar ose kur, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike ose mendore dhe, kur njëri prej të dy shteteve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;
- e) Nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale në përputhje me të drejtën e shtetit zbatues ose do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
- f) Nëse shteti dënues dhe ai zbatues janë dakord me transferimin.

2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuhet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.c

3. Në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, çdo shtet mund të bëjë të ditur se ai do të përjashtojë zbatimin e njëres prej procedurave të parashikuara në nenin 9.1.a dhe b. në marrëdhëniet e tij me palët e tjera, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

4. Në çdo kohë çdo shtet mund të përcaktojë, për aq sa ai është i interesuar, termin “shtetas” për qëllimet e kësaj Konvente me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 4**Detyrimi për të dhënë informacion**

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Konventë informohet nga shteti dënues mbi lëndën e kësaj Konvente.

2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t’u transferuar në përputhje me këtë Konventë, ai shtet njofton shtetin zbatues sa më shpejt që të jetë e mundur mbasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.

3. Informacioni përmbledh:

- a) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
- b) nëse ka, adresën në shtetin zbatues;
- c) përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;
- d) natyrën, kohëzgjatjen dhe qëllimin e dënimit.

4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.

5. Personi i dënuar informohet me shkrim për çdo veprim të ndërmarrë nga shteti dënues ose ai zbatues në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim nga çdo shtet mbi kërkesën për transferim.

Neni 5

Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.
2. Kërkesat bëhen nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të shtetit të adresuar. Përgjigjet komunikohen nëpërmjet të njëjtit kanal.
3. Secila palë mund të tregojë që ajo do të përdorë kanale të tjera komunikimi me anë të një deklaratë, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
4. Shteti i adresuar njofton menjëherë shtetin kërkues për vendimin e tij nëse ai është dakord ose jo me transferimin e kërkuar.

Neni 6

Dokumentet shtesë

1. Shteti administrues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohen prej tij:
 - a. një dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;
 - b. një kopje e ligjit përkatës të shtetit administrues, i cili parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën një veprë penale në pajtim me ligjin e shtetit administrues apo do të përbënte një veprë penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij;
 - c. një deklaratë që të përmbajë informacionin e përmendur në nenin 9.2
2. Nëse bëhet një kërkesë për transferim, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues, nëse njëri nga shtetet ka bërë të ditur se ai nuk është dakort me transferimin:
 - a) një kopje të vërtetuar të vendimit dhe ligjit mbi të cilin ai është bazuar;
 - b) një deklaratë ku të tregohet se ç'pjesë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informacion për ndalimet paragyqësore, shkurtimeve e dënimeve, si edhe për çdo faktor tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;
 - c) një deklaratë ku të shprehet pëlqimi për transferimin e përmendur në nenin 3.1.d dhe
 - d) kur është e nevojshme, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, informacione për trajtimin e tij në shtetin dënues dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në shtetin zbatues.
3. Secili shtet mund të kërkojë të pajiset me çfarëdo lloj dokumenti ose deklaratë të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm, pra se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakort për transferimin e tij ose jo.

Neni 7

Pëlqimi dhe verifikimi

1. Shteti dënues sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.d e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat e tij. Procedura për dhënien e këtij pëlqimi rregullohet nga ligji i shtetit dënues.
2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord nga shteti zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të mësipërm.

Neni 8

Efektet e transferimit për shtetin dënues

1. Marrja në dorëzim i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit zbatues sjell si rezultat pezullimin e ekzekutimit të dënimit në shtetin dënues.
2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9

Efektet e transferimit për shtetin zbatues

1. Organet kompetente të shtetit zbatues:
 - a. vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor ose administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10;
 - b. konvertojnë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën veprë penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11.
2. Nëse bëhet kërkesë, shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, përta i përket procedurës që do të ndiqet.
3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.
4. Secili shtet që në përputhje me ligjin e vet kombëtar nuk mund të zbatojë ndonjë nga procedurat e përmendura në pikën 1, për të ekzekutuar masat e dhëna në territorin e një pale tjetër mbi personat të cilët për shkaqe të gjendjes së tyre mendore nuk mund të dënohen për kryerjen e veprës dhe që është i përgatitur për të pritur persona të tjerë për trajtim të mëtejshëm, mund të tregojë procedurat që ai do të ndjekë në raste të tilla, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 10

Vazhdimi i ekzekutimit

1. Në rastin e vazhimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.
-

2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Përsa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t'u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11

Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:

- a) duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;
- b) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
- c) shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe
- d) nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues mban atë person në izolim ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12

Falja, amnistia, zëvendësimi

Secila palë mund të japë falje, amnisti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën ose ligjet e tjera.

Neni 13

Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14

Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15

Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- a) kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
- b) nëse personi i dënuar është arratisur nga izolimi para se të përfundojë ekzekutimin e dënimit; ose
- c) kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16

Tranziti

1. Secila palë në përputhje me ligjin e vet plotëson kërkesën për kalimin tranzit të një personi të dënuar përmes territorit të tij, nëse një kërkesë e tillë bëhet nga një palë tjetër ose kur ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër ose me një shtet të tretë për transferimin e atij personi.

2. Një palë mund të mos pranojë të lejojë tranzitin:

- a) nëse personi i dënuar është shtetas i tij, ose
- b) nëse vepra penale për të cilën është dhënë dënimi nuk përbën vepër penale në përputhje me ligjin e vet.

3. Kërkesat për tranzit dhe përgjigjet komunikohen nëpërmjet kanaleve të përmendura në dispozitat e nenit 5.2 dhe 3.

4. Një palë mund të plotësojë një kërkesë të bërë nga një shtet i tretë për tranzitin përmes territorit të tij të një personi të dënuar, nëse ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër për transferimin nga ose në territorin e vet.

5. Pala, së cilës i është kërkuar të lejojë kalimin tranzit, mund të mbajë personin e dënuar në izolim, vetëm për atë kohë për të cilën kërkohet për të realizuar kalimin tranzit në territorin e tij.

6. Palës, së cilës i kërkohet të lejojë tranzitin, mund t'i kërkohet të japë garanci se personi i dënuar nuk do të persekutohet ose, nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin e mësipërm, që nuk do të ndalohej apo do të burgoset në ndonjë mënyrë tjetër në territorin e shtetit tranzit për ndonjë vepër të kryer apo dënim të dhënë para largimit nga territori i shtetit dënues.

7. Nuk nevojitet kërkesë për tranzit, nëse transporti bëhet me rrugë ajrore mbi territorin e palës dhe nuk është parashikuar ndonjë ndalim atje. Megjithatë çdo shtet mund të kërkojë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, që ai të njoftohet për çdo tranzit të tillë mbi territorin e vet.

Neni 17

Gjuha dhe shpenzimet

1. Informacioni në përputhje me nenin 4 paragrafi 2-4 jepet në gjuhën e palës së cilës i adresohet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës.
2. Me kufizimet e pikës 3 të mëposhtme nuk nevojitet përkthim për kërkesat e transferimeve ose të dokumenteve shtesë.
3. Secili shtet mund të kërkojë që kërkesat për transferim ose dokumentet shtesë të shoqërohen me një përkthim në gjuhët ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës ose në njërën nga gjuhët që ai bën të ditur me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në momentin e nënshkrimit ose kur të depozitohet instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit. Në këtë rast, ai mund të deklarojë gatishmërinë e vet për të pranuar përkthime në çdo gjuhë tjetër, përveç gjuhës ose gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.
4. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6.2.a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të vërtetohen.
5. Të gjitha shpenzimet e dala si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues.

Neni 18

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Ajo duhet të ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
2. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshkruar Konventës në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.
3. Për shtetet nënshkruese që e shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar Konventës pas këtij afati, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 19

Anëtarësimi nga shtetet joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, pasi të konsultohet me shtetet kontraktuese, mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit dhe që nuk përmendet në nenin 18.1 të anëtarësohet në Konventë, me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar nga neni 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

2. Për çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 20

Zbatimi territorial

1. Secili shtet mund të përcaktojë territorin në të cilin zbatohet kjo Konventë në kohën e depozitimit, miratimit ose anëtarësimit.

2. Me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në kohë të mëvonshme, secili shtet mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklaratë të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm, për territorin e specifikuar në të, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 21

Zbatimi kohor

Kjo Konventë është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 22

Marrëdhëniet me Konventat dhe Marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet si rezultat i marrëveshjeve për ekstradimin dhe marrëveshjet e tjera mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale që parashikojnë transferimin e personave të ndaluar për qëllime ballafaqimi ose deponimi.

2. Nëse dy ose më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat për transferimin e personave të dënuar, apo kanë vendosur në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhëniet e tyre për këtë çështje, apo kur kanë ndërmend ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata kanë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat në vend të kësaj Konvente.

3. Kjo Konventë nuk prek të drejtat e shteteve palë në Konventën Evropiane mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, për të përfunduar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me njëri-tjetrin për çështjet që trajtohen në Konventë, për të plotësuar dispozitat e saj, ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të shprehura në të.

4. Nëse një kërkesë për transferim futet në kuadrin e kësaj Konvente dhe të Konventës Evropiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale apo të ndonjë marrëveshjeje ose traktati tjetër për transferimin e personave të dënuar, shteti që bën kërkesën kur e bën atë, tregon se mbi bazën e cilit instrument ai e ka bërë.

Neni 23**Zgjidhje miqësore**

Komiteti Evropian për Problemet e Krimit të Këshillit të Evropës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe bën çfarëdo që të jetë e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i saj.

Neni 24**Shfuqizimi**

1. Secila palë mund të shfuqizojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Një shfuqizim i tillë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Sidoqoftë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të personave që janë transferuar në përputhje me dispozitat e Konventës para datës në të cilën ka hyrë në fuqi shfuqizimi.

Neni 25**Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet joanëtare që kanë qenë pjesëmarrëse në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shtet që është anëtarësuar në këtë Konventë për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 18.2 dhe 3, 19.2 dhe 20.2 dhe 3;
- d. çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me Konventën.

L I G J**Nr. 8499, datë 10.6.1999****PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:****Neni 1**

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” të datës 21.3.1983, me deklaratimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 3 pika 3, Shqipëria deklaron moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja “a” të kësaj Konvente.

Neni 3

Bazuar në nenin 3 pika 4 “shtetas”, për qëllim të kësaj Konvente, do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 pika 3, Republika e Shqipërisë deklaron se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2402, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

KONVENTË

MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË GREQISË PËR ZBATIMIN RECIPROK TË VENDIMEVE GJYQËSORE PËR ÇËSHTJET PENALE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë, duke dëshiruar të zgjerojnë marrëdhëniet gjyqësore midis dy shteteve dhe të çojnë përpara bashkëpunimin e tyre në sektorin gjyqësor, si dhe të lehtësojnë ripërfshirjen shoqërore të personave që janë dënuar, mbeten dakort të lidhin këtë Konventë lidhur me zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore për çështje penale dhe për këtë qëllim caktojnë si të plotfuqishëm:

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministri i Republikës së Greqisë, të cilët shkëmbyen dokumentat përkatëse të cilat u vërtetuan si ishin hartuar si duhej, vendosën dispozitat që vijojnë:

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1

1. Shtetet kontraktuese detyrohen të zbatojnë reciprokisht në bazë të kërkesës, sipas rregullave dhe kushteve që përcaktohen në nenet që vijojnë, vendimet që janë marrë për çështje penale, me anën e të cilëve një gjykatë e njërit prej shteteve kontraktuese, ka shpallur në mënyrë të parevokushme ndaj një nënshtetasi të shtetit tjetër kontraktues, një dënim ose një mase heqje lirie.

2. Kërkesa që parashikohet në paragrafin 1 depozitohet nga shteti ku është marrë vendimi gjyqësor (shteti i dënimit). Me gjithë këtë shteti ku duhet të zbatohet vendimi (shteti i zbatimit) ka të drejtë të kërkojë nga shteti i dënimit të depozitojë kërkesën në bazë të paragrafit 1.

Të drejtat e të dënuarit

Neni 2

I dënuari si dhe përfaqësuesi i tij ligjor mund të kërkojë nga njëri ose tjetri prej shteteve kontraktuese zbatimin e procedurës që parashikohet në nenin e parë. Çdo i dënuar ndaj të cilit mund të zbatohet kjo konventë duhet të informohet nga shteti i dënimit për përmbajtjen esenciale të saj.

Parashkrimi

Neni 3

Transferimi i ekzekutimit nuk bëhet në qoftë se, në bazë të legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese, dënimi ose masa e heqjes së lirisë i nënshtrohet parashkrimit.

Përfundimi i dënimit të dyfishtë

“NON BIS IN IDEM”

(Jo dy herë për të njëjtën vepër)

Neni 4

Transferimi i ekzekutimit të dënimit nuk bëhet në qoftë se në shtetin e zbatimit ka dalë tashmë vendim kundër të dënuarit për të njëjtën vepër në qoftë se ai është i pafajshëm për të njëjtin shkak.

Rendi Publik

Neni 5

Transferimi i ekzekutimit të dënimit nuk bëhet në qoftë se shteti i dënimit apo shteti i zbatimit gjykojnë se kjo mund të dëmtojë rendin e tij publik ose parimin themelor të legjislacionit të tij.

PJESA E DYTË

Transferimi i ekzekutimit dhe rezultatet e tij

Kërkesa për transferim

Neni 6

Në qoftë se shteti i dënimit gjykon se plotësohen, sipas kësaj konvente, kushtet për transferimin e ekzekutimit, mund t'i drejtojë kërkesën shtetit të ekzekutimit për transferimin e zbatimit të dënimit apo të masës me heqje të lirisë që është marrë.

Pranimi

Neni 7

Mbi bazën e kërkesës që parashikohet në nenin 6, e cila shoqërohet në dokumentet që përmenden në nenin 13, shteti i zbatimit informon shtetin e dënimit për datën dhe vendin ku do të bëhet transferimi ose dorëzimi i të dënuarit.

Nga çasti i dorëzimit veprimet e ekzekutimit të dënimit në shtetin e dënimit, pezullohen.

Zbatimi

Realizimi i zbatimit

Neni 8

1. Në rastin kur kërkesa, e cila parashikohet në nenin 6 pranohet, gjykata e shtetit të

zbatimit e zëvendëson dënimin e dhënë në shtetin e dënimit me një dënim ose me një masë analoge të heqjes së lirisë që i përgjigjet natyrës dhe kohëzgjatjes së saj.

Megjithëkëtë, në qoftë se dënimi ose masa e heqjes së lirisë për nga lloji apo kohëzgjatja e tij është e papajtueshme në legjisllacionin e shtetit të zbatimit, gjykata e këtij të fundit e përshtat atë me dënimin ose masën që parashikohet nga ligji i mundësive për nga natyra ose kohëzgjatja e saj, me atë të vendimit për zbatim. Megjithë këtë shteti i zbatimit nuk mund të kthejë një dënim me ndalim lirie në një dënim tjetër, veçse në qoftë se legjisllacioni i tij nuk parashikon dënim heqje lirie për shkeljen në fjalë. Në asnjë rast shteti i zbatimit nuk mund të bëjë vlerësimin e provave që përbëjnë bazën e vendimit të marrë në shtetin e dënimit.

2. Mënyrat e zbatimit të vendimeve duke përfshirë edhe atë të lirimit me kusht, përcaktohen nga legjisllacioni i shtetit të zbatimit.

3. Transferimi nuk duhet në asnjë rast të sjellë rëndimin e pozitës së personit të dënuarit.

4. Kohëzgjatja e arrestimit në shtetin e dënimit duhet të llogaritet tërësisht në zgjatjen e dënimit ose të masës që do të vuhet në shtetin e zbatimit.

Rezultatet e zbatimit

Neni 9

1. Me rezervën e dispozitave të nenit 8, vendimi i shtetit të dënimit ka, në rast transferimin të zbatimit, po ato rezultate ligjore në shtetin e zbatimit me ato që kanë vendimet për çështjet penale në këtë të fundit.

2. Në qoftë se i dënuari i shmanget zbatimit të mësimin në shtetin e zbatimit, shteti i dënimit merr përsipër të drejtën e tij për zbatimin e dënimit për pjesën e mbetur.

3. E drejta e zbatimit të shtetit të dënimit pushon definitivisht së ekzistuari në qoftë se i dënuari ka vuajtur dënimin ose është liruar definitivisht.

Falja, amnistia, përsëritja e procedimit

Neni 10

1. Çdo njeri nga të dy shtetet mund të japë amnisti apo falje.

2. Shteti i dënimit, dhe vetëm ai, ka të drejtën të vendosë për çdo kërkesë për përsëritje të procedimit që drejtohet kundër vendimit.

Informimi

Neni 11

1. Shteti i dënimit detyrohet të informojë shtetin e zbatimit për amnistinë, faljen dhe kërkesën për përsëritje të procedimit, eveniment tjetër që mund të ndikonte në zbatim.

2. Shteti i zbatimit informon shtetin e dënimit për përfundimin e zbatimit.

Transportimi dhe Kalimi Tranzit

Neni 12

1. për dorëzimin e të dënuarit në shtetin e zbatimit do të zbatohet “Mutatis Mutandis” neni 44 i Konventës midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë lidhur me ndihmën reciproke gjyqësore për çështjet civile dhe penale që u nënshkruan.

2. Neni 46 i Konventës midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë lidhur me kontributin reciprok gjyqësor për çështjet civile dhe penale që u nënshkrua do të zbatohet “Mutatis Mutandis” gjatë tranzitit të një dënuari nëpërmjet tokës së njërit prej Shteteve Kontraktuese në një shtet të tretë ose nga një shtet i tretë në njërin prej Shteteve Kontraktuese për zbatimin e një dënimi ose të një mase me heqje lirie që është marrë ndaj tij.

PJESA E TRETË

PROCEDURA

KËRKESA DHE DOKUMENTAT BASHKËNGJITUR SAJ

Neni 13

1. Kërkesa që parashikohet në nenin 6 të kësaj Konvente bëhet me shkrim.

2. Kërkesa shoqërohet:

- a) me kopje ose kopje zyrtare të vendimit bashkë me vërtetimin që flet për kryerjen e gjykimit dhe karakterin e tij të zbatueshëm
- b) me tekstin e dispozitave ligjore që janë zbatuar;
- c) me informacione të sakta për të dënuarin, nënshtetësinë e tij, banesën e tij dhe vendin e qëndrimit të zakonshëm të tij, kur kjo është e mundshme;
- ç) me një çertifikatë ku tregohet kohëzgjatja e arrestimit për kompensimin e tij;
- d) me një dokument që vërteton dhënjen e pëlqimit të burgosurit (arrestuarit) për transferimin;
- dh) me raport mjekësor për situatën shëndetësore të të dënuarit dhe çdo dokument tjetër të rëndësishëm që lidhet me shqyrtimin e çështjes.

Plotësimi i Kërkesës

Neni 14

Në qoftë se shteti i zbatimit gjykon se të dhënat dhe dokumentet e bashkëngjitura që i jepen janë të pamjaftueshme, kërkon plotësimin e informacioneve të nevojshme. Ai mund të caktojë një afat për marrjen e këtyre të dhënave plotësuese, i cili mund të zgjatet me kërkesë të arsyetuar. Në mungesë të të dhënave plotësuese, shteti i zbatimit vendos në bazë të të dhënave dhe të dokumentave të bashkëngjitura që janë vënë në dispozicion të tij.

Natyrë dhe Komunikimi

Neni 15

Për vetë natyrën e kësaj Konvente shërbimi i dokumentave bëhet nëpërmjet Ministrive të Drejtësisë të Shteteve Kontraktuese. Kjo nuk përjashton përdorimin e rrugëve diplomatike.

Gjuha Miratimi

Neni 16

Kërkesat dhe njoftimet si dhe dokumentat që u bashkëngjiten atyre, në zbatim të kësaj Konvente, nuk i nënshtrohen miratimit dhe shoqërohen me përkthim në gjuhën e shtetit të cilit i drejtohet ose njoftimi ose në përkthim në gjuhën frënge.

Shpenzimet

Neni 17

Shpenzimet që kryhen si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente rëndojnë mbi shtetin e zbatimit përjashtuar shpenzimet që bëhen ekskluzivisht në tokën e shtetit të dënimit.

PJESA E KATËRT

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 16

Kjo konventë nuk prek detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet shumëpalëshe në fuqi.

Neni 19

Kjo Konventë do të ratifikohet dhe dokumentet e ratifikimit do të shkëmbehen në Tiranë.

Neni 20

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë të shkëmbimit të dokumentave të ratifikimit.

2. Kjo Konventë lidhet për një afat të pakufizuar.

Secila nga palët kontraktuese mund ta denoncojë atë duke i drejtuar tjetrit në rrugë diplomatike një denoncim paralajmërues me afat deri në 6 muaj. Megjithatë kjo Konventë do të vazhdojë të zbatohet për personat e dënuar që janë transportuar në bazë të Konventës në fjalë, para hyrjes në fuqi të denoncimit.

Për vërtetimin e sa më sipër, Kryeministrat e Palëve Kontraktuese nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Athinë, 17 Maj 1993, në dy kopje në gjuhët shqipe dhe greke të cilat kanë të njëjtën vlerë.

KONVENTË**MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË GREQISË
PËR TRANSFERIMIN E TË DËNUARVE TË BURGOSUR**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë, të nisura nga dëshira për të thelluar më tej bashkëpunimin në fushën penale, ranë dakort për të lidhur një Konventë për transferimin e të dënuarve të burgosur, dhe në këtë frymë, Kryeministrat e dy vendeve, dhanë pëlqimin e tyre përsa vijon:

Parimet Themelore**Neni 1**

Sipas kësaj Konvente:

- a) Shprehja “shtet i dënimit” nënkupton shtetin në të cilin fajtori është dënuar dhe nga i cili ai transferohet;
- b) Shprehja “shtet i ekzekutimit” nënkupton shtetin në të cilin transferohet i dënuari për të vuajtur dënimin;
- c) Shprehja “i dënuar, i burgosur” nënkupton të gjithë personat që, duke u bërë objekt i vendimit gjyqësor të fajësisë në territorin e njërit apo tjetrit shtet janë të detyruar të vuajnë dënime me heqje të lirisë dhe që ndodhen në gjendje burgosjeje.

Neni 2

Të dy shtetet angazhohen të kryejnë reciprokisht, në kushtet që parashikon kjo Konventë, transferimin e personave të dënuar si më poshtë:

Neni 3

Kërkesa për transferim mund të paraqitet:

- a) Nga shteti i dënimit;
- b) Nga shteti i ekzekutimit;
- c) Nga vetë i dënuari. Ky i fundit mund të paraqesë kërkesën në fjalë në njërin apo tjetrin nga dy shtetet.

Neni 4

Kjo Konventë zbatohet në kushtet që vijojnë:

- a) Vepra për të cilën i dënuari i burgosur ka bërë kërkesën duhet të jetë e dënueshme nga ligjet e secilit prej të dy vendeve;
- b) Vendimi gjyqësor që shpall dënimin duhet të jetë i formës së prerë dhe i vënë në ekzekutim;
- c) I dënuari i burgosur duhet të jetë i ndërgjegjshëm nga ana psikike;
- d) I dënuari i burgosur duhet të ketë ende për të vuajtur në momentin e bërjes së kërkesës për transferim, të paktën dhe një vit heqje lirie.

Në raste të veçanta të dy shtetet mund të ndërmerren vesh për një transferim dhe po qe se koha e dënimit për t'u dënuar është më e vogël.

Neni 5

Shteti i dënimit njofton shtetin e ekzekutimit të dënimit për gjithçka rreth dënimit që jepet ndaj një shtetasi të tij që mund të realizohet transferimin duke aplikuar këtë Konventë.

Autoritetet kompetente të shtetit të dënimit informojnë të gjithë shtetasit e Shtetit tjetër, që janë bërë objekt i një dënimi të formës së prerë, për mundësitë që ua ofron atyre kjo Konventë lidhur me transferimin për ekzekutimin e dënimit në vendin, shtetas të të cilit ata janë.

I dënuari duhet të njoftohet me shkrim për gjithë vendimet që mund të merren në një nga dy shtetet si rrjedhojë e kërkesës së transferimit.

Neni 6

Transferimi i të dënuarit refuzohet kur:

- a) Kur transferimi, sipas njërit nga dy shtetet konsiderohet se është i natyrës që shkakton cënimin e sovranitetit të sigurisë së tij, të rendit publik apo të parimeve themelore të shtetit ligjor;
- b) Nëse kërkesa për transferimin ka të bëjë me një dënim të shpallur për vepra të gjykuara me vendim që ka marrë formën e prerë në “shtetin e ekzekutimit”, për të cilat dënimi është i ekzekutuar ose i parashkruar.
- c) Parashkrimi i ndjekjes penale fitohet sipas ligjit të shtetit ekzekutues;
- d) Dënimi është shpallur për një vepër penale në fushën ushtarake;

Neni 7

Transferimi mund të refuzohet kur:

- a) Autoritetet kompetente të shtetit ekzekutues kanë vendosur të mos fillojnë ndjekjet penale ose t'u japin fund atyre, për të njëjtat fakte.
 - b) Faktet që përbëjnë motivin e dënimit janë objekt ndjekjeje në shtetin ekzistues;
 - c) Kur i dënuari nuk ka shlyer detyrimet në të holla, gjobat, shpenzimet gjyqësore, e dënimet në të holla të të gjitha llojeve që i janë vënë në ngarkim.
 - d) I dënuari ka, gjithashtu, shtetësinë e shtetit “të dënimit”.
- Cilësia e shtetësisë vlerësohet në çastin e dhënies së fakteve që kanë motivuar dënimin.
- e) Dënimi maksimal me heqje të lirisë parashikuar nga ligji i shtetit ekzistues është shumë i ulët se ai i dhënë nga shteti dënues.

Neni 8

1. Idënuari duhet të japë pëlqimin e tij për transferimin sipas nenit 3 shkronja “a” dhe “b” dhe të jetë në dijeni të plotë të pasojave juridike që rrjedhin. Kur për shkak të moshës, të gjendjes fizike apo mendore të metë të të dënuarit dhe njëri nga shtetet e

çmon të nevojshëm pëlqimin, jepet nga përfaqësuesi i tij. Procedura e ndjekjes në këtë rast rregullohet nga e drejta e shtetit dënues.

2. Shteti i dënimit duhet t`i japë shtetit ekzistues mundësinë të verifikojë me ndërmjetësinë e një këshilltari funksionar, nëse pëlqimi për transferimin është dhënë sipas kushteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 9

1. Dënimi i shpallur në shtetin dënues është i ekzekutueshëm për pjesën e mbetur të dënimit në këtë shtet, në shtetin ekzistues, në përputhje me nenin 11 të kësaj Konvente.

2. Kur dënimi i dhënë nga shteti dënues është, për nga natyra ose kohëzgjatja, më i rreptë se sa ai i parashikuar nga ligji i shtetit ekzistues për të njëjtat fakte, autoriteti kompetent i këtij të fundit zëvendëson dënimin me heqje të lirisë që i korrespondon më shumë në legjislacionin e vet, ose zvogëlon në maksimum dënimin e shpallur dhe të zbatuar ligjërisht në shtetin e ekzekutimit.

Dënimi i zëvendësuar nuk mund të rëndojë si nga detyra ashtu dhe nga kohëzgjatja dënimin me heqje lirie të shpallur nga shteti dënues dhe as të kalojë maksimumin e parashikuar nga ligji i shtetit ekzistues.

Neni 10

Shteti ekzistues njofton shtetin dënues nëse ai e kërkon këtë, për ecurinë e mëtejshme të ekzekutimit të dënimit.

Neni 11

Modalitetet e ekzekutimit të dënimit rregullohen nga ligji i shtetit ekzekutues që është kompetent i vetëm për të marrë të gjitha vendimet që lidhen me çështjen në fjalë.

Neni 12

Çdonjë nga shtetet mund të japë faljen, amnistinë ose zëvendësimin e dënimit me përputhje me Kushtetutën e vet ose të rregullave të tjera të veta juridike.

Neni 13

Vetë shteti i dënimit ka të drejtën të vendosë për të gjithë apelimet në lidhje me kundërshtimin e dënimit.

Neni 14

1. Sheti i dënimit, njofton pa vonesë Shtetin ekzekutues për të gjitha vendimet ose masat që përfundojnë plotësisht ose pjesërisht ekzekutimin e dënimin.

2. Autoritetet kompetente të shtetit ekzekutues përfundojnë ekzekutimin e dënimit

sapo të jenë njoftuar për gjithë vendimin ose masat që lidhen me heqjen e karakterit ekzekutiv të dënimit.

Neni 15

Asnjë i dënuar i transferuar në zbatim të kësaj Konvente nuk mund të ndiqet përsëri, të arrestohet ose të burgoset në shtetin ekzekutues për një shkelje që sjell një dënim të shpallur nga shteti dënues dhe që bëhet shkak për transferimin.

PROCEDURA

Neni 16

Të gjithë kërkesat për transferimin duhet të jenë me shkrim. Aty tregohet identiteti i të dënuarve, vendi i tij i burgosjes në shtetin dënues dhe vendi i tij i banimit në shtetin ekzekutues. Ajo shoqërohet me një deklaratë që përmban pëlqimin e dhënë nga i dënuari ose përfaqësuesi i tij për transferimin.

Neni 17

Shteti i dënimit i dërgon shtetit ekzekutues origjinalin ose një kopje autentike të vendimit të dënimit. Në të vërtetohet karakteri i ekzekutimit i vendimit dhe precizohen, në të gjitha masat e mundshme, rrethanat e veprës penale; koha dhe vendime të cilin është kryer ashtu si dhe cilësimi i saj ligjor. Ai jep tërë dokumentacionin e nevojshëm mbi kohën e dënimit që ka mbetur për të vuajtur mbi datën e arrestimit, pjesën e dënimit të vuajtur si dhe për uljen e dënimit tashmë të akorduar ashtu si dhe mbi personalitetin e të dënuarit dhe sjelljen e tij në shtetin e dënimit para dhe pas shpalljes së vendimit të dënimit.

Shteti ekzekutues i bën të ditur shtetit dënues parapranimin të kërkesës për transferim, dënimin maksimal të parashikuar nga legjislacioni i vet për të njëjtat fakte.

Nëse njeri nga dy shtetet çmon se dokumentet e paraqitura nga shteti tjetër janë të pamjaftueshme për të bërë të mundur zbatimin e kësaj Konvente, ai kërkon plotësimin me informacionet e nevojshme.

Neni 18

Kërkesa për transferimin i kalohet Ministrisë së Drejtësisë së Shtetit që merr kërkesën nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues.

Neni 19

Pjesët dhe dokumentacioni që transmetohet në zbatim të kësaj Konvente kërkojnë të gjitha formalitetet e legalizimit, të jenë të pajisur me firmën dhe më vulën e Autoritetit Kompetent.

Neni 20

1. Shpenzimet e transferimit janë në ngarkim të shtetit që ka bërë kërkesën e transferimit, me përjashtim të rasteve të shpenzimeve që bëhen në territorin e shtetit tjetër.
2. Nëse transferimi kërkohet nga vetë i dënuari shpenzimet e transferimit, po qe se vërtetohet se nuk mund të paguhen nga ky i fundit, janë në ngarkim të shtetit ekzekutues.
3. Shteti që përgjigjet për shpenzimet e transferimit siguron eskortën. Në rastin e paragrafit të mësipërm, eskorta sigurohet nga shteti ekzistues me shpenzimet e tij.
4. Shteti ekzistues nuk mundet në asnjë rast të kërkojë pagimin e shpenzimeve të kërkuara prej tij për ekzekutimin e dënimit dhe mbikëqyrjen e të dënuarve.

Neni 21

Kërkesa e transferimit me pjesët dhe dokumentat të cilat mbështesin informacionin që shkëmbehet në lidhje me këtë Konventë duhet të jetë redaktuar në gjuhën e shtetit që merr kërkesën dhe të jetë shoqëruar me një përkthim zyrtar në gjuhën e shtetit.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 22

1. Kjo Konventë hyn në fuqi një muaj pas nënshkrimit të saj.
2. Secila nga të dy shtetet mund të denoncojë në çdo kohë këtë Konventë pa patur rëndësi koha në të cilën bëhet denoncimi, i cili bëhet në rrugë diplomatike me anë të një njoftimi me shkrim. Në këtë rast denoncimi ka efekt një vit pas datës së marrjes së këtij njoftimi.
Për vërtetimin e sa më sipër, u nënshkrua kjo Konventë në dy kopje, në gjuhët shqipe dhe greke, të cilat kanë të njëjtën vlerë.

Bërë në Athinë, më 17 maj 1993.

Rekomandim Nr. R (89) 12
i Këshillit të Europës mbi Edukimin në burgje

(adoptuar nga Komiteti i Ministrave më 13 Tetor 1989 në takimin e 429-të)

4. Të gjithë të dënuarit duhet të edukohen dhe kjo duhet të realizohet nëpërmjet klasave mësimore, edukimit profesional, aktiviteteve kulturore dhe krijuese, sporteve dhe edukimit fizik, edukimit social dhe shërbimit bibliotekar.
5. Edukimi për të burgosurit duhet të jetë njëloj si ai që u sigurohet grupmoshave të ngjashme jashtë burgut dhe se vargu i mundësive të mësimi duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur.
6. Edukimi në burg duhet të ketë qëllim zhvillimin e personit në tërësi duke e ndërgjegjësuar për gjendjen e tij social-ekonomike dhe kulturore.
7. Të gjithë ata që përfshihen në sistemin e burgjeve duhet të lehtësojnë dhe mbështesin edukimin sa më shumë të jetë e mundur.
8. Edukimi nuk duhet të mbetet vetëm në letra, por edhe në punën që duhet të bëhet brenda regjimit të burgut dhe nga pjesëmarrja në edukim të burgosurit nuk duhet të humbin as financiarisht dhe as në ndonjë mënyrë tjetër.
9. Duhet të bëhet çdo përpjekje për të inkurajuar të burgosurit të marrin pjesë aktivisht në të gjitha aspektet e edukimit.
10. Duhet të sigurohen programe zhvillimi për edukatorët e burgjeve në mënyrë që të adaptojnë metoda të përshtatshme për edukimin e të rinjve.
11. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë të burgosurve me probleme të veçanta dhe sidomos atyre që nuk dinë shkrim dhe lexim.
12. Edukimi profesional duhet të synojë një zhvillim të gjerë të individit dhe duhet të jetë i ndjeshëm ndaj tendencave të tregut të punës.
13. Të burgosurit duhet t'i ofrohet direkt shërbimi i bibliotekës të paktën një herë në javë.
14. Duhet të theksohet dhe inkurajohet edukimi fizik dhe sportet për të dënuarit.
15. Duhet t'u jepet rëndësi e madhe aktiviteteve kulturore dhe kreative, sepse ato kanë një fuqi të veçantë për t'i aftësuar të burgosurit të shprehin vetveten.
16. Edukimi social duhet të përfshijë elementë të veçantë që aftësojnë të burgosurin të organizojë jetën e përditshme në burg dhe për të lehtësuar kthimin në shoqëri.
17. Kur është e mundur, të burgosurit duhet të lejohen të marrin pjesë në edukim jashtë burgut.
18. Kur edukimi bëhet brenda burgut, komuniteti i jashtëm duhet të përfshihet sa më shumë të jetë e mundur.
19. Duhet të merren masa për të aftësuar të burgosurit që të vazhdojnë edukimin edhe pas lirimit nga burgu.
20. Duhet të vihen në dispozicion fondet, pajisjet dhe stafi mësimor i nevojshëm për të aftësuar të burgosurit të marrin edukimin e përshtatshëm.

L I G J**Nr. 8328 DATË 10.3.2008****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8328, DATË 16.4.1998 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM”, TË NDRYSHUAR**

Ndryshuar me ligjin Nr. 8758, dt. 26.03.2001, Ndryshuar me ligjin Nr. 9071, dt. 22.05.2003, Ndryshuar me ligjin Nr. 9888, dt. 10.03.2008

PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****V E N D O S I:****PJESA E PARË****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****KREU I****OBJEKTI****Neni 1**

Ky ligj përcakton të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente.

Neni 2

I nënshtrohen rregullave të këtij ligji të gjithë të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale, si dhe të paraburgosurit

Neni 3

Vuajtja e dënimeve me burgim bëhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht sipas këtij ligji. Ministri i Drejtësisë në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të rrezikimit nga forca madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme, si dhe kur rrezikohet jeta dhe shëndeti i të dënuarve, mund të urdhërojë që vuajtja e dënimit të bëhet përkohësisht në vende të tjera të përshtatshme.

KREU II

PARIMET THEMELORE

Neni 4

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ekzekutimi i dënimit me burgim bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe përshkohet nga ndjenja njerëzore.

Trajtimi i të dënuarve bëhet pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar.

Të dënuarve duhet t'u sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë.

Neni 5

KUFIZIMI INDIVIDUAL I TË DREJTAVE

Të drejtat e të dënuarve, sipas këtij ligji, mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht për shkelje të ligjit ose rregullave të brendshme, vetëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 6

KUFIZIMI NË GRUP I TË DREJTAVE

Të drejtat e të dënuarve mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, për shkak të forcës madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme në institucion ose kur ka rrezik për jetën dhe shëndetin e të dënuarve në atë masë dhe për aq kohë sa përcaktohet në urdhër.

Drejtuesi i institucionit dhe në mungesë të tij zëvendësi, për rastet urgjente mund të vendosin kufizime sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe jo më vonë se 24 orë të marrë për këtë miratimin e ministrit të Drejtësisë.

Neni 7

E DREJTA E KËRKESËS DHE ANKIMIT

Të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale.

Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por të dënuarit kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

KREU III**TRAJTIMI**

Neni 8

REHABILITIMI SOCIAL

Për të dënuarit duhet të realizohet një trajtim që synon Rehabilitimin social për integrimin e tyre në jetën shoqërore.

Neni 9

INDIVIDUALIZIMI I TRAJTIMIT

Trajtimi i të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar.

Individualizimi bëhet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar atë nga jeta normale.

Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura.

Neni 10

PROGRAMI DHE REALIZIMI I TRAJTIMIT

Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhet nga administrata e burgut me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse. Kontributi i organizatave joqeveritare dhe individëve të veçantë, inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

PJESA E DYTË

INSTITUCIONET

KREU I

LLOJET E INSTITUCIONEVE

Neni 11

INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PENALE

- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim janë:
- Burgu i sigurisë së lartë
- Burgu i zakonshëm
- Burgu i sigurisë së ulët
- Institute të veçanta, Institute të paraburgimeve
- Krijimi, klasifikimi, mbyllja e institucioneve të ekzekutimit

të vendimeve penale me burgim apo seksioneve të veçanta në këto Institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 12

BURGU I SIGURISË SË LARTË

Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.

Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Kur i dënuari vuan dënimin dhe është vendi për transferimin e tij në një burg të sigurisë së lartë, sipas kritereve të këtij ligji, kërkesa e prokurorit i paraqitet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni. Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vetë të dënuarit, pranë gjykatës ku ndodhet institucioni.

Në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Në burgjet e kategorive të tjera me urdhër të ministrit të Drejtësisë mund të krijohen seksione të burgut të sigurisë së lartë, në të cilat zbatohen rregullat e mësipërme.

Neni 13

BURGU I SIGURISË SË ZAKONSHME

Burgjet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku vuhet dënimi nga gjithë të dënuarit, me përjashtim të atyre që vendosen në burgjet e sigurisë së lartë, në burgjet e sigurisë së ulët dhe në institucione të veçanta.

Kur gjykata, në vendimin me burgim, nuk është shprehur për llojin e Institucionit, ku do të vuhet dënimi, të dënuarit vendosen në një burg të sigurisë së zakonshme.

Shpërndarja dhe transferimi i të dënuarve në burgjet e sigurisë së zakonshme bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në burgjet e sigurisë së zakonshme mund të krijohen seksione të sigurisë së ulët

Neni 14

BURGU I SIGURISË SË ULËT

Burgjet e sigurisë së ulët janë institucionet ku vuhet dënimi për të dënuar për kundërvajtje penale për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon 5 vjet burgim.

Drejtori i Përgjithshëm i burgjeve, me kërkesë të Drejtorit të institucionit ku i dënuari po vuan dënimin, apo me nismën e vet, për të dënuarit që u ka mbetur për të vuajtur më pak se 2 vjet burgim dhe kanë respektuar rregulloren e brendshme të institucionit, mund të vendosë transferimin e tyre në një burg të sigurisë së ulët.

Neni 14/1

Institucionet e paraburgimit

Institucionet e paraburgimit janë institucionet, ku mbahen individët, ndaj të cilëve është dhënë nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”

Neni 15

INSTITUTET PËR TË SËMURËT DHE TË PAAFTËT

Institucionet mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve shërbejnë për mjekimin e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore ose psikike.

Vendosja e personave në këto institucione dhe seksione mund të parashikohet që në fillim në vendimin e dënimit ose gjatë ekzekutimit të dënimit, me miratim të prokurorit dhe në raste që nuk presin, edhe nga drejtori i burgut, ku ndodhet i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

Dalja nga këto institucione bëhet me propozim të drejtuesit të institucionit dhe me miratim të prokurorit.

Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes, i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

Në institucionet dhe seksionet e mjekimit respektohen të gjitha të drejtat e të dënuarve sipas këtij ligji, për aq sa janë të zbatueshme në kushtet spitalore. Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të këtij ligji në to.

Me urdhër të prokurorit në këto institute mund të vendosen edhe të dënuar që kanë profesione që lidhen me mjekësinë ose fusha të tjera të nevojshme, kur për ta nuk ka pengesa sipas këtij ligji.

Vendosja e të dënuarve në këto institute bëhet nga gjykata në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në këto institute, me rekomandim të shërbimit mjekësor të burgjeve ose të institucioneve të tjera mjekësore, të dënuarit me burgim transferohen me urdhër të prokurorit.

Dalja dhe vendosja e të dënuarve në burgje bëhet nga organi që ka vendosur ekzekutimin e vendimit në institut.

Neni 16

VENDET E DËNIMIT PËR GRATË DHE TË MITURIT

Gratë dhe të miturit rregullisht e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për to dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji.

Nënave u lejohet që të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme.

Neni 17

RREGULLORJA E BRENDSHME E INSTITUCIONEVE

Çdo institucion ka rregulloren e brendshme, të dalë mbi bazë të rregullores së burgjeve, që përcakton organizimin, disiplinën e brendshme dhe kërkesat e trajtimit në kushtet e institucionit.

Rregullorja e brendshme përgatitet nga një komision i caktuar dhe i kryesuar nga drejtori i institucionit dhe miratohet nga ministri i Drejtësisë.

KREU II

ORGANET DREJTUESE TË BURGJEVE

Neni 18

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është organ qendror, Në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila organizon, Drejton dhe kontrollon të gjitha Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 19

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë institucione në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe kanë për detyrë pritjen, sistemimin, Trajtimin dhe rehabilitimin social të të burgosurve.

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale drejtohen, kontrollohen dhe përfaqësohen nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 20

PERSONELI ZBATUES

Personeli zbatues realizon dhe përgjigjet për zbatimin e programit të trajtimit sipas detyrës së caktuar.

Neni 21

POLICIA E BURGJEVE

Policia e burgjeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është në varësi të ministrit të Drejtësisë, e cila realizon ruajtjen e institucioneve nga jashtë, mbështet dhe garanton realizimin e veprimtarisë së institucionit në zbatim të ligjit “Për Policinë e Burgjeve”.

KREU III

KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCION

Neni 22

NDËRTESTAT

Ndërtesat e instituteve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhen të projektohen, të ndërtohen apo të rikonstruktohen, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale. Ato duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të dënuarve apo të paraburgosurve.

Rregullat dhe kriteret e hollësishme për kushtet teknike, që duhet të plotësojnë ndërtesat e reja të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit që mbulon fushën e ndërtimit.

Neni 23

MJEDISËT E QËNDRIMIT DHE TË FJETJES

Mjediset, në të cilat jetojnë të dënuarit, duhet të kenë hapësira të mjaftueshme, me ndriçim të nevojshëm natyror dhe artificial, për të bërë të mundur qëndrimin, punën dhe çlodhjen aktive, të ajrosura dhe të pajisura me shërbimet higjienike. Atje ku e kërkojnë kushtet klimaterike duhet të sigurohet edhe ngrohja e mjediseve.

Kur nuk është e mundur të sigurohet fjetja në dhoma individuale, caktimi i të dënuarve në të njëjtën dhomë duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të shmangen konfliktet dhe ndikimet negative të ndërsjella. Për këtë qëllim përdoren kriteret e grupmoshave, të llojit të veprave penale të kryera dhe të veçorive intelektuale e psikike të të dënuarve.

Për çdo të dënuar sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.

Kuotat minimale për sipërfaqet, vëllimet, ndriçimin dhe ajrimin e mjediseve për të dënuarit, caktohen në rregulloren e burgjeve, sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 24

VESHJA DHE PAJISJET

Çdo të dënuari i sigurohet veshmbathje dhe pajisje të tjera individuale në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastra, të tilla që të sigurojnë plotësimin e kërkesave normale të jetesës.

Të dënuarit mund të mbajnë me leje të administratës, veshmbathje dhe sende të përdorimit vetjak, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të përshtatshme, si dhe të objekteve që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale.

Neni 25

HIGJIENA VETJAKE DHE E MJEDISIT

Të dënuarit i sigurohen mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake.

Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të mjediseve, veshmbathjes dhe pajisjeve vetjake, si dhe të qethjes dhe të rruajtjes.

Higjiena vetjake, qethja dhe rruajtja mund të bëhen me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjieno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.

Neni 26

USHQIMI

Të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën, klimën dhe stinën.

Ushqimi përgatitet dhe jepet si rregull në mjedise të caktuara për këtë qëllim. Me leje të drejtorit të institucionit, në raste të veçanta, të dënuarit mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht.

Norma e ushqimit ditor përcaktohet nga tabelat përkatëse të miratuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Administrata e institucionit pranon ushqime tërësisht ose pjesërisht për të dënuarit ose i siguron ato me shpenzimet e tij duke respektuar kufijtë e rregullores së brendshme.

Të dënuarve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm.

Neni 27

KOHA E AJRIMIT

Të dënuarit që nuk punojnë jashtë dhe të gjithë të dënuarit e tjerë, në ditët që nuk punohet, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë.

Kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 1 orë në ditë për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit.

Ajrimi në mjedise të hapura bëhet në grupe, përveç rasteve të parashikuara në nenin 53 shkronjat “c” “ç” dhe “d”.

PJESA E TRETË

PRANIMI DHE TRAJTIMI I TË DËNUARVE NË INSTITUCION

KREU I

PRANIMI

Neni 29

PRANIMI I TË DËNUARVE

Në çdo institucion krijohet një shërbim për të pranuar të sapoardhurit, për t'u dhënë informacion fillestar mbi rregullat e burgut dhe për të parandaluar ndikimet negative nga ndryshimi i mjedisit ose rreziqet e mundshme për të dënuarit e tjerë.

Me pranimin në institucion, i dënuari i nënshtrohet menjëherë një vizitë mjekësore të përgjithshme dhe analizave përkatëse për përcaktimin e gjendjes shëndetësore, veçorive fizike dhe psikike, si dhe të aftësisë për punë.

Mbi bazën e dokumentacionit shoqërues dhe shpjegimeve gojore, formulohen të dhënat individuale të të dënuarit lidhur me personalitetin e tij.

Mbi bazën e këtyre të dhënave përpilohet kartela e vëzhgimit paraparak të të dënuarit dhe programohet trajtimi individual i tij.

Neni 30

DIFERENCIMI I INSTITUCIONEVE PËR QËLLIME TRAJTIMI CAKTIMI DHE GRUPIMI I TË DËNUARVE

Institucionet dhe seksionet e veçanta janë të organizuara sipas nevojave të trajtimit individual ose në grup të të dënuarve.

Numri i të dënuarve në institucione dhe në seksione përgjithësisht, sistemimi dhe aktivizimi i tyre posaçërisht janë të kufizuara në atë masë që të favorizojnë trajtimin e individualizuar.

Lejohet pranimi i të dënuarve në veprimtari të veçanta, të organizuara në institucione ose seksione të një kategorie të ndryshme nga ato ku janë caktuar, me përjashtim të atyre të sigurisë së lartë.

Grupimi i të dënuarve brenda institucioneve të veçanta bëhet duke pasur parasysh mundësinë që ata të përfitojnë nga një trajtim i diferencuar në grup, në përputhje me kërkesat dhe angazhimin e tyre.

Duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të dënuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre.

KREU II**DREJTIMET DHE FORMAT E TRAJTIMIT**

Neni 31

TRAJTIMI

Trajtimi i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset e përshtatshme dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

Objektivat e trajtimit përfshijnë arsimimin, formimin profesional, zhvillimin e aftësive të tjera individuale, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, punën, asistencën shpirtërore dhe veprimtari të tjera në grup që kanë si qëllim rikrijimin e aftësisë për t'i integruar në shoqëri.

Trajtimi social-edukativ i të dënuarve zhvillohet me anë të veprimeve individuale dhe të veprimtarive formuese, që realizohen nga ana e personelit të burgjeve të aftësuar posaçërisht në fushën pedagogjike, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit.

Kontaktet me botën e jashtme dhe familjen inkurajohen dhe sigurohen sipas programeve individuale dhe grupore.

Neni 32

SHËRBIMI MJEKËSOR

Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve.

Administrata e Institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve.

Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit, në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë.

Të dënuarit mund të kërkojnë që të vizitohen, me shpenzimet e tyre, nga një mjek që duan ata.

Shërbimi Shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Diagnostifikimin dhe mjekimin e sëmundjeve
2. Furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore
3. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse
4. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të dënuarve.

Çdo institucion ka shërbim shëndetësor e farmaceutik, që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të dënuarve.

Të dënuarit që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse, izolohen menjëherë në mjedise të posaçme.

Në institucionet ku vuajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale në shërbim të grave shtatzëna dhe të atyre me fëmijë në gji. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të dënuarit e sëmurë e ato që bëjnë kërkesë dhe kontrollon, periodikisht, të gjithë të dënuarit e tjerë, sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit. Personeli mjekësor evidenton dhe njofton menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostifikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohet në kushtet e institucionit, të dënuarit transferohen në spitalin e burgjeve dhe kur është e nevojshme, ata transferohen në Qendrën Spitalore Universitare, Tirane e në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi në varësi të saj.

Diagnostifikimi dhe mjekimi në këto qendra bëhen sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Shëndetësisë.

Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të dënuarit, ai transferohet për mjekim në spitalin e burgjeve ose në spitalet rajonale.

Institucionet rajonale higjieno-sanitare vizitojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për kontrollin e gjendjes higjieno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor i institucionit, për parandalimin e sëmundjeve infektive.

Neni 33

PUNËSIMI

Të gjithë të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria brenda dhe jashtë institucionit duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera.

Gjatë vuajtjes së dënimit me burgim nuk mund të detyrohen të punojnë të dënuarit që kanë plotësuar kushtet për pension pleqërie, që janë invalidë të grupit të parë dhe të dytë, gratë shtatzëna, për aq kohë sa parashikon ligji në fuqi, si dhe personat që nuk janë në gjendje fizike dhe shëndetësore të kryejnë punën që u ofrohet. Të dënuarit që kanë probleme psikike mund të vihen në punë kur kjo i shërben qëllimeve terapeutike.

Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

KUSHTET E PUNËS

Kushtet e punës duhet të jenë si në shoqërinë e lirë, me qëllim që të dënuarit të përfitojnë aftësi profesionale për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Të dënuarit që tregojnë aftësi për veprimtari shkencore, kulturore, artistike ose të artizanatit, mund të lejohen që të ushtrojnë me shpenzimet dhe për llogari të tyre këto veprimtari.

Kohëzgjatja e punës nuk mund të kalojë kufijtë e përcaktuar nga Kodi i Punës.

Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Neni 35

CAKTIMI I PUNËS

Objekti i punës duhet t'u përshtatet kërkesave të veçanta të personalitetit të secilit nga të dënuarit në perspektivën e riintegritimit në shoqëri.

Kur në institucion nuk është e mundur të sigurohet puna për të dënuarit, tërësisht ose pjesërisht, mund të sigurohen fronte pune jashtë institucionit, duke aktivizuar të dënuarit me kriterin e aftësisë për punë, formimin profesional dhe duke preferuar të dënuarit që kanë pasur më pak aktivizim pune.

Në çdo rast, dalja jashtë institucionit dhe kryerja e punës bëhen gjithmonë të shoqëruar nga personeli i institucionit dhe të ruajtur nga policia e burgjeve.

Neni 36

ARSIMIMI

Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas sistemeve në fuqi.

Nxitet kryerja dhe favorizohet ndjekja e studimeve profesionale, duke përdorur kurset me korrespondencë.

Favorizohet leximi pa kufizim i publikimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.

Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të dënuarve me moshë nën 25 vjeç.

Neni 37

VEPRIMTARITË KULTURORE, ÇLODHËSE E SPORTIVE

Organizimi i veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive duhet të synojë ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike, shpirtërore dhe psikike të të dënuarve.

Neni 38

MJEDISËT DHE KUSHTET MATERIALE TË TRAJTIMIT

Në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe riedukimit, sipas kërkesave të trajtimit, duhet të sigurohen mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale.

Institucionet duhet të jenë të pajisura me një bibliotekë librash dhe botime periodike.

Neni 39

LIDHJET ME FAMILJEN

Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të dënuarve me familjen.

I dënuari mund të informojë menjëherë familjarët për futjen e tyre në një institucion ose kur transferohet prej tij.

Në rast vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike të një të dënuari, duhet të njoftohen menjëherë familjarët.

Institucioni njofton menjëherë të dënuarin kur vihet në dijeni për vdekjen e të afërmeve të tij.

Për të dënuarit e mitur dhe për gratë që kanë fëmijë të mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen.

Neni 40

TAKIMET, VIZITAT, KORRESPONDENCAT DHE INFORMACIONI

Të dënuarit lejohen që të kenë takime dhe korrespondenca me familjarët dhe persona të tjerë.

Takimet zhvillohen në vende të veçanta nën kontroll shikimi dhe jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës.

Favorizohen veçanërisht takimet me familjarët.

Kur organizimi i institucionit e lejon, të dënuarit mund të autorizohen të rrinë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Sipas kriterëve të rregullores së burgjeve vizitat mund të bëhen në vende të rezervuara.

Administrata e institucionit vë në dispozicion të të dënuarve, që nuk i kanë mundësitë, mjetet e nevojshme për korrespondencën.

Korrespondenca telefonike mund të autorizohet në marrëdhëniet me familjarët, në raste të veçanta me të tretët.

Të dënuarit lejohen të mbajnë gazeta, revista e libra që janë në shitje të lirë jashtë dhe të shfrytëzojnë mjete të tjera informacioni të lejuara.

Me kërkesë të prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, gjykata lejon kontrollin e korrespondencës së të dënuarit.

Kontrolli mund të bëhet nga drejtori i institucionit ose nga persona të autorizuar prej tij në prani të prokurorit. Kërkesa e prokurorit pezullon dorëzimin e korrespondencës.

Neni 41

E DREJTA E BESIMIT DHE USHTRIMI I RITEVE FETARE

Të dënuarit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve. Për ushtrimin e riteve, institucioni siguron mjedise të veçanta.

Të dënuarit kanë të drejtë të marrin kontakt me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

Neni 42

Hyrja në Institucion

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmës komisionerët e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, Drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe avokatëve të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Nuk është i nevojshëm autorizimi për ata që shoqërojnë personat e përmendur në paragrafin e mësipërm, por gjithmonë jo më shumë se dy.

Personat e tjerë, që nuk parashikohen në paragrafin e parë, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit.

Këta persona në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit, kanë të drejtë të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji.

**PJESA E KATËRT
REGJIMI NË INSTITUCION**

KREU I

NORMAT E SJELLJES, ZHDËMTIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 43

NORMAT E SJELLJES SË TË DËNUARVE

Rregullorja e burgjeve dhe ajo e brendshme e institucionit përcaktojnë rregulla lidhur me trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të dënuarve, duke vendosur kufizime të nevojshme për atë që nuk cenohen kërkesat e këtij ligji dhe synimi për riedukimin e tyre.

Me rastin e pranimit në institucion dhe gjatë vuajtjes së dënimit, të dënuarit janë të detyruar të njohin dhe respektojnë rregullat e brendshme, dispozitat që lidhen me të drejtat dhe detyrat e tyre, të trajtimit dhe të disiplinës.

Asnjë të dënuari nuk mund t'i caktohen detyra në shërbimet në institucion, që i japin atij një pozicion sundues ose favorizues ndaj të dënuarve të tjerë.

Neni 44

PËRGJEGJËSIA PËR DËMET

Të dënuarit detyrohen të kujdesen për sendet e vëna në dispozicion të tyre, si dhe të shmangin çdo lloj dëmtimi të sendeve të të tjerëve.

Të dënuarit që shkaktojnë dëm material ndaj administratës së institucionit ose personave të tjerë, duhet ta dëmshpërblejnë atë.

Neni 45

KONTROLLI VETJAK

I dënuari i nënshtrohet kontrollit vetjak në çdo rast të hyrjes apo daljes nga institucioni dhe, në raste të tjera, kur ka shkaqe të arsyeshme.

Kontrolli vetjak duhet të bëhet, duke respektuar dinjitetin e të dënuarit.

Kontrolli mund të bëhet vetëm nga persona me të njëjtin seks me të dënuarin.

Me autorizim të drejtorit të institucionit, në rastet dhe mënyrën që parashikohet në rregulloren e burgjeve, mund të bëhen edhe kontrole të anësive.

Neni 46

DISIPLINIMI I LËVIZJEVE

Lëvizjet e të dënuarve jashtë institucionit bëhen në një kohë mundësisht sa më të shkurtër me shoqërim nga Policia e Burgjeve sipas rregullave të caktuara. Lëvizja e grave bëhet me asistencë të personelit të të njëjtit seks, ndërsa i të sëmurëve, të shoqëruar nga personeli mjekësor.

Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur, për të mbrojtur të dënuarit që transferohen, nga kureshtja i njerëzve dhe çdo lloj publiciteti tjetër, si dhe për të mos u krijuar shqetësime atyre.

Në lëvizjet individuale përdorimi i prangave është i detyrueshëm, kur e kërkon rrezikshmëria e lartë e të dënuarit ose rrethanat e mjedisit, që e bëjnë të vështirë transferimin.

Në lëvizjet kolektive është gjithmonë i detyrueshëm përdorimi i prangave ose i mjeteve të tjera shtrënguese.

Neni 47

ANKESAT

Të dënuarit mund t'ua paraqesin ankesat me gojë ose me shkrim edhe në zarf të mbyllur:

Drejtorit të institutit, inspektorëve, drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ministrit të Drejtësisë;

gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit dhe prokurorit të rrethit;
personave që vizitojnë institucionin sipas nenit 43 të këtij ligji.

Institucioni është i detyruar të evidentojë ankesat dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Për ankesat me shkrim dokumentohet marrja dhe dërgimi në destinacion.

Neni 48

AFATET E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DHE TË KËRKESAVE

Organet kompetente sipas këtij ligji shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e tyre, përveç kur ka afate të posaçme me dispozita të veçanta.

I burgosuri ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i burgosuri mund t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni

Neni 49

REGJIMI DISIPLINOR

Regjimi disiplinor realizohet në mënyrë që të stimulojë sensin e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit. Ai i përshtatet seksit, moshës, të dhënave fizike dhe psikike të të dënuarve.

Neni 50

SHKELJET DISIPLINORE

Të dënuarit nuk mund të ndëshkohen për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje në këtë ligj, në rregulloren e burgjeve dhe rregulloren e institucionit.

Ndëshkimi mund të jepet vetëm pas dëgjimit dhe verifikimit të pretendimit të të dënuarit.

Ndëshkimet caktohen në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të dënuarit ndaj saj, si dhe të dhënat individuale të tij.

Ndëshkimet zbatohen duke respektuar personalitetin e të dënuarit.

Neni 51

MASAT DISIPLINORE

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

- a. Qortim individual
- b. Vërejtje në prani të të dënuarve
- c. Përgjashtim nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë
- ç. Përgjashtim nga ajrosja në grup për jo më shumë se 20 ditë
- d. Përgjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë
- dh. Ndërprerja e lejeve

Ndaj të miturve dhe grave masat e parashikuara në shkronjat “c” “ç” dhe “d” mund të jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar. Për gratë shtatzëna ose që u është lënë fëmija, mund të zbatohen vetëm masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni.

Në rregulloren e burgjeve masat e mësipërme mund të diferencohen në varësi të llojit të institucionit, pa kaluar kufijtë maksimalë.

2. Masa disiplinore e përgjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta dhe ajrosja në grup nuk mund të bëhet pa një dokument me shkrim, të lëshuar nga mjeku, që dëshmon se i dënuari mund ta përballojë atë. I dënuari, ndaj të cilit merret kjo masë, i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm mjekësor.

Neni 52

ORGANI KOMPETENT PËR DHËNIEN E MASAVE DISIPLINORE

Masat disiplinore të vërejtjes dhe të qortimit vendosen nga drejtori i institucionit.

Masat e tjera vendosen nga këshilli disiplinor i përbërë nga drejtori ose zëvendësi i tij, me funksionin e kryetarit, nga sanitari, edukatori dhe komandanti i policisë.

Masat disiplinore evidentohen në kartelën e të dënuarit dhe konsiderohen të padhëna në rast mospërsëritjeje për një periudhë 6 mujore.

Neni 53

REGJIMI I MBIKËQYRJES SË VEÇANTË

I dënuari mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj kur:

- a. rrezikojnë sigurinë ose prishin rregullin në institucion;
- b. pengojnë veprimtaritë e të dënuarve të tjerë nëpërmjet dhunës dhe kërcënimeve;
- c. përpiqen të detyrojnë të dënuarit e tjerë që t’ju nënshtrohen ose të përfitojnë prej tyre;
- ç. nxisin të tjerët të mos zbatojnë ose të shkelin rregullat individualisht ose në grup.

Të dënuarit nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, me urdhër të drejtorit të institucionit, i cili kufizohet vetëm pjesëmarrja në veprimtaritë e përbashkëta ose ajrosja në grup.

Në rast nevojë urgjente, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve urdhëron drejtpërdrejt për kalimin e përkohshëm të të dënuarit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, duke vënë menjëherë në dijeni për këtë prokurorin, i cili brenda 24 orëve, i paraqet kërkesën gjykatës, e cila me vendim konfirmon ose anulon masën e përkohshme.

Ndaj të dënuarit, i cili gjatë regjimit të mbikëqyrjes së veçantë kryen shkelje të parashikuara në këtë nen, mund të shtyhet koha e regjimit deri në 3 muaj për çdo rast, duke u respektuar rregullat e marrjes së kësaj mase.

Neni 54

PËRMBAJTJA E REGJIMIT TË MBIKËQYRJES SË VEÇANTË

Përmban kufizimet më të nevojshme për mbajtjen e rregullit dhe të sigurisë, për ushtrimin e të drejtave të të dënuarve dhe për rregullat e trajtimit të parashikuara në rregulloren e burgjeve.

Për çdo rast, shtrëngesat nuk kanë të bëjnë me kërkesat e higjienës, të shëndetit, të veshjes, të ushqimit, të pajisjeve, me mbajtjen, blerjen dhe marrjen e ushqimeve ose objekteve të tjera të parashikuara nga rregullorja e institucionit, me leximin e librave, me praktikat fetare, me përdorimin e aparateve radio të tipit të lejuar, me ajrosjen, me bisedimet me avokatin mbrojtës, si dhe me bashkëshortët, fëmijët dhe për të miturit me prindërit.

Neni 55

PËRDORIMI I FORCËS DHE I MJETEVE SHTRËNGUESE

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna.

Personeli, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të dënuarve, duhet menjëherë të verë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit, i cili nga ana e tij bën kontrollin dhe siguron ndihmën shëndetësore të të dënuarve dhe vetëm pas kësaj verifikon çështjen.

Mjetet e shtrëngimit fizik nuk mund të përdoren si ndëshkim, por vetëm në rastet që parashikohen shprehimisht në rregulloren dhe për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personave, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të dënuarit.

Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe për kalimin për një periudhë mbi 72 orë duhet të merret miratimi i prokurorit.

Gjatë shtrëngimit fizik, i dënuari duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.

Neni 56

LLOJET DHE NATYRA E FORCËS DHE MJETEVE TË SHTRËNGIMIT

Në rregulloren e burgjeve përcaktohen llojet, natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit dhe rregullat e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të dënuarit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që formojnë armë ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal, si dhe ato që kanë natyrë torturuese dhe hipnoze.

Policët e shërbimit brenda institutit nuk duhet të mbajnë armë, me përjashtim të rasteve të parashikuar në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

KREU II**LEJET, SHPËRBLIMET DHE NDRYSHIMI I GJENDJES CIVILE**

Neni 57

LEJET SHPËRBLYESE

Të dënuarve të cilët respektojnë rregulloren e brendshme të institucionit, kanë sjellje të mirë dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, për realizimin e interesave të tyre emocionale, personale ekonomike dhe kulturore, drejtori i institucionit mund t’u japë leje shpërblyese, kohëzgjatja e të cilave në total, nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë në vit.

Për të dënuarit e mitur, kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast të dhënjes së saj dhe, në total, nuk mund të jenë më shumë se 45 ditë në vit.

Lejet shpërblyese janë pjesë e trajtimit rehabilitues dhe zbatimi i tyre ndiqet nga punonjësit e shërbimit përkatës.

Leja shpërblyese jepet:

- a. personave të dënuar deri në tre vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit
- b. personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit
- c. personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 2/3 e dënimit.

Sjellja e të dënuarit vlerësohet mirë, kur gjatë vuajtjes së dënimit, në mënyrë të vazhdueshme i dënuari ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie e sjellje korrekte me punonjësit e institucionit, me të dënuarit e tjerë dhe gjatë veprimtarive kulturore e punës së organizuar nga institucioni, si dhe ka krijuar besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit. Mosdhënia e lejes shpërblyese motivohet vetëm si masë disiplinore, në përputhje me shkronjën “dh” të nenit 53, si dhe në rastet e një situatë të jashtëzakonshme.

Leja shpërblyese në burgjet apo seksionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Në rast refuzimi, i burgosuri mund të ankohet në gjykatë e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes.

Neni 58

LEJE TË VEÇANTA

Drejtori i Institucionit mund t'u japë të dënuarve leje të veçantë, në rast sëmundjesh të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, apo të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

Leja e veçantë mund të jepet deri në 7 ditë dhe, me kërkesë të dënuarit, mund të zgjatet për aq kohë sa e diktojnë rrethanat. Në çdo rast, kohëzgjatja e lejes së veçantë nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

Në rast se dhënia e lejes refuzohet nga drejtori i institucionit, i burgosuri mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes.

Dhënia e lejes së veçantë i komunikohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, ku do të qëndrojë i dënuari.

Neni 59

DETYRIMET GJATË LEJES DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

I dënuari është i detyruar të respektojë kohën e lejes, ta kryejë atë në vendin për të cilën i është dhënë, të respektojë të gjitha detyrat dhe kushtëzimet që i janë dhënë dhe të njoftojë institucionin për çdo shmangie të imponuar.

Për mos respektimin e rregullave të mësipërme drejtori i institucionit ndërpret lejen, ndërsa për rastet e tejkalimeve në kundërshtim me kriteret e neneve 59 dhe 60 të këtij ligji, kërkohet nisja e procedimit penal sipas nenit 323 të Kodit Penal.

Neni 60

ULJA E DËNIMIT

Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij ose të drejtorit të institucionit.

Neni 61

NDRYSHIMET NË GJENDJEN CIVILE

Drejtorja e institucionit i evidenton, në një regjistër të veçantë, faktet e lindjeve, martesave apo vdekjeve të ndodhura në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si dhe informon autoritetet përgjegjëse, për të bërë shënime përkatese në regjistrin e posaçëm

të gjendjes civile, në të cilat nuk pasqyrohet statusi i personit si i burgosur.

Drejtoria e institucionit duhet të njoftojë menjëherë autoritetet gjyqësore, zyrën përkatëse të gjendjes civile, familjarët dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për vdekjen e të dënuarit.

Në këto raste kufoma vihet menjëherë në dispozicion të familjarëve dhe, kur nuk ka të tillë ose kur refuzohet marrja, vendoset në varreza publike. Për vdekjen e të dënuarit më shtetësi të huaj dhe për vendosjen e tij në varrezat publike njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 62

DEPOZITAT

Shumat në para të të dënuarve depozitohen pranë zyrës së llogarisë në institucion dhe, kur janë mbi limitet e parashikuara në ligj, jashtë tij, duke i dhënë dokumentin përkatës sipas ligjit.

I dënuari mund të disponojë depozitën sipas ligjit dhe kriterëve të parashikuara në rregulloren e burgut.

KREU III

TRANSFERIMET DHE LIRIMI

Neni 63

RREGULLAT E TRANSFERIMIT

Transferimet bëhen për arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të dënuarit nga të tjerët, kur ka mbipopullim në institucion, për nevoja të hetimit dhe gjykimit, për shkaqe shëndetësore dhe familjare, si dhe kur për shkak të formimit profesional është i nevojshëm në një institucion tjetër.

Transferimet duhet të favorizojnë mundësi që të dënuarit ta kryejnë dënimin pranë vendbanimeve të familjeve të tyre.

Të dënuarit duhet të transferohen së bashku me sendet vetjake.

Neni 64

LIRIMI

Lirimi i të dënuarve bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent.

Administrata kryen veprimet me urdhër me shkrim të drejtorit të institucionit.

Për të dënuar që nuk kanë mjete financiare dhe veshmbathje, me urdhër të drejtorit të institucionit i jepet një ndihmë në sasinë dhe sipas kriterëve të rregullores së burgjeve. Në të gjitha rastet kur rezulton që i liruari do të hasë në vështirësi për kthimin në jetën e lirë, drejtori i institucionit njofton për këtë organet e pushtetit lokal, ku banon i dënuari për asistencë të mëtejshme.

Për të dënuarit e mitur është i detyrueshëm njoftimi paraprak i prindërve ose kujdestarit të tij.

Gjykata që ka dhënë vendimin, organet e policisë lokale dhe Ministria e Brendshme njoftohen menjëherë për lirimimin e të dënuarit dhe në raste të veçanta edhe paraprakisht. Për shtetasit e huaj njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Të liruarit i jepet një vërtetim lirimimi në të cilin saktësohet kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet që ka pasur për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.

Me kërkesën e tij mund të jepet edhe vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar, si dhe njoftime për sjelljen në burg.

PJESA E PESTË

SHQYRTIMI GJYQËSOR I ANKIMEVE DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 65

KOMPETENCAT E GJYKATËS

Gjykata, në territorin e së cilës ndodhet institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit me përjashtim të çështjeve për të cilat në Kodin e Procedurës Penale është përcaktuar kompetenca.

Neni 66

SHQYRTIMI I ÇËSHTJES NGA GJYQTARI

Gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm përsa është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij. Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet.

Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj.

Kërkesat ose ankimet e pabazuara ose të përsëritura për të njëjtat raste e shkaqe, refuzohen. Kundër vendimit, i dënuari, drejtori i institucionit, mund të bëjnë ankesë në gjykatë brenda 5 ditëve nga vënia në dënim.

Ankesa e të dënuarit dhe drejtorit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Kur ankimi është bërë nga prokurori, ekzekutimi bëhet vetëm pas shqyrtimit të çështjes nga gjykata.

Neni 67

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

Vendimet e formës së prerë, që jepen nga gjykata, kur nuk parashikohet ndryshe, ekzekutohen nga drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 67/2

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij

Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:

- a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues
- b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 67/3

Garancitë në veprimtaritë e Mekanizmit Kombëtar

Mekanizmi Kombëtar, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, i garantohet:

- a) marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;
- b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;
- c) hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;
- ç) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japin informacionin e nevojshëm;
- d) zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitohë dhe e individëve që kërkon të intervistohë

Neni 67/4

Format e mbikëqyrjes

Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet:

- a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit më shkrim ose drejtpërdrejt;
- b) marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që

- kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;
- c) kërkimit të informacioneve nga administrata e institucionit
- ç) verifikimit të dokumentave, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.
- Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes Mekanizmi Kombëtar mund të marrë dhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimin të vërejtjeve;

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 68

TRAJTIMI I TË PARABURGOSURVE

Nenet 5 deri 11, 16, 23 dhe 28, 30, 32 deri 45, 47 deri 58, 60, 61 dhe 64 të këtij ligji zbatohen edhe ndaj individëve që mbahen në institucionet e paraburgimit, në përputhje me rregulloren e burgjeve.

Në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturave vajza me të mitur djem në një dhomë. Të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Gratë e paraburgosura vendosen në dhoma apo seksione të veçanta nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Drejtori i institucionit të paraburgimit, me kërkesë të prokurorit apo gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit për të pritur vizita, për korrespondencë apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Të paraburgosurit nuk përfitojnë leje shpërblyese. Me miratimin paraprak të prokurorit dhe drejtorit të institucionit, të paraburgosurit mund t'i jepet leje e veçantë për;

- a) lindje e fëmijës së të paraburgosurit
- b) martesë e fëmijës, vëllait, motrës apo prindit të paraburgosurit
- c) vdekje e fëmijës, bashkëshortit/es, vëllait motrës apo prindit të paraburgosur
- ç) raste të tjera përjashtimore.

Vërtetimi i fakteve juridike dhe identifikimi i personave të mësipërm bëhet në bazë të dokumentave të lëshuara për këto raste nga organet përkatëse.

Pranimi i të paraburgosurve bëhet në bazë të dokumentacionit, i cili përmban vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë, procesverbalin e kontrollit personal, formularin e identifikimit, me dy fotot dhe gjurmët e gishtërinjve, dokumentin e kontrollit mjekësor e çertifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit, pasaportë apo dokument identifikimi të përgatitur nga policia.

Lirimi i të paraburgosurit bëhet vetëm me vendim të gjykatës ose të prokurorisë. Në rast pamundësie objektive për t'u larguar nga institucioni pas lirimimit, me kërkesën e tij, i paraburgosuri strehohet në institucion, deri në përfundimin e pengesës për largim.

Neni 69

AKTET NËNLIGJORE ZBATUESE

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e burgjeve dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Rregulloret e brendshme të çdo institucioni miratohen nga ministri i Drejtësisë, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e rregullores së burgjeve.

Ministri i Drejtësisë në zbatim të ligjit dhe rregullores së burgjeve nxjerr urdhrat dhe udhëzimet e nevojshme.

Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi ato ekzistuese.

Neni 70

HYRJA NË FUQI

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2076, datë 30.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

Mbi ekzekutimin e vendimeve penale të huaja dhe kërkesat për gjykim të të dënuarve pas ekzekutimit të vendimit penal të huaj

Në K.Pr.P. në kreun e III seksioni I rregullohet mënyra e njohjes dhe e ekzekutimit të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë. Në bazë të nenit 512 të K.Pr.P. është Ministria e Drejtësisë që kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit të personit një kopje të vendimit dhe dokumentacionit përkatës dhe ky i fundit, prokurori, i bën kërkesë gjykatës për njohjen e vendimit të huaj.

Nisur nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme rezulton se Ministria e Drejtësisë është autoriteti i vetëm i ngarkuar ligjërisht të mbajë marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja. Megjithatë Ministria e Drejtësisë nuk ka akses të drejtpërdrejtë në gjykatat shqiptare. Në rastin e njohjes së një vendimi penal të huaj dhe ekzekutimit të tij në shtetin shqiptar (konvertimi) Ministria e Drejtësisë ia paraqet gjithë dokumentacionin e nevojshëm me kërkesën përkatëse prokurorisë, e cila është autoriteti i vetëm kompetent që legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykatën, e cila nga ana e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit. Janë vetëm gjykatat më të larta ato që vendosin për vendimet e gjykatave me të ulta në bazë të ankimeve të bëra brenda afateve ligjore dhe në përputhje me dispozitat e K.Pr.P.

Qëllimi që ndjek ky kre i K.Pr.P mbi ekzekutimin e vendimeve penale të huaja si dhe 2 konventat kryesore të KE që janë ajo “Për vlerën ndërkombëtare të gjykimeve penale” e vitit 1970 dhe “Për transferimin e të dënuarve me burg” e vitit 1983 dhe në bazë të kësaj konvente marrëveshja dypalëshe e lidhur midis R.Greqisë dhe R.Shqipërisë në datën 17.05.1994 “Për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore për çështje penale” dhe “Konventa midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për transferimin e të dënuarve të burgosur”. Këto janë baza ligjore të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të huaj, pra njohja dhe transferimi i të dënuarit dhe rehabilitimi më i shpejtë i shtetasit të dënuar në vendin e tij të origjinës.

Mbi këtë bazë ligjore, disa të burgosur në Greqi janë transferuar në burgjet shqiptare. Mbas kërkesave të tyre është bërë transferimi në burgjet shqiptare nga ato greke. Nga këta të dënuar pas transferimit në vendin e origjinës janë bërë kërkesa pranë gjykatave shqiptare të cilat kanë të bëjnë me shuarjen e dënimit të mbetur, kjo në bazë të ligjit mbi amnistinë, ose për rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundër vendimit të konvertimit të vendimit të një gjykate të huaj, si dhe për konvertimin e dënimit në bazë të nenit 3 të K.P. për veprimin në kohë të ligjit penal.

Nisur nga fakti se në gjykatat shqiptare janë gjykuar dhe ndodheshin edhe kërkesa të tjera të kësaj natyre dhe janë mbajtur qëndrime të ndryshme nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore, kolegjet penale të Gjykatës së Lartë kanë vendosur kalimin e çështjeve për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate e cila pas shqyrtimit të çështjeve ka argumentuar dhe vendosur:

Me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 154, datë 15.04.2000, me objekt shuarjen e dënimit për shkak të ligjit nr. 8202 datë 27.03.1997 “Për amnistinë” Gjykata e Lartë argumenton se ligji penal shqiptar (siç është edhe ligji mbi amnistinë) nuk i shtrin efektet e tij ndaj shtetasve shqiptarë që kryejnë veprë

penale në territorin e një shteti tjetër, kur për këtë vepër penale autoriteti gjyqësor i shtetit të huaj ka dhënë një vendim i cili ka marrë formë të prerë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se ligjet mbi amnistinë të dala tek ne nuk i shtrijnë efektet e tij si gjatë kohës që i dënuari vuan dënimin në shtetin e huaj ashtu edhe kur ai është transferuar në ekzekutim të vendimit të tij për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të huaj në Shqipëri. Kjo për rastin kur ligji mbi amnistinë ka dalë para ekzekutimit të vendimit penal të huaj. Nga ana tjetër në bazë të nenit 12 të Konventës të KE për transferimin e të dënuarve me burg dhe nenit 12 të Konventës bilaterale me Greqinë palët mund të japin falje, amnisti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionet përkatëse për të dënuarit e transferuar, por vetëm pasi është lejuar dhe ekzekutuar transferimi, apo kur amnistia dhe falja janë shprehur edhe për subjekte që ndodhen jashtë territorit të vendit.

Përsa i përket çështjes se a ka të drejtë i dënuari ose mbrojtësi i tij që për këtë kategori çështjesh që kanë të bëjnë me njohjen e vendimeve penale të huaja në zbatim të nenit 147 të K.Pr.P. të kërkojnë rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit të njohjes së vendimit penal të huaj. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr. 5 datë 10.10.2002 argumenton se kërkesa e të dënuarve për këto kategori çështjesh për t'u rivendosur në afatin e ankimit kundër vendimit të njohjes dhe konvertimit të dënimit për shkak se nuk kanë marrë dijeni për të nuk qëndron. Vendimi i konvertimit të dënimit të dhënë nga gjykatat shqiptare u është transmetuar autoriteteve të shteteve ku vuhet dënimi dhe i dënuari që kërkon transferimin ka të drejtë të njihet me vendimin e konvertimit para fillimit të proceduarve të transferimit. Në qoftë se i dënuari nuk është dakort me këtë vendim të konvertuar atëherë ai nuk mund të sillet në Shqipëri në kundërshtim me dëshirën e tij.

Mbi kërkesat që janë bërë nga të dënuar për konvertim dënimi në bazë të nenit 3 të K.P. për veprim në kohë të ligjit penal Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr. 4 datë 27.03.2003 argumentojnë se: Fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues (paragrafi 3 i nenit 3 të K.P.) në raport me momentin kohor të zbatimit të tij nuk është i pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal, fazë e cila nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar, ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë të gjykatave të huaja.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin e përgjithshëm se paragrafi i 3 i nenit 3 të K.P. është i zbatueshem në procedimet penale të vëna në lëvizje pas hyrje në fuqi të ligjit favorizues, si dhe me procedimet penale të vëna në lëvizje pas hyrjes në fuqi të ligjit favorizues gjykimi në to nuk ka përfunduar ende me vendim të formës së prerë.

Por nga ana tjetër legjislacioni penal dhe procedural shqiptar edhe për të dënuarit me vendime penale të gjykatave të huaja, pas ekzekutimit të këtyre vendimeve parashikon mundësi për rehabilitimin e tyre më të shpejtë në shoqëri duke përjashtuar tërësisht, pjesërisht personin nga vuajtja e dënimit, të bëjë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë ose duke u liruar para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me vëllimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Këto mundësi të parashikuara nga K.P. janë lirimi para kohe me kusht, falja dhe amnistia.

NGA KODI
I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Miratuar me ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995

TITULLI X
MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

KREU I
EKSTRADIMI

SEKSIONI I
a) - EKSTRADIMI PËR JASHTË SHTETIT

Neni 488

Kuptimi i ekstradimit

1. Dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit.

Neni 489

Kërkesa për ekstradim

1. Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.
 2. Kërkesës për ekstradim i bashkëngjiten:
 - a. kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;
 - b. një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj;
 - c. teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;
 - ç. të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.
 3. Kur konkurojnë disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkues.
 4. Në qoftë se për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi
-

territorin e të cilit është kryer vepra.

Neni 490

Kushtet e ekstradimit

1. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një veprë penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.
2. Kushtet e treguara nga paragrafi 1 nuk merren parasysh:
 - a. kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një veprë penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim;
 - b. kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar dyzet e pesë ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht.
3. Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme

Neni 491

Mospranimi i kërkesës për ekstradim

1. Nuk mund të jepet ekstradim
 - a. Për një veprë me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike;
 - b. Kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut;
 - c. Kur personi që kërkohet ka kryer një veprë penale në Shqipëri
 - ç. Kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit;
 - d. kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar
 - e. Kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar
 - f. Kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe
 - g. Kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon

Neni 492

Veprimet e prokurorit

1. Kur merr nga një shtet i huaj një kërkesë ekstradimi, Ministria e Drejtësisë, në qoftë se nuk e refuzon atë, ia dërgon bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente.
2. Prokurori pasi merr kërkesën urdhëron paraqitjen e të interesuarit për të bërë

identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventual për ekstradim. Të interesuarit i bëhet e ditur se ka të drejtë të ndihmohet nga një mbrojtës.

3. Prokurori u kërkon autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin dhe informacionin që çmon të nevojshëm.

4. Brenda tre muajve nga data kur ka ardhur kërkesa për ekstradim, prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për shqyrtim.

5. Kërkesa e prokurorit depozitohet në sekretarinë e gjykatës bashkë me aktet dhe sendet e sekuestruara. Sekretaria kujdeset për njoftimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësit e tij dhe përfaqësuesit eventual të shtetit kërkues, të cilët, brenda dhjetë ditëve, kanë të drejtë të shikojnë dhe të nxjerrin kopje të akteve, si dhe të këqyrin sendet e sekuestruara dhe të paraqesin memorie.

Neni 493

Masat shtrënguese dhe sekuestrimet

1. Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa shtrënguese dhe të vendoset sekuestrimi i provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprës penale, për të cilën është kërkuar ekstradimi.

2. Në caktimin e masave shtrënguese respektohen dispozitat e titullit V të këtij kodi, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit.

3. Masat shtrënguese dhe sekuestroja nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit.

4. Masat shtrënguese revokohen kur brenda tre muajve nga fillimi i ekzekutimit të tyre nuk ka përfunduar procedimi para gjykatës. Me kërkesë të prokurorit afati mund të zgjatet, por jo më shumë se një muaj, kur është e nevojshme të bëhen verifikime veçanërisht komplekse.

5. Kompetenca për të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm i përket gjykatës së rrethit gjyqësor ose, gjatë procedimit para gjykatës së apelit, kësaj të fundit.

Neni 494

Zbatimi i përkohshëm i masave shtrënguese

1. Me kërkesën e shtetit të huaj, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente, gjykata mund të vendosë përkohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit.

2. Masa mund të vendoset kur:

- a. shteti i huaj ka deklaruar se kundër personit është marrë një masë për kufizimin e lirisë personale ose një vendim dënimi me burgim dhe se ka ndër mend të paraqesë kërkesë për ekstradim;

- b. shteti i huaj ka paraqitur të dhëna të hollësishme për veprën penale dhe elemente të mjaftueshme për identifikimin e personit;
- c. kur ka rrezik ikjeje

3. Kompetenca për të vendosur masën u takon, sipas radhës gjykatës së rrethit gjyqësor në territorin e së cilës personi ka vendbanimin, vendqëndrimin apo banesën ose gjykatës së rrethit gjyqësor ku ai gjendet. Në qoftë se kompetenca nuk mund të përcaktohet në mënyrat e treguara më sipër kompetente është gjykata e rrethit gjyqësor të Tiranës.
4. Gjykata mund të vendosë edhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.
5. Ministria e Drejtësisë njofton shtetin e huaj për zbatimin e përkohshëm të masës shtrënguese dhe të sekuestros eventuale.
6. Masat shtrënguese revokohen në qoftë se brenda tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithsesi në maksimum dyzet ditë nga njoftimi i mësipërm nuk vjen në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e ekstradimit dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj.

Neni 495

Arrestimi nga policia gjyqësore

1. Në rastet e ngutshme, policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm. Ajo bën edhe sekuestrimin e provave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj.
2. Autoriteti që ka bërë arrestimin njofton menjëherë prokurorin dhe ministrin e Drejtësisë. Brenda dyzet e tetë orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës.
3. Gjykata, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi e miraton atë, kur janë kushtet ose vendos lirimimin e të arrestuarit. Për vendimin që merr ajo njofton ministrin e Drejtësisë.
4. Masa e arrestit revokohet në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk kërkon, brenda dhjetë ditëve nga miratimi, mbajtjen e saj.
5. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, në bazë të këtyre neneve, u njoftohet prokurorit, personit të interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

Neni 496

Dëgjimi i personit ndaj të cilit është marrë masë shtrënguese

1. Kur është zbatuar një masë shtrënguese, gjykata, sa më shpejt dhe sidoqoftë jo më vonë se pesë ditë nga ekzekutimi i masës ose nga vleftësimi i saj, sigurohet për identitetin e personit dhe merr pëlqimin eventual të tij për ekstradimin, duke e shënuar këtë në procesverbal.
2. Gjykata i bën të ditur të interesuarit të drejtën për të patur mbrojtës dhe në mungesë të tij cakton një mbrojtës kryesisht. Mbrojtësi duhet të lajmërohet, të paktën njëzet e

katër orë përpara, për veprimet e sipërme dhe ka të drejtë të marrë pjesë në to.

Neni 497

Shqyrtimi i kërkesës për ekstradim

1. Pasi merr kërkesën e prokurorit gjykata cakton seancën dhe njofton, të paktën dhjetë ditë përpara, prokurorin, personin për të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësin e tij dhe përfaqësuesin eventual të shtetit kërkues.

2. Gjykata merr të dhëna dhe bën verifikime që i çmon të nevojshme, si dhe dëgjon personat e thirrur në gjykim.

Neni 498

Vendimi i gjykatës

1. Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.

2. Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit.

3. Kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit, ekstradimi nuk mund të bëhet.

4. Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata.

5. Kundër vendimit të gjykatës, lidhur me kërkesën e ekstradimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga personi i interesuar, nga mbrojtësi i tij, nga prokurori dhe nga përfaqësuesi i shtetit kërkues, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit.

Neni 499

Disponimi për ekstradim

1. Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. Me mbarimin e këtij afati, edhe kur nuk është disponuar nga ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet.

2. Personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit.

3. Ministria e Drejtësisë i komunikon shtetit kërkues vendimin dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet. Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar dhe me kërkesë të arsyeshme të shtetit kërkues mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Kur ka shkaqe që nuk varen nga palët, mund të caktohet një datë tjetër dorëzimi, por gjithmonë duke u zbatuar afatet e caktuara në këtë paragraf.

4. Vendimi i ekstradimit e humbet fuqinë dhe i ekstraduari lirohet kur shteti kërkues nuk vepron në afatin e caktuar, për marrjen në dorëzim të të ekstraduarit.

Neni 500

Pezullimi i dorëzimit

1. Ekzekutimi i ekstradimit pezullohet kur i ekstraduari duhet të gjykohet në territorin e shtetit shqiptar ose duhet të vuajë një dënim për vepra penale të kryera para ose pas asaj për të cilën është dhënë ekstradimi. Por, Ministria e Drejtësisë pasi dëgjon autoritetin procedues kompetent të shtetit shqiptar ose atë të ekzekutimit të dënimit, mund të urdhërojë dorëzimin e përkohshëm në shtetin kërkues të personit që duhet ekstraduar, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e veprimit.
2. Ministria mund të bjerë dakord që dënimi i mbetur të vuhet në shtetin kërkues.

Neni 501

Zgjerimi i ekstradimit të dhënë dhe riekstradimi

1. Në rast kërkese të re të ekstradimit, të paraqitur pas dorëzimit të të ekstraduarit dhe që ka si objekt një vepër penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilin ekstradimi është dhënë, respektohen për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat e këtij kreu. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen deklaratat e të ekstraduarit, të bëra përpara një gjyqtari të shtetit kërkues për zgjerimin e ekstradimit.
2. Gjykata procedon në mungesë të të ekstraduarit.
3. Nuk ka vend për gjykim në qoftë se i ekstraduari, me deklaratat e parashikuara në paragrafin 1, ka pranuar zgjerimin e ekstradimit.
4. Dispozitat e sipërme zbatohen edhe në rastin kur shteti, të cilit i është dorëzuar personi, kërkon pëlqimin për riekstradimin e po këtij personi në një shtet tjetër.

Neni 502

Kalimi tranzit

1. Kalimi tranzit përmes territorit të shtetit shqiptar i një personi të ekstraduar nga një shtet në tjetrin, autorizohet me kërkesën e këtij të fundit, nga Ministria e Drejtësisë, në qoftë se kalimi tranzit nuk prek sovranitetin, sigurimin ose interesa të tjera shtetërore.
2. Kalimi tranzit nuk autorizohet:
 - a. kur ekstradimi është dhënë për fakte që nuk parashikohen si vepra penale nga ligji shqiptar;
 - b. kur janë rastet e parashikuara nga neni 491, paragrafi 1;
 - c. kur është fjala për një shtetas shqiptar, për të cilin ekstradimi në shtetin që ka kërkuar kalimin tranzit nuk do të jepej.
3. Autorizimi nuk kërkohet kur kalimi tranzit bëhet në rrugë ajrore dhe nuk parashikohet zbritje në territorin shqiptar. Por, kur ndodh zbritja, zbatohen për aq sa pajtohen dispozitat për masat e sigurimit.

Neni 503

Shpenzimet e ekstradimit

1. Shpenzimet e bëra në territorin shqiptar mbulohen nga pala shqiptare, kur nuk ka

marrëveshje tjetër

SEKSIONI II

b) - ESKTRADIMI NGA JASHTË SHTETIT

Neni 504

Kërkesa për ekstradim

1. Ministria e Drejtësisë është kompetente që t'i kërkojë një shteti të huaj ekstradimin e një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale. Për këtë, prokurori pranë gjykatës në territorin e së cilës procedohet ose është dhënë vendim dënimi, i bën kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke i dërguar aktet dhe dokumentet e nevojshme. Kur nuk e pranon kërkesën, ministria njofton autoritetin që e ka bërë atë.
2. Ministria e Drejtësisë është kompetente të vendosë në lidhje me kushtet e vëna eventualisht nga shteti i huaj për të dhënë ekstradimin, kur ato nuk vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Autoriteti procedues detyrohet të respektojë kushtet e pranuar.
3. Ministria e Drejtësisë mund të vendosë, për qëllimet e ekstradimit, kërkimin jashtë shtetit të personit të proceduar ose të dënuar dhe arrestimin e tij të përkohshëm.
4. Paraburgimi jashtë shtetit, si rrjedhojë e një kërkesë ekstradimi të paraqitur nga shteti shqiptar, llogaritet në kohëzgjatjen e paraburgimit, sipas rregullave të caktuara në titullin V të këtij kodi.

KREU III

c) - EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

SEKSIONI I

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE TË HUAJA

Neni 512

Njohja e vendimeve penale të huaja

1. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe.
2. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.
3. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit për njohjen e vendimit të huaj. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t'u kërkojë autoriteteve të huaja që i çmon të

nevojshme.

Neni 513

Njohja e vendimeve penale të gjykatave të huaja për efektet civile

1. Me kërkesën e të interesuarit, në të njëjtin procedim dhe me të njëjtin vendim, mund të deklarohen të vlefshme disponimet civile të vendimit penal të huaj lidhur me detyrimin për kthimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit.
2. Në rastet e tjera kërkesa bëhet, nga ai që ka interes, në gjykatën ku disponimet civile të vendimit penal të huaj do të ekzekutoheshin.

Neni 514

Kushtet e njohjes

1. Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur:
 - a. vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;
 - b. vendimi përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;
 - c. vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;
 - ç. ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;
 - d. fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;
 - dh. për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal;

Neni 515

Masat shtrënguese

1. Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente për njohjen e një vendimi të huaj mund të vendosë një masë shtrënguese ndaj të dënuarit që ndodhet në territorin shqiptar.
2. Kryetari i gjykatës, brenda pesë ditëve nga ekzekutimi i masës shtrënguese, merr masa për identifikimin e personit dhe i njofton atij të drejtën për të patur mbrojtës.
3. Masa shtrënguese e vendosur në bazë të këtij neni revokohet kur nga fillimi i ekzekutimit të saj kanë kaluar tre muaj pa u dhënë vendimi i njohjes nga gjykata e rrethit gjyqësor ose gjashtë muaj pa marrë vendimi formën e prerë.
4. Revokimi dhe zëvendësimi i masës shtrënguese vendosen nga gjykata e rrethit gjyqësor.
5. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata u njoftohet, pas ekzekutimit, prokurorit, të dënuarit nga gjykata e huaj dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

Neni 516

Caktimi i dënimit

1. Kur bën njohjen e një vendimi të huaj, gjykata cakton dënimin që duhet të vuhet në shtetin shqiptar. Ajo konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj në një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar. Ky dënim duhet t'i përgjigjet nga natyra atij që është dhënë në vendimin e huaj. Masa e dënimit nuk mund të kalojë kufirin maksimal të parashikuar për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar.
2. Kur në vendimin e huaj nuk është caktuar masa e dënimit, gjykata e cakton atë mbi bazën e kriterëve të treguara në Kodin Penal.
3. Kur ekzekutimi i dënimit të dhënë në shtetin e huaj është pezulluar me kusht, gjykata disponon vendimin e njohjes, veç të tjerave, edhe pezullimin me kushte të dënimit. Të njëjtën gjë gjykata bën edhe kur i pandehuri është liruar me kusht në shtetin e huaj.
4. Për të caktuar dënimin me gjobë shuma e vënë në vendimin e huaj konvertohet në vlerë të barabartë me lekë shqiptare, duke zbatuar kursin e këmbimit të ditës në të cilën është vendosur njohja.
5. Në vendimin e njohjes për ekzekutimin e një konfiskimi urdhërohet edhe zbatimi i konfiskimit.

Neni 517

Sekuestrua

1. Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente mund të vendosë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme.
2. Kundër vendimit mund të bëhet ankim.
3. Respektohen, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat që rregullojnë sekuestron preventive.

Neni 518

Ekzekutimi i vendimit të huaj

1. Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar.
2. Prokurori pranë gjykatës që ka bërë njohjen e vendimit merr masa për ekzekutimin e tij.
3. Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj llogaritet për efektet e ekzekutimit.
4. Shuma e nxjerrë nga ekzekutimi i vendimit me gjobë derdhet në Bankën e Shqipërisë. Ajo mund të derdhet në shtetin ku është dhënë dënimi me kërkesën e tij kur ai shtet, në të njëjtat rrethana, do të vendoste derdhjen në favor të shtetit shqiptar.
5. Sendet e konfiskuara i dorëzohen shtetit shqiptar. Ato i dorëzohen, me kërkesën e tij, shtetit ku është dhënë vendimi i njohur kur ky, në të njëjtat rrethana, do të vendoste

dorëzimin në shtetin shqiptar.

SEKSIONI II

d) - EKZEKUTIMI JASHTË SHTETIT I VENDIMEVE PENALE SHQIPTARE

Neni 519

Kushtet e ekzekutimit jashtë shtetit

1. Në rastet e parashikuara nga marrëveshjet ndërkombëtare ose nga neni 501, paragrafi 2, Ministria e Drejtësisë kërkon ekzekutimin jashtë shtetit të vendimeve penale ose jep pëlqimin kur ai kërkohet nga shteti i huaj.
2. Ekzekutimi jashtë shtetit i një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale mund të kërkohet ose të lejohet vetëm në qoftë se i dënuari që ka marrë dënimin për pasojat, ka deklaruar lirisht se jep pëlqimin dhe kur ekzekutimi në shtetin e huaj është i përshtatshëm për riintegrimin e tij shoqëror.
3. Ekzekutimi jashtë shtetit lejohet edhe kur nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara nga paragrafi 2, në qoftë se i dënuari ndodhet në territorin e shtetit, të cilit i është drejtuar kërkesa dhe ekstradimi është mohuar ose sidoqoftë nuk është i mundur.

Neni 520

Vendimi i gjykatës

1. Para se të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi, Ministria e Drejtësisë i dërgon aktet prokurorit, i cili bën kërkesë në gjykatë.
2. Pëlqimi i të dënuarit duhet të jepet para gjykatës shqiptare. Në qoftë se ai ndodhet jashtë shtetit, pëlqimi mund të jepet para autoritetit konsullor shqiptar ose para gjykatës së shtetit të huaj.

Neni 521

Rastet e moslejimit të ekzekutimit të dënimit jashtë shtetit

1. Ministria e Drejtësisë nuk mund të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale kur ka arsye të çmohet se i dënuari do t'u nënshtrohet akteve persekutuese ose diskriminuese për shkak të racës, fesë, seksit, kombësisë, gjuhës apo bindjeve ose dënimeve e trajtimeve të egra, çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 522

Kërkesa për paraburgim jashtë shtetit

1. Kur kërkohet ekzekutimi i një dënimi me kufizim të lirisë personale dhe i dënuari ndodhet jashtë shtetit, Ministria e Drejtësisë kërkon paraburgimin e tij.
2. Në kërkesën për ekzekutimin e një konfiskimi, Ministria e Drejtësisë ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme.

Neni 523

Pezullimi i ekzekutimit në shtetin shqiptar

1. Ekzekutimi i dënimit në shtetin shqiptar pezullohet nga çasti kur ka filluar ekzekutimi në shtetin e huaj.
2. Dënimi nuk mund të ekzekutohet më në shtetin shqiptar, kur sipas ligjeve të shtetit të huaj ai është shlyer tërësisht.

LIGJI

Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005

PËR AVOKATIN E POPULLIT

Në mbështetje të neneve 60-63, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Avokatit të Popullit.

Neni 2

Detyrat e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj.
Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit

dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për mbrojtjen e të drejtave të të huajve, të cilët janë ose jo rezidentë të rregullt në Shqipëri, të refugjatëve, si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të parashikuara në ligj.

Avokati i Popullit kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligje të veçanta.

Neni 3

Kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit

Avokat i Popullit mund të jetë çdo person që plotëson këto kushte:

- a. të jetë shtetas shqiptar.
- b. të ketë njohuri dhe veprimtari të shquara në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;
- c. të shquhet për aftësi profesionale dhe figure të pastër etiko-morale;
- ç. të mos jetë dënuar penalisht
- d. të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit që bën propozimin a zgjedhjen e tij.

KREU II

ZGJEDHJA, HEQJA DHE TË DREJTAT E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 4

Mënyra e zgjedhjes së Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Para marrjes ose rimarrjes së detyrës Avokati i Popullit bën betimin para Kuvendit. Formula e betimit është: “Beto hem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do të mbroj kurdoherë liritë dhe të drejtat themelore të njerëzve pa dallim, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 5

Kohëzgjatja në detyrë

Avokati i Popullit zgjidhet në detyrë për një periudhë prej pesë vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 6

Imuniteti dhe paga

Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon si të rëndësishme. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e tij barazohet me atë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 7

Mbarimi i funksionit të Avokatit të Popullit

Funksioni i Avokatit të Popullit mbaron:

- a. kur jep dorëheqjen;
- b. kur mbaron afati 5 vjeçar i qëndrimit në këtë funksion;
- c. me vdekjen e tij;
- ç. kur shkarkohet.

Neni 8

Heqja nga funksioni i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit shkarkohet nga funksioni vetëm në rastet kur:

- a. është dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- b. është i paaftë mendërisht a fizikisht për të ushtruar funksionet e tij;
- c. kryen veprimtari në kundërshtim me parashikimet e nenit 10 të këtij ligji;
- ç. nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 muaj.

Mocioni për shkarkimin e Avokatit të Popullit bëhet së paku me 1/3 e deputetëve të Kuvendit.

Vendimi për shkarkimin nga funksioni të Avokatit të Popullit merret me 3/5 e votave të deputetëve të Kuvendit.

Neni 9

Zgjedhja e Avokatit të ri të Popullit

Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit brenda një muaji nga mbarimi apo shkarkimi nga funksioni. Deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit, si për rastet kur Avokati i Popullit është i pamundur të kryejë detyrat, funksionin e tij do ta kryejë komisioneri më i vjetër në detyrë.

Neni 10

Papajtueshmëritë me funksionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit ndalohet të bëjë pjesë në parti apo organizata politike, të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore e profesionale dhe të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare. Ai mund të ushtrojë të drejtën si autor e mësimdhënës.

Neni 11

Sigurimi i punës së mëparshme të Avokatit të Popullit

Me mbarimin e funksionit sipas shkronjave “a” e “b” të nenit 7, Avokati i Popullit ka të drejtë të rimarrë funksionin ose punën publike që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit.

Kur kjo nuk është e mundur, duhet t’i sigurohet një punë e barazvlerëshme me atë që ai

kishte përpara zgjedhjes në detyrën e Avokatit të Popullit.

KREU III

ANKESAT, RREGULLAT E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 12

E drejta për t'u ankuar

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur.

Avokati i Popullit duhet të ruajë fshehtësinë nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën apo njoftimin.

Neni 13

Fillimi i shqyrtimit të çështjes

Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 14

Kushtet e pranimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve

Avokati i Popullit mund të mos fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata. Në këto raste, ai ka të drejtë të kërkojë informacion pranë këtyre organeve, të cilat duhet t'u përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë.

Neni 15

Moskërkimi i formës për ankesat dhe njoftimet

Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Popullit nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës.

Avokati i Popullit nuk pranon ankesa ose kërkesa anonime.

Neni 16

Shërbim pa pagesë

Çdo shërbim që bëhet nga Avokati i Popullit lidhur me ankesat, kërkesat e njoftimet është pa pagesë.

Neni 17

Administrimi i ankesave ose njoftimeve nga Avokati i Popullit

Avokati i Popullit, pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, vendos:

- a. ta pranojë ose jo çështjen për shqyrtim;
- b. t'i kthejë përgjigje të interesuarit, duke i treguar të drejtat dhe rrugët nëpërmjet të cilave ai mund ta mbrojë këtë të drejtë;
- c. t'ia kalojë çështjen organit kompetent.

Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit njofton të interesuarit brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, kërkesës ose njoftimit.

Neni 18

Procedura pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim

Pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim, Avokati i Popullit kryen njërën nga veprimet e mëposhtme:

- a. ndërmerr vetë një proces hetimi;
- b. kërkon shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve;
- c. i rekomandon Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtrojë funksionet e veta.

Neni 19

Procedura e hetimit

Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:

- a. të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.
- b. të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;
- c. të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet;
- ç. të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

Neni 19/1

Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit),

në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.

Neni 20

E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore

Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror.

Neni 21

Veprimet pas përfundimit të hetimit dhe kompetencat

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- a. i shpjegon ankuesit se të drejtat e tij nuk janë shkelur;
- b. paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.
- c. paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen; Mosshqyrtimi i rekomandimit brenda 30 ditëve pezullon aktet ose veprimet e paligjshme ose të parregullta.
- ç. i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara.
- d. për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;
- dh. për shkelje të të drejtave nga organet e pushtetit gjyqësor, pa ndërhyrë në procedurën që ato zbatojnë, Avokati i Popullit i bën të ditur shkeljet organit kompetent;
- e. u rekomandon personave të dëmtuar të paraqesin padi në gjykatë; Rastet e mësipërme nuk përjashtojnë njëri-tjetrin.

Neni 22

Detyrimi i organeve të administratës për t'ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim

për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij.

Neni 22/1

Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit

Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

Neni 23

Ndjekja e mëtejshme e çështjes nga Avokati i Popullit

Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki. Në rastet e përsëritura, si dhe kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

Neni 24

E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative

Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

- a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;
- b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.
- c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.

Neni 25

Personat dhe aktet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit

Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit personat dhe aktet e mëposhtme:

- a. Presidenti i Republikës
 - b. Kryetari i Këshillit të Ministrave
- Gjithashtu, janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit:
- c. urdhrat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura

Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

KREU IV

MARRËDHËNIET E AVOKATIT TË POPULLIT ME KUVENDIN, INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE DHE ME ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Neni 26

Raportimi në Kuvend

Avokati i Popullit paraqet në Kuvend një raport vjetor, i cili diskutohet në seance plenare. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Raporti vjetor për vitin pasardhës duhet të paraqitet jo më vonë se 30 prilli i vitit në vazhdim.

Neni 27

Raportimet e veçanta në Kuvend

Përveç raportimit në kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh. Kryetari i Kuvendit vlerëson nëse ky raportim do të bëhet:

- a. në seancë plenare;
- b. me shpërndarje të raportit;
- c. në komisionet e përhershme të Kuvendit;

Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport.

Neni 28

Publikimi i raporteve

Raporti vjetor dhe raportet e veçanta bëhen publike dhe botohen jo më vonë se një muaj nga data e diskutimit në Kuvend.

Botimi bëhet nga Kuvendi.

Neni 29

Përgatitja e raporteve, për të drejtat e njeriut

Avokati i Popullit mund të ndihmojë dhe të japë mendime e rekomandime në përgatitjen e raporteve dhe të dokumenteve të tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat e

liritë e njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Neni 30

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare

Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat jo qeveritare, duke marrë, periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, organizon, të paktën një here në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

KREU V

KOMISIONERËT, ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT DHE BUXHETI

Neni 31

Struktura

Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në 3 seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët.

Këto seksione janë:

1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;
2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.
3. Seksioni i përgjithshëm për trajtimin e çështjeve jashtë fushave të mësipërme, për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe për studimet e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Neni 32

Emërimi i një përfaqësuesi vendor

Në rastet kur Avokati i Popullit e sheh të arsyeshme, ai mund të emërojë një përfaqësues të tij vendor për një çështje dhe kohe të caktuar. Organet e pushtetit vendor kanë për detyrë ta pajisin këtë përfaqësues me zyrë, si dhe t'i krijojnë kushtet e nevojshme të punës, për zbatimin e gjithë kërkesave të këtij ligji. Ky përfaqësues paguhet nga buxheti i Avokatit të Popullit.

Neni 33

Zgjedhja e Komisionerëve dhe paga e tyre

Komisionerët zgjidhen ndër juristët më të shquar, për një mandat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Për zgjedhjen e komisionerëve zbatohen kushtet e parashikuara në nenin 3 dhe në nenin 10

të këtij ligji. Paga e komisionerëve është sa dy të tretat e pagës së Avokatit të Popullit.

Neni 34

Mbarimi i funksionit dhe heqja e Komisionerëve

Rregullat e përmendura në këtë ligj për mbarimin e funksionit dhe heqjen e Avokatit të Popullit zbatohen edhe për komisionerët.

Në rastin e largimit të komisionerëve, me mbarimin e afatit 3-vjeçar dhe në rastet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c” dhe “ç” të nenit 7 dhe në rastet e parashikuara nga neni 8 i këtij ligji, Avokati i Popullit, brenda një muaji i propozon Kuvendit zgjedhjen e një komisioneri të ri.

Këta mund të shkarkohen edhe me kërkesën e Avokatit të Popullit para mbarimit të afatit 3-vjeçar për shkelje në detyrë apo sjellje dhe akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tyre.

Neni 35

Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit

Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit bën pjesë në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë.

Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit caktohet nga Avokati i Popullit. Avokati i Popullit dhe tre komisionerët përfitojnë falas Fletoren Zyrtare.

Neni 36

Buxheti i Avokatit të Popullit

Mjetet financiare të Avokatit të Popullit përballohen nga buxheti i shtetit, ku Avokati i Popullit ka një kre të veçantë.

Projektbuxheti propozohet nga Avokati i Popullit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, i cili e paraqet për miratim në Kuvend, në përputhje me Ligjin Nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”.

Avokati i Popullit duhet të përgatisë për çdo vit llogaritë e veta, në përputhje me Ligjin Nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”. Llogaritë financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 37

Donacionet që mund t’i jepen Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit mund të përfitojë nga donacione të ndryshme financiare ose materiale. Donacionet duhet të jenë pa kushte që mund të komprometojnë pavarësinë, paanësinë dhe kushtetueshmërinë e veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Donacionet duhet të deklarohen dhe të shënohen në një regjistër që zyra e Avokatit të Popullit mban për këtë qëllim. Në fund të vitit, Avokati i Popullit detyrohet të çojë një kopje të regjistrit

me hyrjet dhe daljet në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe një kopje në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit. Regjistri duhet të përmbajë llojin e ndihmës, masën, kohën, subjektin që jep donacionin dhe mënyrën e lëvrimit të donacionit. Regjistri duhet të përmbajë edhe identitetin dhe nënshkrimin e dhuruesit.

KREU VI

DISPOZITA TRANZITORE

Neni 38

Dispozita tranzitore

Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit.

Neni 39

Rregullorja e brendshme

Brenda 3 muajve nga zgjedhja e tij, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me komisionerët, harton rregulloren e brendshme të punës.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

EMRAT DHE ADRESAT OMBUDSMANËVE NË EUROPË

të cilëve mund t'u ankoheni për shkelje gjatë kryerjes së dënimit në burgje, por jo për vendimet e Gjykatave

Në Maqedoni

Ixhet Memeti

Ombudsman of Macedonia
Ul. "Dimitria Cupovski" br.2
91000 SKOPJE
MACEDONIA

Në Slloveni

Ms.Zdenka Cebasek-Travnik

Ombudsman of Slovenia
Dunjaska 56
1109 LJUBLJANA
SLOVENIA

Në Zvicër

Mr.Thomas Faesi

Ombudsman des Kantons Zyrh
Ajfred Escher-Strasse 11
CH-8090 ZURICH
SWITZERLAND

Në Suedi

Ms.Mats Melin

Box 16327, S 103 26
STOCKHOLM
SWEDEN

Në Spanjë**Mr.Enrique MUGICA HERZOG**

National Ombudsman

Eduardo Dato 31

Madrid 28.010

SPAIN

Në Rumani**Mr Joan MURARU**

Ombudsman of Rumania

Str.Eugeniu Corada

Nr 3 Sector 3

Cod 030057 RO 030057

Bucharest

ROMANIA

Në Bosnje-Hercegovinë**Dr.Vitamis Popovic**

Mr Mariofil Ljubik

Mr Safet Pasic

Human Rights Ombudsman

Marsala Tita 7, BA 71000

SARAJEVO

BOSNIA AND HERCEGOVINA

Në Kroaci**Ms. Jurica Malcic**

National Ombudsman

Opaticka 4

41000 ZAGREB

CROATIA

Në Danimarkë**Dr.Hans Gammeltoft-HANSEN**

Folketingets Ombudsmand

Gammel Torv 22

DK-1457 COPENHAGEN K

DENMARK

Në Bolzano**Burgi Volgeo**

ITALY

Në Holandë**Dr Alex Brenminkmeije**

National Ombudsman

Stadhoudersplantsoen 2

P.O Box 931222

2509 AC THE HAGUE

THE NETHERLANDS

Në Barcelonë**Sr.Rafael Ribo i Masso**

Ombudsman of Catalonia

Josep Ansel, Clave, 31

08002 BARCELONA

SPAIN

Në VALLE D`AOSTA (Italy)**DR. Flavio Curto**

Difensore civico di Valle

D`Aosta

Via Festoz 52

1-11100 AOSTA

ITALY

Në Belgjikë**Mrs.Catherine De Brueckes**

Mr.Guido Schuermans

Federal Om,budsman

Hertogstraat 43

1000 BRUSSELS

BELGIUM

Në Francë

Mr.Jean-Paul Delevoye
Mediateur de la Republique
53, Avenue d`Iena
75116 PARIS
FRANCE

Në Gjermani

Mrs.Kersten Naumann
CHAIPERSON
Petitions Committee
Of the German Bundestag
Plaz der Republik 1
11010 Berlin
GERMANY

Në Hungari

Mr.Mate Szabo
Parliamentary Commissioner
For Human Rights
Orszaggyulesi
Biztosa, 1054-Budapest
HUNGARY
SHQIPËRI

Në Greqi

Mr.Yorgos Kaminis
Ombudsman
5 Hadjiyianni Mexi Str.32
ATHENS
GREECE

Në Kosovë

Z.Hilmi Jashari
Ombudsman of Kosovo
Str.Agim Ramadani
10000 PRISTINA-KOSOVË

Në Shqipëri

Z. Ermir Dobjani
Avokat i Popullit
Tel.++355 4 2 232462
Fax.++355 4 22 2260095
e-mail:ap@avokatipopullit.gov.al
Tiranë

Ribotimi i këtij material u mundësua në kuadër të projektit “Mbështetje për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri”.
Ky projekt financohet nga **Bashkimi Evropian** dhe **Qeveria Italiane** dhe zbatohet nga **IOM** dhe **Qeveria Shqiptare**.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)
Rr. Brigada VIII, Vila Nr 3
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2257 836 / 7
Fax: +355 4 2257 835
www.albania.iom.int

Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri
Adresa: Rruga e Durrësit, 1 27-1
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 222 8320
Fax: +355 4 223 0752
www.delalb.ec.europa.eu